VITI XIII BOTIMIT Nr. 626 12-19 MARS 2022 ÇMIMI 50 LEKË / 0,30 EURO

Gazetë javore, letrare & kulturore, e përditshme online

NACIONAL

Botues: Mujë Buçpapaj
e-mail: bucpapaj@yahoo.com
Mob: 068 20 74 316
www.gazeta-nacional.com
Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë
e-mail: nacionalalbania@yahoo.com

Me 16 Mars, Akademi përkujtimore në 1-vjetorin e ndarjes nga jeta

SHEFKI KARADAKU NJË NGA POETËT DHE PROZATORËT MË TË VEÇANTË TË LETRAVE SHQIPE

Nga Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

Libri " Gjendja kishtare në Kosovë në periudhën paraosmane

SERBËT NDËRTUAN KISHAT E TYRE SIPËR THEMELEVE TË KISHAVE KATOLIKE SHQIPTARE NË KOSOVË

Nga Dr. Besim Morina

EDITORIAL

KOHA PËR TË ZGJEDHUR NJË SHQIPTARO-AMERIKAN NË KONGRES, VEDAT GASHI MUND TA BËJË

Nga Harry Bajraktari

Djali i emigrantëve shqiptarë po kandidon në zonën që dikur përfaqësohej nga kongresisti Engel

SHQIPTARËT NË UKRAINË, STALINI DHE SHQIPTARËT

Nga prof. dr. Spiro Mëhilli



Më 24 maj 1794, me urdhër te Ekaterinës II, në jug të Ukrainës, buzë Detit të Zi, u ndërtua një port ushtarak, që në vitin 1795 e quajti Odesë, dhe më 1796

BARDHYL LONDO, POETI I MAJAVE POETIKE

Nga dr. Uran Butka

Emrin e Sali Butkës, e kisha takuar shumë më parë se të kuptoja atë që marr vesh sot nga jeta, bota, letërsia, poezia,

ARSIMI YNË, SFIDA DHE REALITETE

Nga Fran Gjoka



Drejtimi i arsimit dhe i shkollës në veçanti, përbën sot një ndër prioritetet e MAS dhe është në qendër të reformimit dhe strukturimit të vazh-

Reagim i 17 subjekteve kulturore shqiptare

MINISTRIA E KULTURËS NË MAQEDONINË E VERIUT, DISKRIMINON KULTURËN SHQIPTARE

IMZOT DODAJ: BINOMI FE DHE ATDHE ËSHTË SHUMË I GJALLË NË EKZISTENCËN TIME

FLET PËR "NACIONAL" IMZOT ARJAN DODAJ, KRYEIPESHKËV I KRYEDIOQEZËS TIRANË-DURRËS

"E ndjej veten të thirrur para së gjithash për të mbjellur shpresën tek të rinjtë shqiptarë"

Intervistoi: Dr. Mujë Buçpapaj

FAQE 20

KARIKATURA E NJË REGJIMI NË ROMANIN "DËMTUAR GJATË RRUGËS", TË BESNIK MUSTAFAJT

Nga Arben Cejku

FAQE 18

5 VJET MË PARË U NDA NGA JETA PROFESOR VANGJUSH SIMAKU

Nga Dr. Mujë Buçpapaj

FAQE 18

FONDI I MONUMENTEVE BOTËRORE NË SHBA, RENDITITË BURGUN E SPAÇIT SI NJË NGA VENDET MË TË ÇMUARA NË BOTË

Nga Beqir SINA- New York

NË BRENDËSI

FAQE 12-13
FJALA E NOBELIT J.M.G. LE CLÉZIO
PËRKTHEU: ZYMBER ELSHANI

FAQE 8
POEZIA E LITARE E KADRUSH RADOGOSHIT
NGA RICHARD DAVIES

FAQE 26-27
POEMË NGA MAHMOUD DARWISH
PËRKTHEU: SKËNDER BUÇPAPAJ

FAQE 9
NA ISHTE NJË HERË NJË UJK
TREGIM NGA MEHMET ELEZI

FAQE 10
REPORTAZH NGA ATHINA
NGA KOZMA GJINI



FAQE 31
PROZA E HASKOS, VEÇORI STILISTIKE
NGA KRISTINA DEMIRI DOJÇE

FAQE 6-21
Poezi nga:
- FREDERICO LORKA
- RABINDRANATH TAGORA
- DIEGO VALERI
- GIUSEPPE UNGARETTI
- SALVATORE QUASIMODO
- BLAGA DIMITROV

MAKTHI CULLAK
PROZË NGA MEHMETALI REXHEPI

Mos harro tmerret e diktaturës! Mos lejo rikthimin e saj!

FONDI I MONUMENTEVE BOTËRORE NË SHBA, RENDITITË BURGUN E SPAÇIT SI NJË NGA VENDET MË TË ÇMUARA NË BOTË

Nga Beqir SINA- New York

NEW YORK CITY : Fondi i Monumenteve Botërore, e cila është një organizatë private jofitimprurëse e themeluar në vitin 1965, në New York të SHBA, nga individë të shqetësuar për shkatërrimin e përshpejtuar të thesareve të rëndësishme artistike në të gjithë botën, e ka renditur Burgu i Spaçit në vitin 2016, një nga vendet më të çmuara në botë- ndërtesë e rrezikuar për t'u "zhdukur" simbas raporti te vitit 2016.

Tani që kjo organizat është duke duke festuar 55 vjetorin e krijimit të saj, Fondi i Monumenteve Botërore, ka në veprat e saj më të çmuara në botë, mbi 600 projekte në 90 vende, përfshirë edhe Burgun famekeq te Spaçit , ne Shqiperi,i cili radhitet ndër 50 më të rëndësishmit në botë për t'u vizituar me një drejtshikim për gjeneratat e ardhshme, thote Fondi i Monumenteve Botërore, .

Sot, ky fond me organizatat e saj, degë të themeluara në Britani, Indi, Peru, Portugali dhe Spanjë, sponsorizon një program të vazhdueshëm për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në mbarë botën.

World Monuments Watch, eshte me një program global i nisur më 1995 me rastin e 30 vjetorit të krijimit te Fondit Monumental Botëror, i cili synon të identifikojë vendet e rrezikuara të trashëgimisë kulturore dhe të mbështesë financiarisht dhe teknikisht për ruajtjen e tyre.

Si eshte sipercituar një vend jashtëzakonisht të veçant në mesin e këtyre objekteve botërore, ka zënë dhe Burgu i Spaçit , i cili ishte një kamp famëkeq i punës i themeluar në vitin 1968 nga qeveria komuniste e Shqipërisë në vendin ku shfrytezohej një miniere bakri dhe piriti, në një zonë të largët dhe e eger malore në veri të vendit (Miriditë).

Ndërsa ai është vetëm një nga shumë vende të tilla, të burgosurve politikë, në Europën juglindore, i ngritur vetëm për të mbajtur në Spaç, kundërshtarët politik (të damkosur dhe dënuar si armiqt e popullit nga regjimi i Enver Hoxhes), ku përfshinin disa nga intelektualët më të shquar shqiptarë të shekullit të njëzetë, duke i dhënë asaj një vend të veçantë në kujtesën kolektive të asaj epoke, ngeli në djerr mbas hapjes se tij.

Vendndodhja e kampit të punës së detyrueshme, ishte i ndërtuar në një pjerrtësi të terrenit e cila ndjek kreshtën e maleve të egra të Munellës, niste nën hyrjen e tunelit në këtë minierë. E cila ishte kaq e largët dhe i sigurt për një burg, sa që nuk nevojitej asnjë mur perimetrik për të siguruar rrethimin kompleks, vetëm ishte e rrethuar me disa rrethe me tela me gjemba vetem me një portë e përparme, dukeshin se ishin mjaft për ta siguruar parametrin e rrethimit të tij.

Piktori i ndjer Maks Velo, i cili e vuajti vet terrein e këtij burgu, që u bë i njohur në të gjithë botën, ishte arrestuar në vitin 1978 dhe u dënua me dhjetë vjet burg në Spaç, mbasi doli i gjallë kur u hap burgu, e përshkroi atë si "kampin më të tmerrshëm në Evropë dhe në botë gjatë asaj periudhe".

Burgu politik i Spaçit, është i vetmi burg në botë, që ka bërë një revolt kundra rregjimit dictatorial - për liri e demokraci.

Në Maj 1973, Burgu i Spaç u bë vendi i revoltës së parë dhe vetme të burgosurve politik në botë në atë kohë , dhe është një nga momentet e para të rezistencës ndaj shtypjes së regjimit komunist. Megjithatë, Spaçi vazhdoi të vepronte si kamp pune deri në rënien e sundimit të partisë komuniste nga pushteti në fillim të viteve 1990.

Ajo(ndërtesë) u braktis tërësisht disa vjet më vonë. Sot, edhe pse është përcaktuar si një vend i trashëgimisë, me vlera më të çmuara në botë – drejtshikimi për gjeneratat e ardhshme, kompleksi ishte në një gjendje shumë të avancuar të përkeqësimit, për shkak të elementeve dhe ndërtesave te braktisura dhe të "shkretëruar", pothuajse në të gjitha pushtet.

Duket, se po vihet "dorë" nga organizatat nderkombetare për mbrojtjen e këtyre objekteve nè te gjithe boten.

Njera prej tyre eshte edhe World Monuments Watch, e cila më 2016 njeh një përpjekje të re duke përfshirë institucionet, shoqërinë civile dhe qytetarët privatë për të krijuar një institucion modern të kujtimit duke filluar qysh nga gjetja e eshtrave te te burgosurve nè Burgun e Spaçit, edhe te relikeve e nderteses se mbetur mbas hapjes. E cila eshte vjedhur per skrap dhe material ndertimi nga banoret per teeth saj.

Pasi që asnjë vend tjetër nuk ekziston si një vend i kujtesës për ish të burgosurit politikë në Shqipëri, Fondi i Monumenteve Botërore, ka projektuar se ekziston një nevojë urgjente për të çuar përpara njohuritë, për të rritur ndërgjegjësimin e publikut shqiptar dhe për të krijuar një kërkesë për transformimin e kësaj faqeje të zezë të historisë në një qendër të veçantë përkujtimi dhe edukimi.

Ndërhyrjet e para mbrojtëse në vend që nga mbyllja e tij u zhvilluan në qershor të vitit 2017, falë mbështetjes lokale të ofruar nga Ambasada Suedeze në Tiranë. Ato përfshinin pastrimin e lokacionit, riparimin e çatisë së emergjencës dhe stabilizimin e përkohshëm strukturor të disa ndërtesave. Më parë atë muaj, ish Ministri i Kulturës i Shqipërisë vizitoi vendin dhe e shpalli atë prioritet për Ministrinë e Kulturës gjatë viteve të ardhshme. Falë hulumtimeve dhe dokumentacionit të ri, një propozim për zgjerimin e zonës së mbrojtur në vend është paraqitur nga propozuesit në vitin 2016.

Burgu Spaç: një dëshmitar qe "nuk ka "gojë" të flasë" por i qendron ende e dhibshme per te "rrëfyer" vitet e egra te diktatures komuniste në Shqipëri për 45 vjet.

Diktatori Enver Hoxha, ishte udhëheqës i asaj kohe i cili arriti të mbajë drejtimin e vendit, si kreu i shtetit për më shumë se 40 vjet., dhe kryegazeta e botës "New York Times" e ka quajtur atë "Krye/organizatori i izolimit dictatorial të Shqipërisë".

Gjatë asaj periudhe,(45 vjeçare) Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë, ishte nën sundimin komunist dhe ishte i mbushur me kampe pune dhe burgje, të cilat ishin mbushur përplot me të burgosur politikë, dhe njerëz që nuk përputheshin fare me përkufizimin e zakonshëm të regjimit që i damkoste se "armiq të popullit", por se vetëm që ishin kundërshtar të përbetuar të atij regjimi –Megjithse, regjimi komunist i Enver Hoxhës, i quajti të gjithë kundershtaret e tij politik, si " kriminel dhe armiq të popullit, tradhëtar , sabotator dhe bashkëpuntor dhe ëndrrimtar të Perendimit (Europes perendimore dhe Shteteve te Bashkuara te Amerikes) .

Në atë kohë simbas statistikave të ish Ministrisë së Punëve të Brendshme të Shqipërisë, thuhet se ishin rreth 40 burgje zyrtare. Një nga këto, në shtetin e athershem te rrethuar të Shqipërisë, njihej thjesht si "Spaç" një zonë nga më të egrat malore të vendit. Në një pjesë e fshatit Spaç, institucioni që fsheh kujtimet e së kaluarës së errët të Shqipërisë, ka shkruar NYT.

Duke shpjeguar se ky Kamp, si e quan New York Times, u krijua fillimisht në vitin 1968, 17 vjet para vdekjes së Hoxhës, shkruan gazetari ishte i pasur në të dy minerale të vlefëshme nëntokësore ; atë të bakrit dhe piritit. Ndërkohë, që të burgosurit politik u detyruan të punonin në këto miniera.

"Shumë nga të burgosurit ishin ish anëtar të familjeve më fisnike, ish intelektual të shquar, shkolluar në perendim, ose nga ata që kërkonin të arratiseshin nga që nuk e duronin dotë diktaturën komuniste, ndërkohë që ishte edhe pjesë e grupeve armiqësore të Shqipërisë, të shpallur nga Hoxha, që do t'i privonte ata nga statusi dhe pozita e tyre. Kampi - burgu u ndërtua që të përngjajë ngushtë me kampet, ashpër të Bashkimit Sovjetik, për Gulagët në Siberi".

Më tej gazeta amerikane New York Times, tregonte se ndërtesa kryesore ndodhej nën hyrjet e minierave, prej të cilave pesë ishin gjithsej :Hyrja në të gjithë kompleksin ku ehe sot duket të ishte në një fund pa dritë në fund të tunelit.

"Terreni ishte kaq i vështirë sa që ishte ndoshta i vetmi burg në botë që një mur parametri nuk ishte ngritur kurrë, por vetëm i rrethuar me tela me gjëmba. Disa kabina(punte në form fanari) vrojtimi në pikat këndore qëndronin rojet e ushtrisë të armatosur rëndë, dhe me dylbi vrojtimi të shpërndar rreth zonës së një gardhi i thjeshtë me tela me gjemba që duhej për të mbajtur të burgosurit brenda, burgut për të mos u arratisur. Ekspertët e minierave u punësuan për të siguruar që minierat funksiononin siç duhet; ata jetonin jashtë ndertesave të burgut, dhe nuk kishin të bënin me dënimin e të burgosurve dhe nuk kishin asnje kontakt me te burgosurit".

Simbas dokumentet të New York Times, popullsia e përgjithshme e Burgut Spaç ishte rreth 1400 të burgosur – Ndersa, një numër pak më i vogël krahasuar me numrin e përgjithshëm të personave të burgosur gjatë kësaj periudhe ishte ne burgjet e tjerk. Ku ky numër arriti në dhjetra mijëra të burgosur politik në Shqipëri , çka u mësua vetem kur u hapën burgjet politike. Një përqindje e madhe e këtyre njerëzve u izoluan dhe u detyruan të punonin në këto miniera – që pothuajse të gjitha kishin nga një burg, krahasuar kushtet e të burgosure të Shqipërisë – as që kishin të krahasuar me ato të pjesës tjetër të botës, në Luftën e Ftohtë.

"Kushtet në Spaç ishin brutale, për ta vënë atë në renditjen e burgjeve në botë. Burgjet ndërtoheshin përgjethësisht aty ku ish minierat e Shqipërisë, dhe ngriheshin qëllimisht në vende të vështira dhe shumë të burgosur vdiqën ose u sëmurën me sëmundje të rënda nga rraskapitja dhe kequshqyerja dhe keq trajtimi shtazarak që përdorte rregjimi ndaj tyre. Temperaturat në ato zona ku ishin burgjet politike ishin vazhdimisht gjatë dimrit në minus 20-25 gradë Celsius dhe në korrik rreth 45 gradë Celsius, nga që ishte shpatë mali dhe ato orë që binte dielli të "përvëlonte".

Një pjesë e shkallëve të brendshme të kampit të çonin në dhomat e të burgosurve.

Të sëmurët të lodhur për t'u trajtuar në këtë mënyrë, të burgosurit politik që i shfyrtëzonin të nxirrinin mineralin nga nën toka, vendosën të rebeloheshin kundër autoriteteve në shenjë zëmërimi kundra rrregjimit. Më 21 maj 1973 u bë një revoltë, unike e të burgoserve politik në të gjithë Europën juglindore. Në atë kohë, të burgosurit politik shqiptar ishin të vetmit në botë që arritën të marën në kontroll burgun e Spaçit, duke arritër ta mbajnë atë vetëm për dy ditë.

Kur autoritetet arritën të fitonin kontrollin mbi vendin ku ndodhi revolta, me foraca të shtuara policore, dhe forca të ndërhyrjes së shpejt nga Tirana, forcat të ashtuquajtura speciale, ata ekzekutuan pa gjyq brenda disa ditëve katër të burgosur, dhe dënuar, pikerisht ata që i konsideruan sipas tyre si përgjegjës për organizimin e revoltës.

Eshtë, për t'u theksuar se mbas kësaj asgjë nuk ndryshoi me kushtet: kushtet madje u riten represioni dhe u përkeqësuan edhe ato pak kushte edhe më shumë për të dënuarit politik.

Burgu politik në të gjithë vendin vazhdoi praktikat e tij, edhe pas vdekjes së Hoxhës, megjithse se edhe koha e tij po "përendonte" ngadalë-ngadalë, dhe vendit po i afrohej liria ajo që as që mendohej në atë atë periudhë.

Deri në vitin 1995, Burgu Spaçit qendroje i braktisur fare dhe u la për t'u përkeqësuar : duke u shkatërruara dhe humbur gjurmët atje në Spaç : "me një vdekje të ngadaltë dhe të dhimbshme", për ish të burgosurit politik, që vuajtën dënimin në Burgun e Spaçit, në një nga burgjet më të tmerrshme dhe famëkeqe në botë., ka shkruar NYT.

Mbas 1991, kur njerëzit mësuan se burgu ishte lënë në "duar të fatit", grabitësit dhe plaçkitësit erdhën për të grabitur gjithëçka, që kishte mbetur dhe që iu nevoitej banorëve për rreth që ishin të varfër shumë në atë kohë .

Ndërsa, për ata që shërbyen në atë periudhë në Burgun e Spaçit, si autoritete, apo policë burgu, hetues, dhe ish ushtarët e gardës e rojes së kufirt, thuhet se shkuan sa 'u hap burgu' të zhdukin pjesën e tyre të objekteve dhe dokumenteve, dëshimve të Shqipërisë Komuniste, duke shkatërruar rëndë gjithcka edhe Burgun e Spaçit në këtë proces, i cili u zhvillua atëhere në të gjithë Shqipërinë për zhdukjen e provave të tyre., simbas New York Times

"Mirëpo, është për t'u theksuar se edhe më pas nuk është bërë shumë për të ruajtur vendin ku ishin burgjet, dhe kampet e interrnimit, ku gjurmët e tyre pothuajse janë zhdukur tashmë. Në Burgun e Spaçit, shumë nga dhomat ku ishin të mbyllur të burgosurit, janë ende plot me vizatime dhe mbishkrime nga të burgosurit, që sot mund të shihen edhe si vepra arti dhe të zbulohen se kush i ka bërë".

Në vitin 2007, burgu u shpall një monument kombëtar i kategorisë së dytë dhe u bënë plane për ta kthyer tërë vendin në një muze. Megjithatë, asgjë nuk ndryshoi për vite deri në vitin 2017, kur Ambasada suedeze e Tiranës dhuronte fonde drejt punëve të ruajtjes.

Projekti përfshiu pastrimin e lokacionit, stabilizimin e disa ndërtesave më të përkeqësuara dhe riparimin e shumë çative.

Tmerret e regjimit komunist në Shqipëri mbeten të freskëta në mendjet e të mbijetuarve, pasi vendi kujton mizoritë me të cilat përballen të burgosurit politikë 46 vjet më parë në burgun famëkeq të Spacit.

Më 23 maj 1973, të burgosurit politikë në Shqipëri, u ngritën kundër një prej regjimeve më brutale diktatoriale në Evropë, duke kërkuar trajtim human, duke i dhënë fund urisë dhe kushteve çnjerëzore të jetesës.

Thuhet se Revolta e Spaçit, e të burgosuve politik shqiptar ishte revolta më e madhe e këtij lloji në burgjet anembanë botës gjatë epokës komuniste.

Shqipëria kujton mizoritë brenda burgut të epokës komuniste

Ndonëse, në atë kohë revolat këtyre të burgosurve në burgun e Spacit, dërgoi një mesazh shprese për njerëzit e shtypur anembanë botës, nëpërmjet "Zërit të Amerikës" e vetmja që ka siguruar athere lajmin – marrja e burgut për dy ditë fitorja e tyre do të vijë në një vëmendje tjetër vite më vonë në 1991, duke u bërë edhe frymëzim për rrëzimin e komunizmit në Shqipëri.

Sepse edhe thirrja e demostratave te studentve ne 1990: "E duam Shqipërinë si gjithë Europa", ka qenë e "kopjura" nga thirrja e Revoltës së Spaçit, më 23 Maj 1973.

Ishte pikerisht ajo thirrja që këndonin studentët e dhjetorit (90)dhe të gjithë demostruesit në Tiranë, Shkodër e Kavajë, më 1991, duke hedhur anembanë Shqipërisë, slogane antikomuniste, po që u shtypën brutalisht nga qindra ushtarë e policë të pajisur me armë dhe shkopinjë gome.

Katër të burgosur të përfshirë në Revoltën e Spaçit, ishte bilanici I tmerrshem më 21 maj të 1973, i revoltës antikomuniste të të burgosurve politikë në burgun famëkeq të Spaçit, ku u ekzekutuan Skënder Daja, Pal Zefi, Dervish Peka dhe Hajro Pashai., të cilët u pushkatuan nga një skuadër pushkatimi, ndërsa tetë të tjerë u dënuan me 25 vjet burgim, sipas "Muzeut të Kujtesës", një projekt i mbështetur nga shteti për të nderuar viktimat.

Sidoqoftë, disa të burgosur mbetën të vendosur dhe kundërshtar antikomnist deri në fund. Kur Skënder Daja, një nga burrat e pushkatuar pa gjyq, iu kërkua të kërkonte falje, ai u përgjigj me zë të fuqishëm : "Edhe sikur të kisha 10 jetë, të gjitha 10 herët do të kisha bërë të njëjtën gjë" dhe plumbat e pushkëve e përplasën për tokë, ndërsa komandati i togës së pushkatimit i fundit me revolver i gjuan edhe tre herë në kokë , simbas ligjit të pushkatimit.

Burgu i Spaçit kujton mizoritë brenda burgut të epokës komuniste….

Simon Miraka, një i mbijetuar shqiptar i këtyre kampeve, duke folur rreth mizorive të regjimit që filloi për të dhe familjen e tij qysh në kohën kur ai u lind në qytetin e Shkodrës, në veri të Shqipërisë, në vitin 1945, ka deklaruar se regjimi e kishte kthyer shtëpinë e tij në një burg, atë periudhë.

Miraka ka pohuar se ai jetoi 45 vjet në kampet e internimit deri në kohën kur ra regjimi. Ai ka treguar se pesë vitet që ai kaloi në kampin e përqendrimit në Tepelenë midis 1949 dhe 1954 në Shqipërinë jugore, ishin ato më të vështira për familjen e tij. "Rreth 400 fëmijë vdiqën në këtë kamp, mbetjet e të cilëve mbeten të zhdukur deri më sot. Edhe, sot mendoj se si mund të mbijetoj [atë kamp] pasi që kaq shumë fëmijë vdiqën atje," citohet te kete thene ai.

Kampi i përqendrimit në Tepelenë ishte një nga shumë kampet Stalinist të Shqipërisë, e cila u hap në vitin 1949.

Sipas tij kampit të internimit, ishte me më shumë se 500 njerëz të pafajshëm qe nje pjese vdiqën në këtë kamp nga "uria, sëmundjet, torturat dhe puna e rëndë, keqtrajtimi dhe kushtet çnjerëzore"

Simon Mirkaj, i cili per disa vjet ka qene ish-kreu i Institutit për Integrimin e ish të Persekutuarve Politik, ka deklaruar disa here per shtypin e huaj dhe vendas në Shqiperi, se "rreth 6,000 njerëz u ekzekutuan me ose pa gjyq" gjatë më shumë se 45 vjet regjimit komunist.

"Gjithsej "18,000 njerëz u burgosën" për arsye politike dhe disa "30,000 u dërguan në kampe internimi" brenda vendit," ka thën Mirakaj.

Nderkohe, simbas shtypit të huaj diktatori shqiptar Enver Hoxha, ishte ai që udhëhoqi vet një nga regjimet më të ashpra dhe më të përgjakshme në Evropë nga viti 1944 deri në vdekjen e tij në vitin 1985.

Përveç vrasjeve, regjimi i Hoxhës përmendet për ndërtimin e 23 burgjeve dhe 48 kampeve të përqendrimit në vendin e vogël.

Burgu i Spacit, i cili u hap në vitin 1968 në një luginë të vargmaleve veriore të Mirditës, maleve të Munelles, ishte një burg nga më brutal i regjimit - I ashtuquajtur "burg mbi burgun" e izolimit dhe kampin e detyrueshëm të punës. Zona e ashpër gjeografike e bëri të pamundur që mijëra të burgosur politikë të iknin nga ky burg - ku nuk munguan në ndonjë rast sporadik edhe arratisjet vet-skarifikuese.

Lugina ishte e pasur në burime nëntokësore një minierë bakri dhe piriti e cila u bë një varrezë për qindra të burgosur që punonin atje për vdekje, mori emrin Burgu i Spaçit.

Instituti Shqiptar i Studimeve Politike në bashkëpunim me Ministrinë Shqiptare të Kulturës ka thënë se e ka lansuar më 23 maj 2017 ekspozitën "Lugina e Rezistencës" kushtuar revoltës antikomuniste.

Autorët e saj kan thënë se ekspozita e tyre synonte të bënte homazhe ndaj mijëra viktimave të sistemit komunist.

Sipas Instituti Shqiptar i Studimeve Politike, një përqindje e konsiderueshme e popullsisë shqiptare vuajti persekutimin politik direkt ose indirekt gjatë regjimit komunist. Gjithashtu, se mbetjet e mijëra njerëzve që u ekzekutuan pa gjyq ose ata që vdiqën në burgje për shkak të urisë ose torturave mbeten të zhdukur, mbetet ende në hulumtim dhe nuk është statistik perfundimitare.

Ky institut thotë se regjimi komunist ne Shqiperi, nuk i kursente as familjet e të burgosurve politikë dhe ku ka pasur edhe gratë e vajza të dënuarave të përdhunura, fëmijët dhe pleqtë në kampet e internimit të keq trajtuar dhe të privvuar nga cdo gjë.

Historia e zbehjes së krimeve të komunizmit në Shqipëri…….!

Ish Kryetari i Shoqatës së të Përndjekurve politikë Nebil Çika,gjate nje vizite në Shqipëri, tre vjet më parë na deklaroie në Tiranë, në zyrën e tij se simbas dokumentave që ai kishte mbledhur : " Rreth 43,000 shqiptarë u burgosën, u dërguan në kampe internimi ose u ekzekutuan gjatë sundimit komunist që zgjatën nga viti 1944 deri në vitin 1990″.

Ai tha se :"Regjimi i Hoxhës kishte 50 burgje dhe kampe internimi; U ekzekutuan 5,577 burra dhe 450 gra; rreth 1.000 vdiqën në burg; 17,900 u burgosën me 914,000 vjet burg dhe vetëm rreth 2,700 prej tyre janë ende gjallë tani; më shumë se 30,000 u dërguan në kampet e internimit".

Ndërkohë, ai shtoi se akoma Dosjet e Sigurimit po përdoren nga partitë për pushtet të hapen pa kushte : "Nuk kam aspak besim tek kjo klasë politike që ka zgjedhur ish bijt e atyre që kryen këtë gjëmë të madhe dhe plag të pa-mbyllur, dhe mbanë akoma në krye të këtij Parlamenti atë që ishte ish Ministrin e Brendshëm të fundit të regjimit,(bëhej fjalë për Gramoz Ruçin) dhe ka një ish oficer të lart të Shkollës së oficerve të Enver Hoxhës, për Ministër të Brendëshëm(behej fjale per Gjeneral Sander Lleshaj)- njëzet e pesë vjet pasi regjimi u rrëzua në kaos, pothuajse gjysma e popullsisë prej 3 milionë banorësh, nuk ka ende kujtesën më të vogël për atë cfarë ka ndohur, si ndodhi dhe kush e bëri, në në një nga vendet më të izoluara të botës." pati deklaruje ish-Kryetari i Shoqatës së të Përndjekurve politikë" zoti Nebil Çika.

FRYMËZIME TË HUAJA POETIKE NË GJUHËN SHQIPE

Përkthime poetike nga italishtja dhe anglishtja, nga Anton Çefa, New York

Rabindranath Tagora

(1861-1941)

"Kur mbasi të ketë dëgjuar të recitohet një poezi imja, ndonjë më thotë: "Nuk e kam kuptuar', unë jam i detyruar të hesht.
Në qoftë se i merrni erë një luleje dhe thoni: 'Nuk kuptoj' – përgjigjja ime është: 'Këtu nuk ka gjë të pakuptueshme, është vetëm erë e mirë'. Dhe në qoftë se, megjithëkëtë, ju ngulni këmbë duke thënë: 'E di, po ç'kuptim ka?', Atëherë nuk më mbetet tjetër veç të ndërroj bisedë ose të bëhem i pakuptueshëm, duke pohuar se era e mirë është forma që merr gëzimi i gjithësisë në një lule".

Dashuria për natyrën

Cilido që të jesh ti, lexues i këngëve të mia
Pas njëqind vitesh,
Unë nuk do të mund të të çoj
As edhe një lule të vetme
Të kësaj pranvere të pasur,
Një fjollë të artë resh që shtrihen atje lart.
Hap dyert e shih jashtë,
Mblidh prej kopshtit tënd kundërmues
Kujtime të erandshme,
Të zhdukura njëqind vite më parë !
Në zemrën tënde do të mund të ndiesh
Gëzimin plot jetë
Që këndova në një mëngjes pranvere,
Duke të dërguar zërin tim të gëzueshëm
Të njëqind viteve më parë.

PËRHUMBJE NË ZOTIN

Në duart tua, o Zot, kohha është e pafund.
Asnjë nuk mund të numërojë minutat.
Kalojnë ditët dhe netët.
Moshat lulëzojnë dhe vyshken si lulet.
Ti di të presësh. Për ta përkryer një një lulëz të egër
Shekujt Tuaj ndjekin njëri-tjetrin.
Na nuk kemi kohë me humbë . . .
Në muzg ngutem nga frika se dera Yte mbyllet,
Por . . . ka prap kohë.

VËLLAZËRIM UNIVERSAL

Hapi sytë e shih:
Zoti yt nuk është para teje.
Ai është atje ku fshatari lëron plisin e fortë
E gurthyesi punon.
Ai është me ta, në diell e në shi,
Dhe rrobet e Tij janë të mbuluara me pluhur.
Hiqe atë mantel dhe zbrit si Ai
Mbi truallin plot pluhur!
Lerim! Ku mund ta gjesh këtë lirim?
Mësuesi ynë ka marrë mbi shpatullat e Tia
Dhimbjet e njeriut.
Është bashkuar me ne përgjithmonë.

2. ALFRED LORD TENNYSON

(Poet anglez, 1809-1892)

Tingëllo jashtë Vit i vjetër,
Tingëllo brenda Vit i Ri.
Tingëlloni kumbonë të lumtura
Përmes dëborës:
Viti po shkon,

BLAGA DIMITROV
(poeteshë bullgare)

DERI NESËR!

"Deri nesër!", më the dhe ike.
Të shoqërova, e humbur, me sy.
Eshtë larg e nesërmja. A është e mundur
Të qëndrojmë të ndarë kaq orë?

Deri nesër nuk do të njoh
Hijen e ballit tënd, as pëshpëritjen
E dorës tënde të ngrohtë s'do ta ndjej
Dhe as lumin e mendimeve tua.

Në qoftë se do të të marrë etja në këto orë,
Nuk do të mund të jem burimi yt. Po të kesh ftohtë
Nuk do të jem unë flaka që të ngrohë.
As drita yte kur të bëhet errësirë.

"Deri nesër!" më the dhe ike,
Pa dëgjuar as psherëtimen time.
Ndërsa unë prisja që të qëndroje pranë meje
E të më thoje: "Deri në amshim!"

ISHIM MË TË AFËRMIT (MË INTIMËT)

Të mbetemi miq të mirë! Ç'kuptim
Ka kjo frazë? Duart tona të shkrira
N'shtërngim (më dhembin ende),
Do të takohen vetëm për një lamtumirë?

Shikime të etura që thitheshin,
Tani vetëm një salutim ?
Në vend të buzëve që digjeshin të përvëluara,
Vetëm një fjalë miqësore?

Jo, nuk mund të jemi miq të mirë.
Dashuria nuk njeh rrugë të mesme.
Ishim më intimët. Tani e mbrapa
Do të jemi më të huajt mbi këtë botë.

HUMBJE

Nuk di nëse isha dashuruar pas teje.
Di vetëm se isha shastisur
Pas dhomës së vogël, pak të ndriçuar,
Në mesnatë, e pas çajnikut që zinte . . .

Pas pemëve që prisnin horizontin.
Kinemave të humbura të lagjes,
Kujtimeve plot ankth të burgut.
Dhe plagëve të bombave mbi mure.

Stacioneve të tramvajit. Gjetheve të lagështa,
Gështenjave të nxehta në xhep.
Shtërgatave. Tringëllimit të telefonit.
Dhe deri mjegullave, detit gri…

Pas gjithë botës isha dashuruar.
Jo pas teje. Më dukej interesante,
E re, më e pasur. Për këtë më vjen keq,
Jo sepse të kam humbur ty; po pse kam humbur botën.

PA DASHURI

Tani e mbrapa do të jetoj pa dashuri.
Nuk do të varem më nga telefoni yt
Ose nga rasti. Do të bëhem indiferente.
Nuk do të vuaj. Do të jem erë e lidhur.
Do të ngrihet përroi pa psherëtima.

Nuk do të me zbehet më fytyra
Pas një nate pa gjumë, dhe as
Nuk do të më përndezet ajo. As toka
nuk do të më dridhet nën këmbë nga dhimbja,
Kurrë më nuk do të fluturoj drejt qiellit tënd.

Nuk do të jem e keqe, por edhe një gjest të vetëm
Nuk do të mund ta bëj në horizont të hapur.
As drita nuk do të më mungojë,
Po çfarë hapësire do të mund të shoh…

Nuk do të përvëlohem më duke pritur mbrëmjen,
Por edhe dita nuk do të agojë më për mua.
Nuk do të dridhem më nga akulli i fjalëve,
Por as nuk do të digjem mbi zjarrin flakërues.

Nuk do të qajë mbi supet tua mizore,
Por edhe nuk do të qeshi më me gjithë zemër.
Kurrë më nuk do të vdes për një shikim,
Por në të vërtetë nuk do të jetoj më.

QYTETI I VOGËL DHE BOTA E MADHE

U linda në një qytet të vogël e në një shtëpi të vogël,
nën gërshetimin e blertë të një pjergulle.
Për këtë kam aq dëshirë të zbuloj
çdo gjë në këtë botë.

Jam rritur mbi kalldrëmet e rrugëve
Me bar të zbërdhylët anash,
aq të ngushta sa atje bënte të ftohtë,
kur ishte nxehtë e anasjelltas.
Prandaj në rrugë të gjera ndjej
frikë prej ngricës e prej vapet.

Njëri me tjetrin njiheshim,
në qytet ecej ngadalë,
ndaleshim nëpër rrugë
e pyesnim njëri-tjetrin :
"Si je, si shkon?"
Prandaj fati i shumë të panjohurve
Më intereson në qytetet e mëdha
E befas më tërheq vetmia në trafik.

Kujtoj në qytetin e vogël
komshitë ndër dyer duke marrë e dhënë
bukë, lule për të mbjellë, e tjera,
ose pranë gardheve, duke shkëmbyer
zjarr, lajme e ndonjë fjalë të mirë.
Prandaj më duket sikur më kafshon
çdo derë e përplasur.
Oh, sikur njerëzit
e botës shurdhe, të huaj, të vendosnin
me inisiativën e tyre: duar e zemër!

Ia di për nder qytetit tim të vogël,
sepse më ka hapur sytë
e habisë për tërë botën,
sy provincialesh, por të etur,
që do të besojnë e do të kërkojnë
gjatë ecjes të takojnë
ata që flasin një fjalë ngushëllimi,
që të japin pak zjarr, një këshill, e tjera.

VINCENZO CARDARELLI
(poet italian)

KALIM NATËN

Shtrihet atje lart fëmijëria ime.
Lart në atë kodrinë
që rishtas po e shoh natën,
duke kaluar me tren,
shënuar me drita të gjalla.
Erë kallamishtesh të djegura
më mbështjell në stacion:
erë e vjetër dhe e shpërndarë
e ngjashme me shumë zëra që më thërrisnin.
Por treni ik. Unë nuk di se ku shkoj.
Më shoqëron një mik
që s'merr mundimin as të zgjohet.
Askush nuk e mendon as e përfytyron
çfarë është për mue
kjo tokë amtare që unë e kaloj fluturim
si një i huaj, si një tradhtar.

JUAN RAMON JIMENEZ
(poet spanjol)

"KONVALESHENCA"

Vetëm ti je pranë meje, diell mik.
Si një qen drite lëpin shtratin e bardhë timin;
e unë e humbi dorën në qimet tua të arta,
i drobitur nga lodhja.

Sa gjëra që qenë
janë tashma larg!

Unë hesht
e qeshi, si një fëmijë!

Më lë të lëpihem prej teje, diell i mirë!

…Ngreju, me forcë, o diell,
roje besnike e disfatës sime,
dhe me britma të ndezura e të marra
lehu fantazmave të kota
që, si hije të heshtuna, më kërcenojnë
nga shkretia e perëndimit.

DIEGO VALERI
(poet italian)

VJESHTË E BRISHTË

Vjeshtë e brishtë: gjethi i varur
në degën e zhveshur, krejt i zbehtë,
shtresë e re
e bardhë, sipër kaltërsia; lulet e verdha …
Paksa lëviz era, si zëri
i ujit që rrjedh e humbet tej,
tek grykderdhja.
Vjeshtë e brishtë: gjethi ka rënë.



BORIS SLUTSKIJ
(poet rus)

KEMI KALUAR TË GJITHË NËN ZOTIN

Kemi kaluar të gjithë nën Zotin,
nën brinjën e tij.
Në këmbë mbi mauzole,
ishte më i fortë e më i keq,
më i mençur se ai tjetri
që e ka emrin Jehovah,
dhe të cilin e rrëzoi,
e zhduku, e karbonizoi,
por më pas e tërhoqi nga errësira
e i dha një tryezë e një qoshe.

Kemi kaluar të gjithë nën Zotin,
nën brinjën e tij.

Një ditë po shkonte për Arbat.
Zoti kalonte mbi pesë makina.
Gati si kurrizdala nga frika
ndër kapota ngjyrë miu
dridheshin pranë tij rojet.

Ishte vonë dhe ishte heret,
Qielli ngjyrë hiri. Mëngjesi po lindte.
Zoti shkonte mizor e dinak
me shikimin që depërtonte çdo gjë,
me shikimin që kërkonte gjithçka…

Kemi kaluar të gjithë nën Zotin
dhe i kemi qëndruar pranë.

SALVATORE QUASIMODO

DIMËR I LASHTË

Dëshir i duarve tua të zbehta
në gjysmerrësirën e flakës:
kundërmonin erë dushku e trëndafilash,
erë vdekjeje. Dimër i lashtë.
Kërkonin melin zogjtë
e mbuloheshin shpejt nga bora;
kështu fjalët:
pak diell, një rrezatim ëngjulli
e mandej mjegulla, dhe pemët
dhe na, të tejdukshëm në ajrin e mëngjesit.

PRAGU I PUBERTETIT

O natë e mbrojtur nga heshtja
Që tulat plogështi e dhimbje,
Mosha e trishtimeve dredhuese
Mugullon tek unë.
Te vetja shoh fëmijët të hijshëm
Ende të palindur,
Në pjerrësi të guaskave
Të turbullueme nga zëri im i ndryshuem.

TASHMË SHIU ËSHTË MES NESH

Tashmë shiu është mes nesh
Duke tundzitur ajrin e heshtur.
Dallëndyshet prekin ujrat e amullt
Pranë liqejve lombardë,
Kërcejne çafkat mbi peshqit e vegjël,
Sana kundërmon përtej gardheve të kopshteve.

Edhe një vit tjetër u dogj
Pa një ankim, pa një britmë
U ngrit një ditë të fitojë papritmas.

DITA – DITËS

Ditë në tjetrën: fjalë të mallkuara e gjaku
E ari. Ju njoh, njerëz, përbindësha
Të tokës. Në kafshimin tuaj ka rënë mëshira
Dhe kryqi i njerëzishëm na ka lënë.
Unë nuk mund të kthehem më në parajsën time.
Do të ngremë varre bregut të detit, mbi fushat e grisura,
Por asnjë sarkofag heronjsh.
Me ne më shumë se një herë ka luajtur vdekja:
Ndihej në ajr një rrahje monotone gjethesh
Si në shqopishtë kur zogu i kënetave
Ngrihet mbi re në erën e shirokut.

BORË

Zbret mbrëmja, përsëri na leni
Figura të shtrenjta të tokës, pemë,
Kafshë, njerëz të varfër, mbështjellë
Në kapota ushtarake, nana
Me bark të shterrun prej lotëve.
Si hënë, bora na shëndrit
Prej livadheve. Oh, këta të vdekun!
Rrahni ballin, rrahni deri thellë në zemër!
Të ulurojë së paku ndonjë në heshtje,
Në këtë rreth të bardhë të varrosurish!

TANI QË DITA PO NGRIHET

Mbaroi nata e hëna
Zgjidhet lehtë në kthjelltësi,
Perëndon ndër kanale.

Eshtë kaq i gjallë shtatori në këtë tokë
Fushnaje, livadhet janë të blerta
Si në luginat e jugut në pranverë.
Kam lënë shokët,
Kam mshehur zemrën mbas mureve të vjetra,
Për të mbetur vetëm kur t'ju kujtoj.

Oh, më e largët se hëna je,
Tani që dita po ngrihet
E mbi gurë rreh këmba e kuajve!

FREDERICO GARCIA LORKA

NJË PASION I MSHEHTË

Dielli është thyer
Mes reve të bakërta.
Vjen prej malesh të kaltra një erë plot tingllim.

Mbi livadhin e qiellit
Mes luleve të yjeve
Shkon hëna e re
Si një çengel i artë.

Nëpër ara (në pritje të rreshtave të njerëzve)
Shkoj i ngarkuar me vuajtje
Në shtegun e shkretë,
Por këndon zemra ime
Ëndrrën e rralllë
Të një pasioni të mshehtë
Në hapësirat pa fund.

GIUSEPPE UNGARETTI

VËLLEZËR

Prej cilit regjiment jeni
Vëllezër ?

Fjalë e dridhshme
Nëpër natë.

Gjeth i porsaçelur
Në ajrin e ndemë.

Revoltë e pavullnetshme
E njeriut të vetëdijshëm
Për brishtësinë e tij
Vëllezër!

SONTE

Parmakë puhize
Me mbështetë sonte
Trishtimin tim.

Vlerat aktuale në një studim madhor mbi gjendjen kishtare në Kosovë në mesjetë

SERBËT NDËRTUAN KISHAT E TYRE SIPËR THEMELEVE TË KISHAVE KATOLIKE SHQIPTARE NË KOSOVË

Një vështrim analitik mbi librin studimor të dr.sc. Besim Morina " Gjendja kishtare në Kosovë në periudhën paraosmane shek. VII-XV", LB, Prizren, 2020

Nga Fatmir Minguli

Sapo doli nga botimi në vitin 2020, libri i dr. sc. Besim Morinës mbi një problem tejet delikat, një problem i parrahur mirë më parë, atë të gjendjes social-kishtare të mesjetës, mendoj se ishte një ngjarje në botën shkencore jo vetëm për Kosovën, por për gjithë trojet shqiptare.

Ky libër ka vlera unikale, dhe patjetër është një botim në rrjedhë të botimeve të prof. dr. Jahja Drançollit e disa studjuesve të tjerë. Dr. sc. Besim Morina ka patur një guxim të tejskajshëm që ka marrë përsipër botimin shkencor të këtij libri.

Pse e them këtë? Sepse jo vetëm në Kosovë por edhe në Shqipëri të pakta janë botimet për jetën sociale të mesjetës.

Duke qenë se vetë jam marrë me një temë mbi problemet social- ekonomike të periudhës së shekujve IX- XV të, e konkretisht për periudhën e ikonoklastisë në trojet shqiptare, leximi dhe studimi i librit të Besim Morinës "Gjendja kishtare në Kosovë në periudhën paraosmane (shekulli VII- XV)" më erdhi si një burim të dhënash të jashtëzakonshme për studimin tim.

Për aq më tepër që ky studim i tij është shkencor në kuptimin më të mirë të kësaj fjale:

Ja si shprehet vetë Besimi në parathënien e librit të tij për arritjen e vlerave shkencore:

" Për hartimin e kësaj teme, nga burimet historike, kemi patur mundësi t'i shfrytëzojmë vetëm burimet e botuara, qofshin ato në origjinalë ose të përkthyera. Gjatë punës, jemi munduar që të bëjmë një vlerësim kritik, duke arritur në konkludime të rej që janë të një rëndësie të veçantë për problematikën në fjalë."

Ky libër i ndarë në katër kapituj trajton në më të mirën e mundshme problemet e fillimeve të krishtërimit, analizën për kishën e Kosovës përballë pushtuesve njemanid dhe kishat shqiptare përballë pushtimeve osmane. Besim Morina e përfundon librin e tij me një kapitull shumë delikat siç është paraqitja e mësimeve të shtrembëruara dhe qëndrimi i përfaqësuesve të kishës shqiptare. Ky kapitull përmbyllës dëshmon vlerat e mëdha, sinqeritetin e autorit dhe forcën e mendimit të tij.

I gjithë libri "Gjendja kishtare në Kosovë në periudhën paraosmane (shekulli VII- XV)" është një kompleks i plotë i ekuilibrit mes mendimit të autorit dhe literaturës referuese. Eshtë ky ekuibër që e bën këtë libër mjaft tërheqës, dobiprurës dhe një themel ku mund të ndërtohen "shtëpi" të tjera të mendimit origjinal shqiptar.

S'ka si të jetë ndryshe! Autori që në fillim e përkit temën me problemin e studimeve serbe, duke na sqaruar se ky libër kundërshton shkencërisht teoritë e sajuara të historianëve serbë e pansllavë mbi jetën e shqiptarëve të Dardanisë e më gjerë.



Ja se si e shtejllon fare pastër dr. sc. Besim Morina këtë problem që në parathënie të librit të tij:

" Meqë, territori i Kosovës së sotme, ishte nën sundimin serb, historiografia serbe me tezat e saj pseudoshkencore, bëri çmos që me botimet e saj të shumta në gjuhën serbe dhe në ato të huaja, të "dëshmojë" se ky territor i takonte shtetit serb, madje që nga koha e dyndjeve barbare sllave".

Këtë fakt e mbështet katërcipërisht edhe Mr. sc. Nue Oroshi në analizën e tij "Gjendja kishtare në Kosovë në periudhën paraosmane (shekulli VII- XV)" një libër që zbulon shumë të vërteta historike për mbijetesën e kishës katolike në Kosovë" botuar në blogun "Zemra shqiptare":

"Këto studime që jep studiuesi Morina tregojnë qartë se kishat iliro-shqiptare ishin përvetësuar nga serbët dhe më pas i kishin përshtatur në stilin e tyre kurse sot serbët bëjnë politikën e tyre shtetërore me kishat tona që na i kanë përvetsuar."

Ky libër është një burim i madh të dhënash për jetën kishtare të Kosovës në periudhën e mesjetës. Këto burime duke u lidhur dhe me të dhënat për kohën mesjetare të Shqipërisë, pjesës jugore të Epirit (Çamëria) dhe të Maqedonisë me toka shqiptare e pa harruar tokat shqiptare të Kroacisë, përbëjnë një pamje të plotë të jetës së shqiptarëve ashtu siç ka qenë dhe jo si e shkruajnë sllavo- grekët.

Besim Morina në këtë libër na vërteton atë ç'ka konstatuar mesjetologu i njohur Zhak Lë Goff, në librin e tij "Njeriu i mesjetës" se " Liria është një vlerë e vjetër e njeriut të mesjetës, shpirti i revoltave të tij kryesore, ku kisha, paradoksalisht jep sinjalet […] Por njeriu i mesjetës do të mbetet në kufizimet e kësaj lirie duke e quajtur si një tokë të premtuar, pas një proçesi luftarak të reformave, të progreseve gjithmonë të pakryera."

Duke i kaluar kapitujt njeri pas tjetrin, në librin " Gjendja kishtare në Kosovë në periudhën paraosmane (shekulli VII- XV) " do të ndeshesh pikërisht me këto konstatime të luftës për liri të popullit shqiptar të Kosovës e deri sa të vish te shpallja e pavarësisë së Kosovës në 17 shkurt 2008, do të kuptosh luftën që populli i Dardanisë ka kryer shekuj me radhë.

Jo më kot, autori i mëshon termit gjeografiko- politik të Ilirikut, kësaj treve aq të madhe sa që edhe sot i trondit, në mos i tremb ish pushtuesit e këtyre trevave. Dokumentat burimorë që ka marrë autori dhe i ka sjellë në mënyrë konstruktive në libët i rrisin për së tepërmi vlerat shkencore. Të tilla janë emrat e njerëzve dhe toponimet e shumta në gjuhën shqipe, cka është e vërtetuar nëpërmjet shembujve konkretë. Kjo e gjallëron librin.

Jo vetëm ky fakt është gjallërues i këtij libri por dhe regjistrimi i kishave në kronologjinë dhe gjeografinë përktatëse e kthen pamjen e librit në një hartë virtuale të kishave, manastireve dhe shenjtoreve të krishtera në tokën e bekuar të Dardanisë. Dhe jo vetë kaq, por autori na sjell jetën e këtyre monumenteve të historisë shqiptare

deri në ditët tona, natyrisht të shoqëruara me faktet përkatëse.

Për Besim Morinën ka shumë rëndësi jeta e sotme e shqiptarëve, andaj ai i kushton rëndësi të madhe, madje me përgjegjësi shkencore ndikimeve pushtuese që nga Nemanja e serbët të të gjitha periudhave.

Dhe vlen për t'u përmendur dhe konstatimi që studjuesi i ditëve tona Dilaver Goxhaj mbi veprimet shkatërruese të serbëve të sotëm ndaj monumenteve të kultit të besimit mysliman, ku populli i Kosovës ka besuar ndër shekuj. Në këtë konstatim që është një përgjigje për shpifjen e ministrit të jashtëm të Serbisë, Nikolla Selakoviç, thuhet:

" I them këtij zotërie, nëqoftëse Ushtria Çlirimtare e Kosovës do të kishte atë lloj urrejtje, atëhere nuk do të digjte gjatë luftës dy vjeçare çlirimtare ndëretnike, 1997-1999, një apo disa kisha e manastire ortodokse, por kishte mundësi t'i digjte të gjitha ato objekte kulti mbasi nuk ia ndalte kush dorën, do të vepronte në shenjë hakmarrjeje ndaj akteve të tilla barbare që bëri policia dhe ushtria serbe që dogjën dhe shkatërruan në Kosovë plot 218 xhami dhe të gjitha teqetë bektashiane, pa përjashtim."(Gazeta "Veterani", nëntor 202,nr. 11, në artikullin "Serbët dogjën në Kosovë 218 xhami dhe të gjitha teqetë bektashiane.")

E solla këtë konstatim real për të treguar vlerat e punës së bërë nga dr. sc. Besim Morina në këtë libër të tij. Por është fakt i pamohueshëm dhe ndërhyrja e shëmtuar e serbëve mbi monumentet e kultit të krishterë shqiptar. Këtë konkluzion të nxjerrë nga libri i dr. sc. Besim Morinës e jep dhe prof. dr. Qerim Dalipi në recensionin e tij:

" Duke ballafaquar prurjet historiografike, burimet historike dhe rezultatet e zbulimeve arkeologjike, autori vjen në përfundim se kisha ortodokse serbe përvetësoi kisha ë mocme iliro-shqiptare, duke ndërtuar dhe rindërtuar mbi to, që nga shekulli XIII, duke vazhduar në periudhën e sundimit osman, të Mbretërisë Jugosllave, deri në shkatërrimin e Jugosllavisë. Mund të vecohen këtu manastiri i gracanicës që u ndërtua në vend të një kishe të vjetër dhe manastiri i Shenjtorëve Mihail e Gabriel që u ngrit mbi themelet e një kishe dardane të krishtërimit të hershëm etj. Ndërkaq kisha e mnastirit të Deçanit është ndërtuar nga shqiptarët dhe në të ka elemente të ndërtimtarisë shqiptaro- dalmate."

Edhe pse harku kohor studimor është periudha që nga koha apostolike e Ilirisë deri në kohën e pushtimit osman, libri në mënyrë sugjestionuese sjell në mendjen e lexuesit bëmat e ditëve tona jo vetëm për Kosovën por dhe për ato politika të mbrapshta në ditë tona lidhur me bashkimin e trijeve shqiptare.

Ky është dhe qëllimi i këtij libri dhe nuk është aspak libër "ex catedra", por është i ndërtuar me shpirtin e atdhetarit.

Vlen të theksohet bibliografia e përdorur nga autori i librit "Gjendja kishtare në Kosovë në periudhën paraosmane (shekulli VII- XV) " është për t'u pasur zili, për nga numuri i pafund i autorëve më në zë që prekin çështjet e historiografisë së shqiptarëve.

Emrat e K. Biçokut, P. Bogdanit, E. Çabejt, J.Drançollit, Sh. Demiraj, K. Frashërit, L.Malltezit, Z. Mirditës, G.Ostrogotskit, A. Stipçeviçit, M. Shuflait etj, e nderojnë dr. sc. Besim Morinën për zgjedhjet e duhura për këtë studim tejet delikat mbi historinë e popullit të Dardanisë. Janë kĽto referenca tĽ pafund që e lejojnë autorin e librit të përballojë dallgët që ngrihen nga erëra të kundërta sidomos në çështjet religjioze. Besim Morina ia ka dalë me sukses!

Durrës 20 shkurt 2022

Trashëgimia kulturore shqiptare

KISHA NË CURRAJ TË EPËR, NË HISTORINË E VET 3 SHEKULLORE

Curraj Eper Bijët e Grimcit "e vodhën" truporën e Shna Noit, e shpetoi Kukeli nga shëmbja, po e përjetëson Skenderi me burrat e Currajve!

Nga Agron PREBIBAJ

Vërtetë në Curraj Eper, në prehërin e alpeve shqiptare kanë ndodhur momente të rëndësishme vetëvendosje e qytetarie si aristokraci parisiene, kjo në tre shekujt e fundit, ku bash aty dhe vetëm aty për në shqiptari është vëndosur e nga vetë ata gjithçka, pa pyetur kurrë krajli as mbret, të vëndosur në pushtetin e vet, ata ishin të vendosur mbi kokën e të gjithëve nga prej aty "për pak prekej edhe qielli".

Curraj Eper të Nikaj por të vëndosur më lart e për të qëndruar më fort se askush tjetër, provuan kapjen e majave të mire. Pikturuara nga Zoti të cilat do administroheshin nga njeriu vital e i vlefshëm përballë çetnikut i cili duhej përzënë.

Curraj Eper në etapën e vet tre shekullore vendosi veton përpara secilit, edhe përpara fisit të vet Nikaj, pastaj para gjithkujt që e kufizonte, e për pushtuesin nuk pysnin fare, vertetë indipedencë shqiptare.

Betaja e Curraj Eper matje në parakalim inteleg-jence, zgjuarsie e suksesi krahasuar me Napolonin, kjo nga fshati parcial shqiptar si fitues përballë gjithkujt, e përse jo parakalues të përendorisë Franceze të vetëdorëzuar.

Ndoshta ndonjëri mendon se krahasimi i Curraj Eper apo i Nikaj-Mërturit me Parisin e me Napoleonin janë anti-pode, por ç'është e verteta këta Francës së lirisë e dorëzuan Parisin për 10 minuta me një fenogram, ndërsa këta Curraj Eper të Nikaj-Mërturas, as nuk u shkoi ndermend të dorëzoheheshin, as të islamizoheshin, as të afrikanizoheshin, e as të prostanizoheshin e kurrë të judizoheshin.

Pa ju futur historisë Nikaj-Mërturase e mbushur më shumë me dhimbje sesa gëzime, po veçoj vetëm një memoment nga shpetimKryqëzata komuniste e cila vjen vetëm nga mendimtarët të cilët parakalojnë edhe Krishtin e livduem i cili u kryqëzua.

Bash aty në Curraj Eper në dhjetorin e vitin 1966 u hodhën shqiponjat për të mbrojtur shënjëtoret e për ti murosur.

Ishin djemt e Grimcit(Prebibaj), të udhëhequr nga Pali e Lleshi të mbrojtur nga Marku e Shani të cilët vëndosen "ta vidhnin troporen e Shna Ndoit së bashku me Kryqat" në Kishen e Curraj Eper e ta izolonin në muret e shtepisë së tyre.

Ndersa Ded Prel Prebibaj nuk kurseu vetën deri me letren e tij në Shkoder e Vatikan e deri në rreziqe për ruajtjen e e arkës me rrobat e priftit.

Por vrapimi komunist ndaj shëmbjes së Kishava nuk kishte ndalesë, e kjo erdhi në Curraj te Eper, bash aty erdhi Sekretari i Parë i Tropojës A. Kruja me sigurimin e shtetit, me qellim për të prishur Kishen e për të arrestuar burrat mendimtarë si Kukel Ndou etj.

Por aty ndodh mrekullia e shpetimit nga kryqëzata komuniste e burrave mendimtarë.

KISHA ZONJA MARIE

Ajo fjala e Kukel Ndout, e shpetoi Kishen e Shna Ndoit.

Pra fiks në fillim viti 1967 në mbledhje me burrat e Curraj Eper, udhëheqësi i drejtohet Kukelit: Partia ka vendosur për prishjen e kësaj Kishe, ti Kukel Ndou si mendon?

Ndersa Kukeli pasi kuptoi djallëzinë e udhëheqjes komuniste, u përgjigj,- partia ka vendosur ti shëmbë kishat, por kjo e jona mendoj të ruhet si qënder lufte e rezistence ndaj Serbo-Malazesëve,të shëndrrohet në shtepi kulture e zyra për pushtetin popullor.

Ashtu u miratua nga populli i Curraj pa u viktimizuar askush nga bluzat e zeza të cilët prisnin te dera urdhrin e arrestimit për secilen mëndje kunder.

Kisha e Curraj Eper e ndertuar në vitin 1897, erdhi nga vetë banorët pasi fshati u rrit numerikisht në popullsi, edhe largësia me Kishën e Nikaj, ajo u shëndrrua në shtepi sherbese para Zotit, i shpetoi shembjes nga sistemi komunist, u rihap në vitin 1991, u rikonstruktua sa për t'u mbajtur në këmbë nga Gasper Prebibaj e më vonë mirëmbajtja erdhi edhe nga djemt e Gjon Palit(Filipi, Arbeni, Nikolini e Paulin Prebibaj) e cila i mbijetoj ekzistencës.

KISHA RIKONSTRUKSION

Por zbrazja e fshatit e mos kujdesja e çoi në rrezik shembje këtë monoment të kultit e historik për Curraj Eper.

Por së fundi darka Londineze e disa djemve-burra të Curraj Eper të vendosur në Londer me kërkesën e Dr.Mhill Gecaj, ka konfirmuar mbeshtetjen financiare të rikonstuksionit të përjetësisë së Kishës së ndertuar nga të parët e tyre.

Kisha tashmë po rikontruktohet e cila në pranverë do i dorëzohet me force të përjetëshme e qëndrese Kishes Katolike shqiptare, gjithçka nën kujdesjen e kalorsëve Mhill Gecaj, Skender Perpepaj e Dom Simon Kulli, por kontributi financiar i ardhur nga atletët për shtëpinë e Zotit mundëson përjetësinë, e keta janë; Gasper Prebibaj, Mhill Prebibaj, Gegë Prebibaj, Skender Qokaj, Nikolin Vatnikaj, Besnik Vatnikaj, Fran Vukaj, Prel Adem Përpepaj, Agron Perpepaj, Skender Pepepaj, të cilët meritojnë urimin njerëzor, Zoti i bekoftë e jua shtoftë paratë.

Tashmë Curraj Eper nën lobigun e Skender Perpepaj është renditur e para në 15 fshatrat turistike për tu investuar, një sukses i madh që ishte mohuar duke mos u renditur as në 100 fshatrat turistike.

Ishte dhe vazhdon të jetë përkushtimi i djemve nismetar me shumë guxim në veprime e cila u pasua me financa për të mundësuar rrugën e makinës, rindertimin e shtëpive, kujdesi për objektin e kultit, e cila rikthen e jetesën në vëndlindje.

Përmbledhja poetike e Kadrush Radogoshit, "Liria ishte vetëm një ëndër", Kanada 2022

UDHËTIM I PAHARRUESHËM PËRMES KAOSIT, ERRËSIRËS DHE ÇMENDURISË DREJT DRITËS

Nga Richard Davies*

Përktheu nga anglishtja: Dr. Mujë Buçpapaj

KULTURË

Një Orfe i Edmontonit

Richard Davies

Kadrush Radogoshi

Kadrush Radogoshi, poeti i mirënjohur dhe shumë i nderuar shqiptar me origjinë nga Kosova, që tani jeton në Edmonton (Alberta, Kanada), përjetoi tmerret e luftës, që nisën me pushtimin e Kosovës nga diktatori Slobodan Millosheviç. Ai, si shumë nga bashkëqytetarët e tij dhe bashkatdhetarët e guximshëm, përjetoi shtypjen e lirive civile, dhunën sadiste dhe burgosjen e padrejtë, të gjitha këto ndryshuan përgjithmonë mënyrën se si ky profesor-poet prej kohësh e shikonte vendin e tij nën të këqijat e autokracisë, autoritarizmit, dhe aparteidit.

Për fat të mirë, Radogoshi i mbijetoi asaj, që ai e ka përshkruar si "Sodoma e ringjallur ose Ferri i Dante Aligierit" në përmbledhjen poetike "Liria ishte vetëm një ëndërr" dhe pavarësisht nga të gjitha vuajtjet, ai më pas qe në gjendje të shkruante me elokuencë dhe pasion për këto kohë brutale dyzet e katër nga poezitë e këtij libri të titulluar "Liria ishte vetëm ëndër", të cilat fillimisht u shkruan dhe u botuan në gjuhën e tij amtare, ndërsa tani atyre iu bashkohen edhe 12 poezi të reja, të shkruara së fundmi (2020-2021) në shtëpinë e tij të re e të ngrohtë kanadeze në Edmonton.

Kjo përmbledhje e re dhe e angazhuar poetike fillon me një poezi-prolog për miqtë e tij poetë (në tanishmen edhe në të kaluarën) me një aludim për Platonin, i cili i përzuri poetët nga "Shteti ideal" i tij për arsye politike për të kufizuar të drejtat dhe liritë e individëve, të cilët kundërshtojnë dhe për të penguar kritikat e tyre, ashtu siç bëri vetë Millosheviçi duke filluar nga viti 1989. Poezitë e këtij libri zbulojnë një konflikt thelbësisht politik midis forcave sodomike ose apokaliptike dhe një republike poetike më të drejtë dhe ideale, të bazuar në lirinë dhe humanizmin. Janë këto dy vizione dhe këto dy botë, që përplasen apo përleshen në mënyrë të vazhdueshme në dyzet e katër poezitë e hershme të përmbledhjes poetike "Liria ishte vetëm një ëndërr", meqenëse Millosheviçi iu kundërvu dhunshëm popullit të qytetëruar shqiptar dhe kulturës së tij, të cilin e sundoi dhe e shtypi pamëshirshëm.

Dyzet poezitë e para të këtij libri poetik dolën drejtpërdrejtë nga konfliktet e mësipërme dhe u vendosen në perspektivë nga këndvështrimi më i gjerë i Radogoshit për kulturën dhe qytetërimin perëndimor, pasqyruar në aludimet e tij të shumta nga Bibla, mitet greke, Komedia Hyjnore e Dantes dhe historia. Ai gjithashtu aludon për shumë njerëz të famshëm dhe personazhe letrare si Homeri, Laokooni, Centauri, Prometeu, Platoni, Sokrati, Galileo, Macbeth, Iago si dhe për vende si Sodoma, Troja, Ferri dhe Guernika, poqese duam t'i përmendim disa nga më të spikaturat. Me gjithë këto referenca të zgjedhura me shije, Radogoshi dokumenton me sukses tragjeditë e vendit të tij në kontekstin e qytetërimit dhe historisë perëndimore.

Gjithashtu, po aq të shquara janë poezitë "Një pendim publik", "Një konflikt" dhe "Izolim" nga takimet e tij personale me të këqijat e regjimit të Millosheviçit, që e kërcënuan jetën dhe karrierën e tij si poet. Udhëtimi i tij poetik përfshin gjithashtu referenca prekëse nga familja e tij (gruaja, vajzat, motra e madhe, babai dhe nëna, e të tjerë). Për më tepër, në mënyrë efektive, ai fokusohet në viktimizimin e grave në kohë lufte, pos bukurisë, dashurisë dhe mësimeve të jetës së tyre.

Poezitë e tij të fundit në këtë përmbledhje kanë të bëjnë gjithashtu me përshtatjen e tij me jetën pas Kosovës dhe atë që ai ka mësuar në planin afatgjatë për bukurinë, të vërtetën, drejtësinë, mbijetesën personale dhe përballjen me vdekjen. Radogoshi ka më shumë se të drejtë për të gjitha këto epifani; ai ka paguar prej kohësh detyrimet e tij si studiues, poet i dashurisë, poet politik, luftëtar lirie, familjar i devotshëm dhe kërkues i sinqertë dhe i vazhdueshëm i së vërtetës dhe mençurisë.

"Liria ishte vetëm një ëndërr" është një udhëtim i gjatë, por i paharrueshëm përmes kaosit, errësirës dhe çmendurisë drejt dritës, një lirie të merituar dhe, së fundi, paqes së mendjes. Libri është një kujtesë për të gjithë lexuesit sot se çfarë ndodhë, kur errësira vendos dorë mbi dritën, si dhe mbi gjithçka, që është e mirë në jetë, e cila vazhdon ta kundërshtojë duke mbijetuar pavarësisht nga forcat e pandërgjegjshme të së keqes.

Edmonton, 17 shkurt 2022

*(Autori i këtij shkrimi është poet i shquar kanadez, kritik dhe historian i letërsisë, kitarist dhe kantautor.)

Kadrush Radogoshi: Freedom Was Just a Dream, 2022

A MEMORABLE JOURNEY THROUGH CHAOS, DARKNESS AND MADNESS TOWARD LIGHT

By Richard Davies,
Canadian poet, essayist and literary critic

Kadrush Radogoshi, the well-known and much-revered Albanian poet originally from Kosovo now living in Edmonton, Alberta, Canada experienced the horrors of war that begin with Kosovo's takeover by the dictator Slobodan Milosevic. He, like so many of his fellow citizens and brave compatriots, endured repression of civil freedoms, sadistic violence, and unjust incarceration all of which changed forever the way this long-time professor-poet viewed his country and the evils of autocracy, authoritarianism, and apartheid.

Fortunately, Radogoshi survived what he has described as a "resurrected Sodom or Dante Alighieri's Hell" in the poetry collection Freedom Was Just a Dream. And despite all he suffered, he was subsequently able to write eloquently and passionately about these brutal times--44 of the poems here were originally written and published in his mother language and now joining them are 12 new poems written recently (2020-2021) in his new Canadian home of Edmonton.

This engaging new collection begins with a prologue poem to his poet-friends (both present and past) with an allusion to Plato out poets from his "ideal state" for political reasons to limit the rights and freedoms of individuals who drove and to thwart criticism (much as Milosevic himself did beginning in 1989). The poems in this book reveal an essential political conflict between sodomic or apocalyptic forces and a more just, ideal poetic republic based upon freedom and humanity. It is these two visions and worlds which repeatedly clash in the early poems of Freedom Was Just a Dream, much as Milosevic opposed the civilized Albanian people and culture he ruthlessly ruled and oppressed.

The first 44 poems arose immediately from the above conflicts and are put into perspective by Radogoshi's larger view of Western culture and civilization, reflected by his many allusions from the Bible, Greek myths, Dante's Divine Commedia, and history. He also alludes to many famous people and literary characters such as Homer, Laocoon, Centaurs, Prometheus, Plato, Socrates, Galileo, Macbeth, and Iago as well as to places like Sodom, Troy, Inferno, and Guernica, to name several of the more prominent. With all these appropriate references, Radogoshi successfully documents his country's tragedies within the context of Western civilization and history.

Equally remarkable, though, are the poems such as "A Public Repentance", "A Conflict" and "Isolation" from his own personal encounters with the evils of Milosevic's regime which threatened his own life and career as a poet. His poetic journey also includes poignant references to his family (wife, daughters, elder sister, father and mother, and others). Moreover, effectively, he focuses on the victimhood of women in wartime, in addition to their beauty, love, and life teachings.

His last poems in this collection are also about his adjustment to life after Kosovo and what he has, in the long term, learned about beauty, truth, justice, personal survival, and facing death. Radogoshi is more than entitled to all these epiphanies; he has long paid his dues as a scholar, a love poet, a political poet, a freedom fighter, a devout family man, and a continuing sincere seeker of truth and wisdom.

Freedom Was Just a Dream is a long but memorable journey through chaos, darkness, and madness toward light, a well-deserved freedom, and, finally, peace of mind. The book is a reminder to all readers today of what happens when darkness gets the upper hand on light as well as all that is good in life that persists against and survives despite the unconscionable forces of evil.

Edmonton,
February 17, 2022

NA ISHTE NJË HERË NJË UJK

Tregim nga Mehmet Elezi

Nata e tretë që e dëgjoja. Kum-kum. Natën e parë vinte e mekur. M'u duk se ngjitej grykës së përroit. Bashkë me trishtimin e një nate vjeshte. Kum-kum. Kumbonë është kjo? Ç'ne kumbonë në këtë orë të vonë. Dhentë e kooperativës janë në stallë, ngujuet. Tjetërkush s'ka gjë të gjallë. Mbase ushton ahishta? Nuk mund të jetë ahishta. Ushtima e pyllit nuk vjen me shkëputje. Qita kryet në dritare. Terri i lagët lëshohej si brymë. Hënë kish e s'kish. Qielli mbuluar me lëpë të kujtonte napat që kullojnë qumështin. Prapa lëpesë hutohej një hënë e verbët, petë dylli. Drita qe trusur brenda saj.

Më kanë bërë veshët?

Natën tjetër u dëgjua më fort. Afrohem te dritarja. Hëna kësaj here e bardhë, si pshere djathi. E zgrapsur sa grima në skaj. Kum-kum. Dhe pushim. Dhe prapë kum-kum. Mbase janë zhurma, i shkapet shkëmbi mbi përrua. Është ndonjë shpellë që i mbledh, si guackat që mbledhin zhaurimën e detit. Apo janë krisma, i sjell gryka e përroit, kushedi prej kah? Si djalë qyteti, nuk ia njoh trillet malit. Gryka e përroit nxinte. Ham-ham, u gjallërua një qen matanë. Kumbona meni, nata ra fashë.

Qetësi rrenësh, kumbona kërciti rishtas. Iu përgjigj një qen me zë të trashë, samurr stani. Dhe dy-tre të tjerë me zë më të hollë, si për t'i dhënë zemër mos u tut, na ke edhe ne. Ndoshta po më lëviz shtypja e gjakut. Prej saj uturojnë veshët.

Hapa dosjen me etyde, merrem me to në fundjavë. Ditëve të javës u mësoj fëmijëve vizatim e punë dore, jap edhe botanikë e histori, me plotësue numrin e orëve. Ku je Da Vinç, e shpotita veten, pikturë e fizikë bashkë. M'u kujtua Zisoja, praktik siç është. Budalla, askush në moshën tënde s'ka hapur dy ekspozita në Tiranë, si ti. Nuk të lënë atje, talentet u duhen, veç thirri mendjes. Bëj ca skica koperativistesh të lumtura, portretin e sekretarit të partisë e të ndonjë heroine të punës socialiste, botoji nëpër gazeta. Kështu ndreq biografinë. Mirë e ke ti Ziso, për vete i ke punët grurë. Ngrohtë në televizion, ohoho.

Natën e tretë kumbona plasi fort, nuk mund ta shpërfillje. Kum-kum, kum-kum. Thua një përçor, kapreç bridredhur, po i printe tubës në kullotë. Përjashta errësirë e thellë, erë e lagësht, ahishta përkundej. Qeni me zë të trashë, që kish lehur një natë më parë, u trenua. Pas tij të tjerët. Diçka u rrëzua e u thërmua në oborr. Çka kërciti ashtu? Nata është e mbushur me gjithfarë fshehtësish, të vogla e të mëdha. Gjëmimi i kumbonës ndihet krejt ngjat. Qentë u çartën duke lehur. Më duket po çartem edhe unë, çfarë kumbone mund të rrahë në këtë orë të natës? Veç në qoftë vetë qoftëlargu.

Deri vonë nuk mbylla sy. Më dukej se dikush ngjitej dhe rrahte kumbonën te dritarja. Në një vend të panjohur të duket i dyshimtë edhe bari. U lehtësova diqysh, kur ndërmenda se kthina ime është në kat të dytë.

Në nesret e diel, aksion me korrë kallamboq. Katundi është rreth malit, arat e pjerrëta mbillen me një misër të vogël, të verdhë, farë vendi. Mbërrij me të parët. Brigadieri po gazitej me dikë. U dëgjua sonte andej nga ju? Lere, lere, harboi Arushi im, tha tjetri. Hidhej në verigë, lehte sa i hanin mushkëritë. Gallatë e madhe. Edhe atij përdreqanit, si i polli mendja ashtu. Për punë të verdha është i vetmi.

I përshëndeta, mora draprin që më dhanë, vura re se i lëvizte bishti, nuk bëzana. Jam rishtar këtu, nuk i njoh, nuk më njohin. Fshatarët janë kur i do të çiltër, kur i do dinakë. Flasin me rrotulla, të venë në lojë. Le më kur e ke mizën nën kapuç, si puna ime. Biografia, mushkëritë me hije. Këtu m'i dinë të tëra, sigurisht. Para se me ardhë unë, ka mbërri dosja ime. E qëndisur hollë.

Të hënën çohem herët, peshqirin krahëve dhe mësyj përroin. Akuarel mahnitës, eci si nëpër ëndërr. Udhëza e hollë përvidhet shpatit, përmes ahave të lagur vjeshtakë. Vende-vende shtruar me dushkun e kalbur të vjetëm, mbi të digjet ndonjë gjeth i verdhë, rrëzuar prej fërfërimës së natës. Një mjegull e brishtë ngjitet me përtesë grykës, cukla-cukla, si e përdhunuar. Ndalet dhe ve buzët mbi ujë. Mjegull je a pelë e lëbardhme, që të ka tharë etja?

Shpejtoj hapin, duke rrotulluar krahët me shpejtësi, për me u nxe.

Nuk u besoj syve. Mbas një trungu me myshk, turiri i një ujku. Nuk lëviz, rri si i shituar. Veshët curr, ujk hesapi. Shpina e përthime. Vetëm sytë ndryshe. U lëviz drita, sikur don me shqiptue diçka.

Ujk kaq afër shtëpive? Dhe pasi ka çelë drita? Pa e prishur fare terezinë?

- Mirëmëngjes, ujk!

Desha me i thanë hapu, ma ke zënë udhën. E di se ujku i tutet njeriut. Gjithsesi sjellja e tij po më dukej e çuditshme. Mos është ujk i çartur? Ata nuk pyesin. Tërbimi është më i lig se vdekja. Boll një jargë me ta lëshue!

- Jam pa hangër, thotë ujku. Dhe s'kam asnjë shpresë.

- Me mua kot e ke, i them. Nuk shuan dot uri me mua. Unë të vras në vend.

I mëshoj zërit trimërisht. Ani pse një tjetër zë, më i ulët, në fellutat e qenies, thotë të kundërtën. Dashtë Zoti s'ke mendje të keqe, se nuk të bëj dot gjë, o ujk, thotë ky zëri tjetër, në zgafellat e qenies. Në dorë kam një sapun e një pastë dhëmbësh, kaq janë armët e mia. As një shkop a gur rroshatak s'po më kap syri përreth.

Nuk thonë kot pushka e zbrazët tut dy burra. Atë që e mban, se e di se s'ka fishek brenda, dhe tjetrin që i drejtohet, se ai kujton se është e mbushur. Unë isha pushkë e zbrazët. Ujku këtë s'e dinte, pra mund ta trembja.

- Prandaj jam kah pres këtu, thotë ujku. Mbase të mbushet mendja e më fut një kokërr plumbi. Një plumb kish me më shpëtue. Këqyre si jam katandisur, zhele.

Tundi qafën e ligur. Vetëm atëherë ia pashë kumbonën në qafë. Kum-kum. Ushtoi ahishta.

Ujk, u bënë tri net që ma prish gjumin me atë dreq kumbone. Gjumin e gjakun. Ç'dreqin ke, mos jam në ëndërr?

Mjerisht nuk është ëndërr, thotë ujku. Jetoja në pyll, në botën time. I lirë. Në pyll nuk mbetesh kurrë pa hangër. Në dêjë nuk bëhet fjalë, por as në dimrat me borë. Gjuaj vetë, prenë e rrëmbej të gjallë. Nuk më pëlqejnë coftinat. Jemi racë krenare, vetë ju ia vini djalit emrin ujk. Ndihesha zot i malit, s'i druhesha kujt. Rrallë zbrisja në katund. Vatha ka qen, ka njerëz me pushkë. Më mirë gjuaj në kullotë të hapur. Aty i sheh e nuk të shohin, e sheston planin me nge. Rrëmben prenë e bëhesh tym në pyll.

Ujku prani, i bëri veshët curr. Nga suka matanë dikush i bëzani shokut, e ndiet sonte? He-he, ia ktheu tjetri, po i afrohet fundi.

Me mua e kanë, thotë ujku. Kanë hak. Qe natë e plotë, errësirë e lidhur nyje. Në këtë terr nuk del pa gjë, them. I afrohem një vathe bri përroit. Mat me sy hapësirën ndërmjet hunjve. Fort e ngushtë, as një këlysh, as një dhelpër mos me përbirue dot. Në një vend m'u dukën dy hunj pak më të larguar. Shti kryet mes tyre, thith barkun e bëhem petë, po, mund të kaloj! Qeni më heton. Leh çmendurisht, hov thikë përpjetë, gati me i këputë zinxhirët. Del i zoti e vikat. I jap trupit mbas, tërhiqu shpejt se e pate! Se si përdridhet huri, ngushtohet hapësira, më mbet kryet aty. Nuk bëj dot para as mbrapa. Bariu i shpejtë, ujk e shkuar ujkut edhe ai. Sa çel e mshel sytë merr një bigë të fortë e ma ve mbi qafë. I mëshon bigës, e ngul në tokë mirë, qafa ime nën të. I thërret dikujt, ma bjer një kumbonë. Atë të madhen, të ogiçit. Ta nderojmë, siç i ka hije një ujku trim.

Mendova se po përdorin gjuhë të fshehtë, të koduar. Do të ma këpusin kryet, duke më prerë në qafë me sakicë a me thikë, siç presin berrin për mish. Apo do të ma lëshojnë qenin me më copëtue së gjalli, siç bëj unë me prenë? Ndoshta kanë ndër mend me më zhgojue në hu, sa të më dalë shkuma e të jap shpirt. Mos u tut o ujk, thotë çobani, që m'i blen mendimet. Një qime s'kemi me ta heqë, po ta jap fjalën. Kam me të lëshue prapë në mal, si kokrra e mollës.

Nuk i besova. A ka besë me njeriun, që i kam ngrënë aq berre? Tjetër gjë se edhe mua më duhet me jetue. Kështu më ka bërë Zoti, mbahem gjallë dhe përtërij racën vetëm duke gjuajtur. Përndryshe shuhem, nuk bëj hije në fytyrë të tokës.

Qeni i kërthndezur çohet hucel, do me i këputë hekurat. Çobani ma mban fort qafën zënë nën bigë. E shoqja afrohet, ma var në qafë kumbonën. E përthekon fort në kllapë, mos me u shkoqë kurrqysh. Çobani heq bigën e ma mëshon me shuplakë vitheve. Mbathja tash o ujk, a të dhashë fjalën s'kam me ta prekë një qime?

U bëra erë.

Kumbona kum-kum. Në qafën time.

Jam i lirë në mal, por a është liri kjo? Barinjtë zënë pritë e ma veshin shpinës me hu të çarë, pse me e harxhue plumbin kot. Dhitë e egra e kapronjtë e ndiejnë kumbonën hejseku larg dhe bëhen erë mbi thepa. Më e rënda, kur tallen lepujt. E marrin vesh se po vi, hingrizen e ma qesin gjuhën pas. Një lepur i ri bënte thirrje ejani ta q… ujkun, të tërë me radhë. Edhe këtë mund të ma bëjnë lepujt tashti, pse jo. Unë po cof. Po jap shpirt, pa shti gjë në gojë. A më ndien kur marr frymë? Më fishkëllojnë brinjët si fisarmonikë e çarë. Po marr fund i uritur, i koritur, i fëlliqur. Na ishte një herë një ujk. Isha unë ky ujk, por nuk jam më ujk. A s'të ndodhet një plumb, me ma shkrepë në lule të ballit?

Veshët më kumbojnë prej kumbonës së ujkut.

Herë-herë prek qafën. Ruajna Zot, mos ma kanë varur edhe mua një kumbonë në këtë qafën time të hollë?

Na ishte një herë një u... unë!

18 nëntor 2016

Reportazh nga Athina

"UDHËTIM BRENDA VETES..."

Nga Kozma GJINI

Në dhe të huaj, besomë,
Zemra m'u mallëngjye,
Dërgomë një gur, dërgomë,
Ta vë jastëk në krye!...

Këto vargje të bukura e po kaq tronditëse të rilindasit, të cilat tingëllojnë aktuale edhe sot, më erdhën ndërmend, ndërkohë që miku im, botuesi skrupuloz i 'NACIONAL" e shkrimtari i mirënjohur, prof. Mujo Buçpapaj, me mirësjelljen që e karakterizon, gjatë bisedës, më nxiti që të sillja për gazetën ndonjë mbresë nga Athina. Pse jo. Atëhere u ula e sistemova disa episode me interes, ku lexuesi ka ç'përfiton, gjen njerëzit e tij në reportazh si dhe merr informacion.. "UDHËTIM BRENDA VETES..." Ka një motiv të qartë përligjja e titullit. Kjo lidhet me historinë e kaluar të arvanitasve (të mos harrojmë se historikisht, janë mbi 11 kryeministra grek me origjinë shqiptare).

Dhe historia përsëritet. Në vitet '90, vitet e shndërrimit të sistemit, djemt tanë, pa harqe e heshta, por me trasta në sup... iu turrën fqinjit jugor, jo për të rrëmbyer "Helenën e Trojës," por të etur për një korë bukë, për një jetë më të mirë... Dhe ata s'pyetën për mure piramidash, klone e tela me gjemba, por i shembën "muret" dhe e "pushtuan" Helenën... "Dyndjeve barbare" alashqiptare, fqinjët u hapën dyert me tërë zemërgjërësinë e tyre dhe koha do të tregonte se vetiu do të ndahej gruri nga egjra... Djemt dhe vajzat shqiptare do të bëheshin miq, krushq, vëllezër e motra me fqinjët grekë dhe me qytetarët e shumëkombeve që jetojnë në Greqi. Do të integroheshin shpejt, do të bëheshin edhe qytetarë me të drejta të barabarta si grekët. Kjo është demokracia. Se edhe vet fjala "demokraci", këtu e ka origjinën. "Shtet i popullit".

E pra, do të sjellim në këtë reportazh disa aspekte nga jeta dhe veprimtaria e emigrantëve, djemëve dhe vajzave tona në Greqi. Puna, dora dhe mendja e njeriut ka bërë mrekullira. Një rrugë e gjatë dhe e lodhshme, gjithsesi e bukur.Ura e Patrës është një mrekulli e tillë..Duke udhëtuar i sigurt me automjetin e drejtuar nga Fredi Kurti, marrim prej tij një opinion që përcjell një mesazh njerëzor.

-E ke problem të folurit gjatë kohës që ke në duar timonin?

-Jo, përgjigjet ai. Telefoni është i ndaluar...(!)

-Xhaxhai jot, në Lushnjë, kur drejtonte autobusin, pas shpine kishte një tabelë: "Mos i fol shoferit!".

-Xhaxhai dhe babai kanë qënë shofera në Shqipëri po ç'e do, mbetën fukarenj.

-Kjo urë e bukur cilët brigje lidh?

-Kjo është ura e Patrës. Lidh Veriun e Greqisë me Peloponezin. Këtu jemi në një gadishull.

-E keni mësuar mirë greqishten.

-Nga nevoja. S' kisha rrugë tjetër.U bënë 20 vjet duke udhëtuar me taksi në këtë rrugë vajtje-ardhje. Fillimisht kam punuar si kamarier dhe në punë të tjera, por pastaj kapa timonin. Tani do ta lë punën e do të shkoj pranë familjes, në Lushnjë.

Është mëngjesi i fresket i një dite të kthjellët shkurti.

Sintagma dhe Parlamenti. Sheshi kryesor i Athinës. Është i njohur botërisht ky shesh për mikpritjen e mijëra turistëve nga vende të ndryshme të botës. Këtu vazhdimisht, ditë e natë, vigjëlojnë dy roje, dy ushtarë të veshur me kostume popullore tradicionale helene, me pushkë në dorë, që më tepër i ngjajnë dy të rinjve për argëtim, se sa dy ushtarëve. Ata bëjnë një shërbim me orar të kufizuar dhe i ndërron çdo dy orë përgjegjësi i tyre. Pikërisht, çasti i ndërrimit të rojeve përbën edhe kuriozitetin e bukurinë kulmore spektakolare të ceremonisë. Ceremonia e ndërrimit të rojeve më shumë përcjell një mesazh paqësor, se sa ushtarak. Paqësor, sepse ata janë veshur me kostume popullore, paçka se në dorë mbajnë simbolikisht një armë. Ceremonia e ndërrimit të shërbimit të ushtarëve është magjia e tërheqjes së vëmendjes të sa e sa turistëve të cilët realizonin video apo fotografi pranë ushtarëve. Pas këtij demonstrimi të bukur ushtarak e artistik, ushtarët stacionohen te vendroja. Ulin pushkën me qytë tek maja e këmbës dhe marrin drejtqëndrim, kurse përgjegjësi kujdeset për pamjen e tyre dhe u rregullon uniformën, palët e fustanellës, kapelen, gërshetin e gjatë që varet pas deri në mes të shpinës, lidhëset e këpucëve, korrigjon largësinë e këpucëve që xhufkojnë në majë, kurse në taban kanë thumba hekuri që ta bëjnë më të bukur përplasjen në çimento.

... Athina është një qendër e rëndësishme administrative me vlera të spikatura: kulturore, artistike, arsimore, shkencore. Ajo e mori emrin Athina nga "Perëndesha e Luftës". Është e njohur botërisht për resurset e saj historike, për ndërtesat jo fort të larta, që janë një përshtatje dhe resistencës ndaj lëkundjeve sizmike. Kryeqyteti helen, është shumë i vizituar nga turistët. Kjo është një industri mjaft fitimprurëse për vendin.Sipas regjistrimit të vitit 2013, në Greqi jetojnë 10.815 197 banorë. Vendi ka një sipërfaqe prej 131.940 km katrore nga të cilat 130.800 km katrore sipërfaqe në tokë. Shqiptarët përbëjnë përqindjen më të madhe të të huajve që jetojnë në shtetin helen. Konkretisht, në Greqi jetojnë 480.824 shtetas shqiptarë, baraz me 57.2% të të huajve. 77% në zonat rurale dhe 22.9% në zonat urbane. Pas shqiptarëve vijnë: bullgarët, rumunët, rusët, pakistanezët, egjiptianët etj. Emigrantët shqiptarë që nuk kanë përfituar nënshtetësi greke, por që punojnë e jetojnë këtu, përbëjnë 4.4 % të popullsisë helene.Të kuptohemi: këtu nuk janë përfshirë shqiptarët që kanë marrë nënshtetësinë greke, apo mijëra të tjerë që nuk janë pajisur me dokumenta. Marrja e nënshtetësisë është një akt i rëndësishëm juridik, një tregues i virtyteve dhe vizionit që kanë djemtë tanë për Evropën.Kalohet përmes filtrave. Të dalësh nga një sistem izolimi totalitar dhe të fitosh të drejta të barabarta me shtetasit evropianë e pastaj të udhëtosh i lirë nëpër Evropë, nuk është e lehtë.

E diel. Ndodhemi për një vizitë në shtëpinë e familjes korçare "Anastasi". Shtëpia e tyre është mobiluar sipas stilit korçar, ku nuk mungon dora e gruas me dantella e qilima prej Korçe. Zjarri bubulak i oxhakut ngroh krejt mjedisin e shtëpisë, kurse dy djemtë e tyre luajnë shah e flasin ngadalë në gjuhën shqipe."Djemtë kanë lindur në Greqi dhe mësojnë e shkojnë shumë mirë me mësimet në shkollë", thotë mamaja e tyre. Silva do të kërkojë punë, sepse jeta nuk përballohet dot kur punon vetëm njëri nga familja. Kur e pyesim, a ka mall për Shqipërinë, ajo thotë: "Malli më djeg, paçka se isha në Korçë një muaj gjatë verës". Ndërsa pyetjes, a mund të kthehen një ditë e të jetojnë në Shqipëri, ajo përgjigjet: "Në Shqipëri do të shkoj, se atje kam njerëzit e mi, por s'jam e sigurt për të ardhmen. Presim të marrim pasaportën greke dhe më shumë mundësi ka të shkojmë në ndonjë vend evropian... S'kemi kohë për të humbur, se fëmijët duan një jetë më të mirë e më të sigurt.Kështu bën tërë bota.Nuk e shpikëm ne këtë tendencë".

Është vlerë e kulturës sonë qytetare të dëgjosh se shqiptarët janë bërthama e inteligjencës, e punëve, e rezultateve në shkollë, apo veprimtarive private. Ndjehesh krenar, kur shikon që në një ekspozitë madhështore ndërkombëtare në Athinë, piktori i talentuar fierak, Rafael Gremi, përfaqësohet me disa punime dinjitoze e të lakmuara. Ai ka marrë disa porosi prej shumë miqve dhe e gëdhin duke punuar me penelë në dorë, me qëllim që të realizoj dy gjëra: pikturën në kohë dhe të ardhurat për familjen. Rafaeli tregon: "Janë disa piktorë shqiptarë që marrin pjesë në këtë ekspozitë ndërkombëtare. Konkurenca është e madhe dhe që të arrish të futesh deri këtu, është e vështirë. U ka dashur punë, lodhje, sakrificë, por kënaqësia është e madhe, kur mes artistëve botërorë, gjendemi dhe ne shqiptarët."

"Djemtë shqiptarë janë shumicë dhe mbeten shtylla të ndërmarrjeve greke". Është bindëse ta dëgjosh këtë konsideratë nga sipërmarrësit e vendit. Ja si e shpreh vlerësimin e tij Jorgo, pronari grek i një ndërmarrjeje në Athinë: "Biznesin e kam hapur më 1999. 60 % të punonjësve e kam me djem nga Shqipëria, thotë ai. Jam shumë i kënaqur me punën dhe sjelljen e tyre. Në këto momente duhet të jenë 15-20 shqiptarë në punë, por gjatë periudhës 20-vjeçare numri i shqiptarëve të punësuar i kalon kalon 30-35 veta. Janë djem që komunikojnë dhe bashkëpunojnë. Po të ishte ndryshe nuk do të punonin me mua. Edhe ata ndjehen ngrohtë me pagën dhe me të mbajnë familjet"

-Nga cilët qytete të Shqipërisë i keni djemtë shqiptarë?

Kësaj pyetje Jorgo i përgjigjet me një theks e ngrënie shkronjash që ngjall humor, por saktë: "Janë nga Shkodra, |Lezha, Tirana, Lushnja, Fieri, Korca, Saranda..."

Tek bisedojmë me djem të njohur, te këmbët na qëndron motorin një tjetër djalë. Afrohet e takon me shokët. Quhet Almir Rr. " Babai im është nga Fieri, kurse mamaja është nga Divjaka, prezantohet ai.

Ka ndryshuar opinioni ndaj komunitetit shqiptar në Greqi. Nëse fillimisht kishte edhe të tillë që e prishën imazhin e vendit tonë, kjo i takon së kaluarës. Shqiptarët përbëjnë bërthamën e ndërmarrjeve greke. Sot grekët preferojnë të marrin të parët në punë çunat shqiptarë.Sa më shumë kalon koha, aq më shumë rritet përgjegjësia e shqiptarëve në frontet e punës dhe në familjet e tyre, aq më shumë rritet prestigji i vendit tonë. Ka rënë racizmi. Ndihet dukshëm edhe vlerësimi që na bëjnë vëllezërit grekë. Japim gjithë kontributin tonë për zhvillimin e vendit dhe të ardhurat tona i investojmë në të dyja anët. Shqiptari paguhet mirë, por bëjmë edhe punë të dytë. Kur do të punojmë, po nuk punuam tani që jemi të rinj?"

...Ja, tek shikoj një vajzë, një nënë të re që dallohej, sepse duke çuar për dore djalin në shkollë, i tha atij në shqip: "Ec shpejt, se na mbyllet porta e shkollës". Hyra në bisedë me të. Quhet Arta. Është vajzë nga fshatrat e Fierit. "Sapo jam kthyer nga Shqipëria,-tregon Arta.- Kalova mjaft mirë. Këtu kemi më tepër liri, po dhe në Fier u ndjeva mirë. Takova prindërit, vëllezërit e kushërinjtë.Me kushërinjt kishim shumë kohë pa u parë.Kisha mall dhe ata gjithashtu.Kishim një dasëm dhe nuk mund të mungoja. M'u bë qejfi që edhe fëmijët u kënaqën e kështu nuk harrojmë gjuhën e nënës. Në shtëpi ne komunikojmë në gjuhën tonë dhe pas nesh, gjuhën shqipe e kanë mësuar edhe fëmijët.Kam tre fëmijë. Vajza është në shkollën e lartë. Të tre fëmijët dinë të flasin e të lexojnë në gjuhën shqipe. Për të shkruar e kanë pak të vështirë.

-A ju shkon mendja të ktheheni një ditë në Shqipëri?

-Na pëlqen më tepër këtu se ka më shumë të ardhura, kushte pune e shëndeti dhe më tepër qetësi. Kemi marrë edhe dokumentat e qendrimit dhe tani mund të lëvizim të lirë. Shpresoj të na shkojnë gjërat më mirë."

...Takojmë edhe Panajotin, një mesoburrë serioz grek që jeton në pallat me shqiptarë e fqinjëron me ta. Ai ka ardhur për vizitë te Jani, një djalë nga Myzeqeja.Panajoti shprehet me kosideratë të lartë për familjaritetin e grekëve me shqiptarët në lagje e në pallat.

-Nuk do të doja fqinjë më të mirë, shprehet me dashuri e respekt për komshijtë shqiptarë ai.-Janë njerëz që shikojnë punën e tyre.

-Cila është shkalla e njohjes suaj për Shqipërinë?

-Shqipëria është një popullsi që ka lidhje gjaku me ne grekët. Kanë qënë fqinjë në shekuj dhe historikisht kanë shkëmbyer bukë e miqësi mes tyre, pavarësisht se në kohën e diktaturës kemi qënë të ndarë. Shqiptarët janë njerëz punëtorë e familjarë. Mua më lidh me Shqipërinë edhe një fakt tjetër, sepse gruaja ime është që nga Tropoja.

-E njihni mirë Shqipërinë, domethënë?

-Pak a shumë. Kam shkuar shumë herë në Tropojë te njerëzit e gruas.

-Ju banoni në një pallat ku ka edhe djem shqiptarë.-Cili është mendimi juaj për shqiptarët sot ?

-Janë njerëz të thjeshtë e pa qibër. Njerëz të respektuar, të drejtë, me sedër, punëtorë dhe që kanë fëmijë të mirë. Mbijetojnë ashtu si edhe ne."

x x x

Futemi në një lokal së bashku me familjen. Në një kënd të veçantë duken rreth 10 fëmijë të moshës

←

së ultë shkollore. Të gjithë ishin shqiptarë.Kur po këndonin këngën "Shumë urime për ty" në anglisht, greqisht e shqip, kuptuam se ishin grupim shqiptar që festonin ditëlindjen e një shoku të tyre. Alex mbushte 10-vjetorin e ditëlindjes dhe shokë e shoqe të shkollës, moshatarë të tij, bashkë me prindërit e tyre, kishin menduar të kalonin disa orë argëtimi, natyrisht dhe për t'u bërë qejfin fëmijëve. Ishin: Alex, Rajna, Gjito, Marina, Arta, Panajot, Jani, Olga...etj. Edhe nga emrat mund të kuptohen nuancat helene, si prioritet i ortodoksisë, fesë sunduese të vendit. Alex pret të mbarojë kënga e urimit dhe mbushet me frymë e i shuan qirinjtë e vendosur mbi tortën... kurse të gjithë fëmijët kullojnë sytë e mezi presin ndarjen e saj...

-Do të kishim në mes tonë edhe Marigo, thotë Marina, një vajzë me prindër nga Lushnja, por xhaxhi Arturit i doli llotaria amerikane dhe kanë ikur në Amerikë. Vajza e tij doli shkëlqyer në mësime, e para ndër gjithë nxënësit e shkollës së shumëkombësive, me pikë maksimale nga të gjithë mësuesit dhe komisoni i vlerësimit. Ajo ngriti flamurin në shkollën e saj dhe ky ishte një nder dhe për gjithë komunitetin shqiptar. Por një ekstremist nga Selaniku, në një televizion e kundërshtoi këtë trofe. "Nuk i takon të mbajë flamurin grek fëmija e një shqiptari që punon tokat e mija" tha para ekranit ai. Diversiteti pranohet, por rregullat i bëjnë institucionet. Dhe vajza shqiptare e fitoi dhe e ekzekutoi marshin me flamurin grek përpara shkollës."

E sollëm këtë mbresë për të treguar se fëmijët e shqiptarëve janë të aftë, të shkëlqyer e të gatshëm të matin njohurit dhe dijen me moshatarët e tyre kudo në Evropë. Dhe këta, kur i pyesim, nëse duan të kthehen në Shqipëri, përgjigjen, se kanë problem gjuhën, të folurit, shkollën. Kurse prindërit kanë tjetër qendrim: "Ata që janë bërë qytetarë grekë e kanë mendjen për të ikur në vendet e Bashkimit Evropian. Edhe pse askund nuk do ta gjejnë diellin dhe detin e Greqisë. Kurse prindërit e tyre shqiptarë: Taso, Silva, Ana, Janis, Rafaeli, Arta etj, shkëmbejnë një kafe në pritje të mbarimit të ditëlindjes së Alex.

Është mëngjesi i një dite të kthjellët shkurti. Sa herë që vizitojmë Athinën, do të vërejmë diçka të re: një rrugë të asfaltuar, një park lojërash të ri, një mjedis të pajisur me vegla gjimnastikore për të gjitha moshat... Rrugët e qytetit zhurmojnë nga lëvizjet e shpejta të automjeteve të shumta që udhëtojnë në destinacionet e tyre. Janë disa korsi për lëvizje dhe gjithçka të duket e sinkronizuar.Nuk shikon polic rrugës që të drejtojnë makinat, e kjo më kujton qytetet tona, ku policët më shumë ngatërrojnë e ngadalësojnë qarkullimin se sa e ndihmojnë lëvizjen.

Metroja e Athinës, kjo arterie hekurudhore e nëntokës që shkon në çdo skaj të qytetit, ka një orar perfekt, ku nisjet dhe qendrimet e trenave ndajnë sekondën, ndërsa qytetarët të ndërgjegjshëm, pa asnjë kontroll, fusin biletën në aparat dhe hyjnë në vagon. Ndërgjegja para dhe ligji pas. Rrallë kontrollohen biletat në vagon, por nëse gjendesh pa biletë, përgatitu për gjobën që varion sa dhjetëfishi i biletës.

Kush vjen në Athinë, duhet të ketë një arsye të fortë për të mos shijuar kënaqësinë që të jep vizita në "AKROPOL". Ai i përket trashëgimisë kulturore botërore dhe mbrohet nga UNESCO. Vështruar nga "Kodra e Muzave", Akropoli duket si i vendosur prej dorës së zotit në një sofër mbi supet e një kodre shkëmbore në lartësinë ekstreme të qytetit. Sa herë që shkoj për të vizituar Akropolin, kujtoj sheshin e vogël aty pranë, ku rrinte një vajzë, "nuse manekine", me vello të bardhë nga koka e gjer në fund të këmbëve dhe fytyrën të lyer me të bardhë e cila rrinte si të ishte një statujë, me dorashka të bardha, këpucë të bardha. Bardhësia vetë. Rreth saj mblidheshin gjithë kuriozitet turistët.Ajo rrinte si e ngrirë, madje edhe bebëzat e syve i ngulte në një pikë.Vetëm atëhere, kur dikush i hidhte lek në prehër, ajo lëvizte paksa, buzqëqeshte, falenderonte me një përkulje të kokës, pastaj menjëherë merrte pozicionin e mëparshëm të një statuje. Ishte një gjetje e bukur për të lypur dhe kjo më frymëzoi për të krijuar tregimin "Kalomira" të cilin "Nacional" e ka botuar qysh herët. Këtë rradhë nusja manekine nuk ishte në vendin e saj. Mbase ka gjetur ndonjë punë.

Një varg njerëzish të kombeve të ndryshme, ngjiten për në Akropol. Turizmi është një industri me leverdi për shtetin. Ka edhe shqiptarë mes tyre. Marrim biletën dhe futemi ne portë. Historia e Greqisë të duket se përmblidhet brenda mureve e nën rrënojat e kësaj pike turistike. Ciceroni ynë është piktori i talentuar fierak, Rafael Gremi. Ai jeton me familjen e prindërit prej tri dekadash në Athinë. Përpara nesh shfaqen godina të gurta, skulptura të personaliteteve mitike, shtylla që rilidhen prej arkitektëve për të ruajtur konstruktin origjinal. Turistët bëjnën foto e marrin kujtimet në video. Kalojmë nga një "pavijon" në tjetrin dhe Rafaeli na tregon për kultin e kësaj sofre shkëmbore apo rrënojat e saj, për Panteonin, ndërtesën historike më të famshme arkitekturore. "...Ka filluar ndërtimi i tij që në shek e II para Krishtit",-tregon Rafaeli. Kalojmë nga Parthenoni e Propilaja, te Erekteion e tempulli i Athinës, nga më të vjetrit e qytetërimit të botës...Interesante është godina ku tavani e çatia e saj mbahen nga 6 shtylla që janë njëherësh dhe skulptura perëndish.

Nuk mund të lija pa shkruar dy fjalë edhe për familjen e veçmas për fëmijët e Joanit. Marina është maturante, kurse Alex në ciklin e ultë.Të dy flasin shkëlqyer në shqip, shkruajnë e lexojnë rrjedhshëm në gjuhën e nënës. Është edukata prindërore.Në bibliotekën e vogël të familjes gjen edhe libra nga autorët shqiptarë: D. Agolli, S. Goliku, S. Spasse, S. Godo, F. Haliti, I. Bobaj, B.Çoku, N. Lera, E. Qerreti, G. Bushaka, F. Lamaj, K. Gjini etj. Pranë sheshit të Parlamentit na priste Fredi. Qindra turistë bëjnë foto e marrin video mes pëllumbave të cilët u qendrojnë njerëzve mbi supe, në duar, në kokë, pa kurrfarë frike.Dikush u hedh ushqim dhe ata me tërë ndjeshmërinë e tyre fluturojnë e bëhen grumbull krahësh për të marrë ndonjë kokërr grurë.Ndërsa ecim duke u kujdesur të mos shkelim ndonjë pëllumb, pyes veten dhe "Shoqatën e Kolombofilëve Shqiptarë" : "Po sheshi i Tiranës dhe i bashkive te vendit, a do të kenë një ditë të tillë pëllumba, simbolin e paqes?"

-0-0-0-

Në rrëfimin e gjatë "Ditari i Pandemisë" mbi gjithçka mbizotëron dashuria për kombin, për familjen dhe jetën



SHËNIME PËR LIBRIN E AGIM VINCËS "DITARI I PANDEMISË" (RRËFIME NGA KARANTINA)

"Ky libër është shkruar në llojin non-fiction (jo i trilluar), i përket atij lloji që më së shumti lexohet në ditët tona kudo nëpër botë, sepse libri i shkruar në formën e ditarit rrëfen të vërtetat e atyre 100 ditëve të kaluara në ngujim. Autori rrëfen ditë pas dite se çfarë ndodh në Kosovë në ato ditë kur krejt bota ka ndalur frymën për të përballuar coronavirusin."

Nga Meri Lalaj

Sapo mbarova së lexuari me një frymë librin e Agim Vincës "Ditari i Pandemisë" (Rrëfime nga karantina). Shumë e shumë vite më parë në Pogradec më pati rrëfyer doktor Misto Marko (Mirosh Markaj) pseudonimi letrar, shkrimtar e dramaturg se atje në anën tjetër të liqenit përballë nesh në fshatin Veleshtë të Maqedonisë jeton një poet me emrin Agim Vinca. Më dukej se po të rrija buzë liqenit as shiut përmasa tij ujore do të afrohej pak e nga pak dhe do shihnim poetin Agim. (E kishim aq afër dhe nuk e takonim dot). Pas viteve 1990, lexova poezitë e tij dhe në mendje më ka mbetur libri i tij poetik "Kohë e keqe për lirikën" si edhe një cikël me poezi kushtuar Parisit, të cilin ma dërgoi mua dhe e botova në shtypin tonë. Në vitin 1998, u ndodha në Strugë ku takova miken time këngëtaren e mirënjohur Fitnete Tuda, e cila më rrëfeu se Agimi ishte daja i saj.

Libri "Ditari i Pandemisë" (që ma dha për ta lexuar mikja ime Drita Harito-Lazri. (Për fat të keq librat midis Kosovës dhe Shqipërisë nuk qarkullojnë). Ky libër është shkruar në llojin non-fiction (jo i trilluar), i përket atij lloji që më së shumti lexohet në ditët tona kudo nëpër botë, sepse libri i shkruar në formën e ditarit rrëfen të vërtetat e atyre 100 ditëve të kaluara në ngujim. Autori rrëfen ditë pas dite se çfarë ndodh në Kosovë në ato ditë kur krejt bota ka ndalur frymën për të përballuar coronavirusin. Veçse Kosovës nuk i mjafton thjesht përfshirja në këtë luftë me sëmundjen infektive që ditë e për ditë shtrin përdhe shpirtëra njerëzorë, Kosova përfshihet edhe në një luftë të egër të pakuptimtë të njerëzve të paskrupullt të etur për pushtet, ata në vend që të zgjidhin hallet e popullit grinden porsi çakej kush e kush të zhvasë sa ë parë një karrige. Agim Vinca duke gërshetuar talentin e tij si poet e shkrimtar na e paraqet e përshkruan të kthjellët situatën politike dhe shëndetësore. Ndonëse libri i shkruar në një situatë kaq të vështirë mbart faqe pas faqesh optimizëm për jetën për të ardhmen sepse ashtu siç ka shkruar Rudyard Kipling tek poezia "Në qoftë se" "Të mbahesh fort kur nuk ke ku të mbahesh, përveç vullnetit që të thotë: "Mbahu fort!" Dhe në rrëfimin e gjatë "Ditari i Pandemisë" mbi gjithçka në këtë libër mbizotëron dashuria për kombin, për familjen, për Fluturën (bashkëshorten), për bijtë dhe nipat, për miqtë e dashur të botës letrare e të tjera. Gjuha e autorit është një shqipe e kulluar me përjashtim të disa fjalëve (por nuk duhet harruar se është një ditar i përditshëm shkruar për veten e vet). Libri përshkohet nga të gjitha ngjyrat e jetës nga të gjithë tingujt e saj dhe kur të lexohet ky libër në të ardhmen do të shërbejë si një pasqyrë rrëfimi për një kohë të pakohë kur njerëzit e deshën jetën edhe më fort.

NË PYLLIN E KUNDËRSHTIVE

Kumtesë Nobeli nga J.M.G. Le Clézio

Përktheu nga anglishtja: Zymber Elshani

7 Dhjetor, 2008

Përse shkruajmë? Marr me mend se secili prej nesh ka përgjigje në këtë pyetje të thjeshtë. Janë prirjet, mjedisi shoqëror, rrethanat. Shkurtimet në plotësuarjen e dëshirave poashtu. Nëse jemi duke shkruar, kjo tregon se nuk jemi duke vepruar. Se të përballur me realitetin e kemi gjetur veten në vështirësi, dhe kështu kemi zgjedhur mënyrë tjetër të reagojmë, mënyrë tjetër bashkëbisedimi, largësinë që jep siguri, kohën për përsiatje.

Nëse i shqyrtoj rrethanat të cilat më frymëzuan për të shkruar – dhe kjo nuk është thjesht vetë-kënaqësi, por dëshirë për saktësi – e shoh qartë se pikë nisëse e krejt kësaj ishte lufta. Lufta, jo në kuptimin e një momenti të veçantë të rrëmujës së madhe, ku ngjarjet historike, si fushata frënge në fushëbetejen në Valmy, janë rrëfyer nga dy krahët, nga Goethe në krahun gjerman dhe nga paraardhësi im François/Fransua në krahun e ushtrisë revolucionare. Ky moment duhet të këtë qenë moment plot me lavde dhe patetikë. Jo, lufta për mua është çka civilët e përjetojnë, së pari dhe para së gjithash fëmijët e vegjël. Lufta nuk më dukej kurrë moment historik. Ne ishim të uritur, të frikësuar, ndienim të ftohtë dhe kjo është e tëra.

Më kujtohet të kem parë si nën dritaren time trupat e Mareshalit Rommel iu ngjiteshin Alpeve, duke e kërkuar një shteg kalimi drejt veriut të Italisë dhe Austrisë. Nuk kam kujtesë veçan të ndezur të kësaj ndodhie. Sjell ndër mend, megjithatë, se gjatë viteve të cilat e përcollën luftën ne ishim nevojtarë të gjithçkaje, në veçanti të librave dhe letrës së shkrimit. Patëm mungesë të letrës dhe bojës së shkrimit. Bëra vizatimet e para dhe shkrova tekstet e para në shpinë të librave të racioneve, duke përdorur lapsin kuq e blu të marangozit. Kjo në mua la parapëlqimin e sigurt për letër të ashpër dhe lapsa të rëndomtë. Në mungesë të librave për fëmijë, kam lexuar fjalorët e gjyshes. Ata ishin hyrje e mrekullueshme nëpërmjet të cilëve fillova zbulimin e botës, u enda e ëndërrova përpara faqeve të ilustruara, hartave, listave të fjalëve të panjohura.

Libri i parë që shkrova, në moshën gjashtë apo shtatë vjeçe,

ishte titulluar, veç kësaj, Le Globe à mariner/Marinoj/futem në Glob.

Menjëherë pastaj erdhi biografia e një mbreti imagjinar me emrin Daniel III – mund të kishte qenë ai Suedez? – dhe një rrëfenjë e treguar nga një pulëbardhë. Ishte kohë e jetës në vetmi.

Si fëmijë ishim pak të lejuar të loznim jashtë në natyrë, pasi në arat dhe kopshtet pranë atyre të gjyshes kishte mina.

Sjell ndër mend që ndërsa isha duke ecur pranë detit një ditë erdha përgjatë vendit të rrethuar me tel me gjemba: në rrethojë ishte tabela me shkrim në gjuhë frënge dhe gjermane e cila të ardhurit atypari i jipte mesazhin kërcënues, me kafkën e cila i bënte gjërat plotësisht të qarta.

Në gjendje të tillë, është lehtë ta kuptosh dëshirën të shpëtosh nga rreziku – pra, të ëndërrosh, dhe t'i vësh ato ëndrra në shkrim.

Gjyshja ime nga nëna, veç kësaj, ishte treguese e jashtëzakonshme e rrëfenjave, dhe ajo për t'i treguar rrëfenjat ruante pasditet e gjata. Ato rrëfenja qenë gjithnjë shumë të imagjinuara, dhe ishin vendosur në pyll –në Afrikë mbase, apo në Maurice, ndoshta në pyllin e Makabit –

2

ku personazhi kryesor ishte një majmun tinëzar që kishte talent të madh për prapësi, dhe i cili në mënyrën e tij të shkathët gjithnjë ia dilte edhe në situatat më të rrezikshme. Më vonë, unë do të udhëtoja tek Afrika dhe atje do të kaloja kohë, me ç'rast zbulova pyllin e vërtetë, ku kafshë pothuaj nuk kishte.

Por në fshatin Obudu, pranë kufirit me Kamerunin, një oficer regjioni më tregoi si në kodrën e afërt mund të dëgjoja rëniet si të daulleve të gorillave, që rrahnin fort gjokset e tyre. Dhe prej atij udhëtimi, e kohës që kalova aty (në Nigeri, ku im atë ishte mjek fshati), nuk ishte vetëm lënda që solla për romanet e ardhshëm, por një lloj personaliteti i dytë, ëndërrtari me sy hapur që në të njëjtën kohë ishte i magjepsur me jetën e vërtetë, ky personazh më ka shoqëruar gjithë jetën – dhe në mua ka ndërtuar përmasë kundërshtie, kohë të pashpjegueshme, të veçantë, të jashtëzakonshme, që herë pas here më ishte burim vuajtjesh. Më dha ngadalësi jete, më mori pjesën më të mirë të jetës të kuptoja domethënien e kësaj kundërshtie.

Librat në jetën time kanë hyrë në periudhë më të vonë. Kur ishte ndarë trashëgimia e tim atë, në kohën e dëbimit të tij nga shtëpia e vendlindjes në Moka, në Maurice, ai ia doli t'i mblidhte bashkë disa biblioteka nga librat që mbeten. Kjo asokohe më bëri të kuptoja të vërtetën, jo menjëherë të qartë për fëmijët, se librat janë thesar më i çmuar nga pasuria e patundshme apo llogaria bankare.

Ndodhi që në ato vëllime, shumica të vjetra dhe të lidhura, zbulova veprat e mëdha të letërsisë botërore: Don Kishotin, e ilustruar nga Tony Johannot, La vida de Lazarillo de Tormes/Jeta e Lazarillo Tormes-it/; The Ingoldsby Legends/Legjendat e Ingoldsby-it/; Udhëtimet e Guliverit; romanet e mëdhenj të frymëzuar të Victor Hygo-s,

Quatre-vingt-treize (Katër - Nëntëdhjetë e Treshe), Les Travailleurs de la Mer (Punëtorët e detit), dhe L' Homme qui rit (Njeriu që qesh). Poashtu Les Contes drôlatiques (Tregime humoristike) të Balzakut.

Por librat që paten ndikim më të fuqishëm në mua ishin antologjitë e përshtypjeve të udhëtimit, shumica e tyre lidhur me Indinë, Afrikën dhe ishujt Masacare, apo historitë e mëdha të hulumtimeve nga Dumon d'Urville apo Abbé Rochon, Bougainville, Cook-u, dhe natyrisht Udhëtimet e Marco Polo-s. Në jetën e rëndomtë të një lagjeje të vogël province të përgjumur nën diell, pas viteve të lirisë në Afrikë, ata libra më dhanë shijen e aventurës, më lejuan të parandiej madhështinë e botës reale, më dhanë mundësinë ta hulumtoj këtë më tepër nga intuita dhe shqisat se sa nga njohuritë. Në një mënyrë, poashtu, ata libra më dhanë, qysh herët, një vetëdije të natyrës kundërthënëse të jetës së fëmijës: fëmija do të ngjitet te një hierore, për ta harruar dhunën dhe garën, dhe poashtu të marrë kënaqësi në shikimin e botës së jashtme nëpërmjet xhamit të dritares së tij.

Pakëz para se të merrja lajmin – për mua befasues – se Akademia Suedeze ishte duke më shpërblyer me këtë nderim, isha duke e ri-lexuar një libër të vogël të Stig Dagerman-it që më pëlqen në veçanti: koleksionin e eseve politike të titulluar Essäer och texter (Ese dhe tekste). Nuk ishte krejt rastësi që isha duke e ri-lexuar këtë libër me kritikë të ashpër, të mprehtë.

Isha duke e përgatitur udhëtimin

3

për Suedi të merrja çmimin që Shoqata e miqve të Stig–Dagerman-it më kishte dhënë verën e kaluar, me qëllim që të vizitoja vendet ku shkrimtari kishte jetuar si fëmijë.

Kam qenë gjithnjë veçanërisht perceptues ndaj shkrimeve të Dagermanit, mënyrën si ai bashkon butësinë e ngjashme me të fëmijës me naivitetin dhe sarkazmin. Perceptues ndaj idealizmit të tij. Ndaj largpamësisë së qartë me të cilën e gjykon epokën e tij të shqetësuar, të pas luftës – për të kohë e viteve të pjekurisë, e për mua kohë e fëmijërisë. Vëmendjen time e tërhoqi sidomos një fjali, dhe në atë çast dukej sikur ajo më drejtohej pikërisht mua - sepse sapo kisha botuar romanin me titull Ritournelle de la faim/Refreni i Urisë.

Kjo fjali, apo më parë kjo pjesë, është si vijon: "Si është e mundur të sillemi, nga njëra anë, njëlloj sikur në botë të mos këtë asgjë më shumë rëndësi sesa letërsia, ndërsa nga ana tjetër, është e pamundur që të mos shohim rreth e qark si njerëzit luftojnë kundër urisë dhe si janë të detyruar të mbajnë më të rëndësishme atë çka fitojnë në fund të muajit? Sepse ai (shkrimtari) pengohet në kundërshti të re: ai që nuk donte të shkruante për gjë tjetër, veçse për ata që kanë uri, zbulon se vetëm të tjerët, ata të cilët kanë për të ngrënë kanë dhe mundësinë për t'ia vënë veshin jetës së tij"

(Shkrimtari dhe ndërgjegja).

Ky "pyll kundërshtish", si Dagerman e quan, është, saktë, mbretëria e shkrimit, vendi prej ku artisti nuk duhet të provojë të ikë, përkundrazi, ai apo ajo duhet të "dalë fushim" në të me qëllim që të njohë çdo hollësi, të hulumtojë çdo shteg, të emërtojë çdo dru. Kjo nuk është gjithmonë ndjenjë e këndshme. Ai që mendonte se në atë pyll kishte gjetur strehën, ajo që ishte duke iu folur në mirëbesim në fletën e saj, sikur pylli ishte mik besnik, i butë, ja, ata tash janë duke u përballur me realitetin, jo thjesht si vrojtues, por si aktorë. Ata duhet zgjedhur anët e tyre, të vënë largësi. Ciceroni, Rabelais-i, Condorcet-i, Rousseau, Madam de Stawl, apo, shumë më vonë, Soljenitsyn-i apo Hwang Seokyong, Abdelatif Laâbi, apo Milan Kundera: të gjithë ishin të detyruar të ndiqnin udhën e ekzilit.

Për dikë sikur unë, që gjithnjë – me përjashtim të asaj periudhe të shkurtër të luftës – kam gëzuar lirinë e lëvizjes, ideja se dikush mund të pengohet të jetojë në vendin që ka zgjedhur është aq e papranueshme sa të qenit me liri të hequr.

Por kjo liri lëvizjeje si privilegj, ka për pasojë kundërshtinë.

Shihni për një moment, në drurin me gjemba shpues domethënë në zemrën e vërtetë të pyllit ku shkrimtari jeton: ky burrë, ajo grua, të zënë me shkrimin, me sajimin e ëndrrave të tyre – a nuk i takojnë ata një happy few shumë fatlume dhe të zgjedhur? Le të bëjmë një pushim dhe ta përfytyrojmë një situatë të skajshme, tmerruese – si ajo ku jeton shumica e njerëzve në planetin tonë. Situatë e cila, kaherë, në kohën e Aristotelit, apo Tolstojit, ishte ndarë nga ata të cilët nuk kishin gjendje shoqërore – skllevërit, shërbëtorët, vasalët e Europës në Mesjetë, apo njerëzit që të plaçkitur nga bregu i Afrikës, ishin shitur gjatë Iluminizmit në Gorée, El Mina, apo Zanzibar. Dhe edhe sot madje, derisa po flas për ju, atje janë të gjithë ata që nuk e kanë lirinë e shprehjes,

4

që janë nga krahu tjetër i gjuhës. Unë jam i rënduar nga mendimet pesimiste të Dagermanit, më tepër se me shpirtin luftarak të Gramscit, apo sfidën e pashpresë të Sartrit. Përshtypja se letërsia është luks i klasës dominuese, duke ushqyer idetë dhe imazhet që mbesin të huaja për pjesën dërrmuese: kjo është zanafillë e shqetësimit që secili nga ne është duke e ndier – u drejtohem atyre që lexojnë dhe shkruajnë.

Natyrisht dikush do të donte ta shpërndante fjalën të të gjithë ata të cilët kanë qenë përjashtuar, t'i ftojmë me bujari në shtruarjen e gostisë së kulturës. Pse është kjo kaq e vështirë? Popujt pa shkrim, siç antropologët dëshirojnë t'i quajnë, kanë pasur sukses në shpikjen e një forme komunikimi të plotë, nëpërmjet këngës dhe mitit. Pse në ditët e sotme për shoqëritë tona të industrializuara, kjo është bërë e pamundshme?

Duhet ta rishpikim kulturën?

Duhet të kthehemi të një lloj komunikimi i menjëhershëm, i drejtpërdrejtë? Është tunduese të besosh se në kohën tonë kinemaja e plotëson një rol të tillë, apo muzika popullore moderne me ritmin dhe rimat e saj, me jehonat e vallëzimit. Ndoshta xhazi, e, në viset tjera, kalipsoja, maloja, sega.

Kundërshtia nuk është e re. François Rabelais (Fransua Rabële), shkrimtari më i madh i gjuhës Franceze, shumë kohë më parë bëri luftë kundër mburrjes me dijen të shkollarëve në Sorbonë, duke ua përplasur në fytyrë talljen me fjalët e këputura nga gjuha e thjeshtë. Ishte duke folur ai për ata që kishin uri? Tepri, dehje, dëfrim. Ai vuri në fjalë oreksin e jashtëzakonshëm të atyre që hanin lloj të veçantë ushqimi, varfërinë e fshatarëve dhe punëtorëve, pak a shumë mjaft të mirë për një ballo me maska, botë të kthyer me kokë përmbys. Paradoksi i revolucionit, si vargani kalorësiak epik i kalorësit fytyrë-pikëlluar, jeton në ndërgjegjën e shkrimtarit. Nëse aty është një virtyt të cilin penda e shkrimtarit gjithnjë duhet ta ketë, kjo është se atë kurrë nuk duhet përdorur të ngre lart të

fuqishmin, qoftë edhe me shkarravitjen më të pakët. Dhe prapë vetëm nga që një artist e thotë këtë sjellje të virtytshme nuk do të thotë se ai mund të ndihet i larë nga të gjitha dyshimet. Zemërimi i tij, mohimi i tij, dhe të metat pa dyshim qëndrojnë në njërën anë të pengesës, anën e gjuhës së fuqishme. Fjalë të pakëta, ca fraza mund të kenë shpëtuar. Po pjesa tjetër? Palimpsest i gjatë, kohë elegante dhe e përhumbur e varrakatjes. Dhe aty është humori, ndonjëherë, që nuk është mirësjellje dëshpërimi, por dëshpërim i atyre që i dinë shumë mirë të metat e tyre; humori është bregu ku vala e trazuar e padrejtësisë i ka lëshuar ata.

Pse, atëherë, të shkruhet? Sepse ka ca kohë, që shkrimtarët nuk e kanë më mendjemadhësinë sa të besojnë se ata mund ta ndryshojnë botën, se përmes rrëfimeve e romaneve të tyre, do ta lindin modelin më të mirë si duhet të jetë jeta. Thjesht, ata do të pëlqenin të dëshmojnë.

Shihe këtë pemë tjetër në pyllin e kundërshtive. Shkrimtari

do të donte të dëshmojë, kur në fakt, shumicën e kohës, nuk është asgjë më shumë se vrojtues i thjeshtë.

5

Dhe ndodh që artisti të jetë i tillë, dëshmitar. Dante në Komedinë Hyjnore, Shekspiri në Shtrëngata - dhe Aime Césaire në përshtatjen madhështore të kësaj shfaqje, titulluar me Une Tempête/Një Shtrëngatë, në të cilën Caliban-i, ulur mbi një fuçi baroti, kërcënon të hedh në erë veten dhe të marrë me vete padronët e tij të urryer.

Dëshmitarët nganjëherë janë poashtu të paqortueshëm, sikur është Euclides da Cunha në shtE pgrtret familjar Në pbOgra- facoletash. FacoLetau e burrave ishin më0të }ëdhat, md skaje!tû errëta borfurash ngjyrë kafe, gri, të ouqe apj$të bardhë. FacOlutaô e grqve ys(in më të vogla, dhe m kclta e çelur, e kuqja, apo e `lerta i3hin ncjyral e s+ajeve të uyra. Facoletat e fëmijëve ishin mË të voglat: katrorë |ë bardHë pa bordurê piktUruar me |ule apo kafshë. Tri llojet e facoletave ishin nd`rë në ato për përdorim të përdIts(ëm, raeha e përparme- dhe ato të rezervuara për të Dielën, radha e prapmen Tsinë e saj në Sanctuary/Faltorja të William Faulkner-it, apo në First Snow/Bora e parë të Lao Shesë. Brishtësinë e fëmijërisë në Ormen (Gjarpëri) të Dagerman-it.

Shkrimtari kurrë nuk është dëshmitar i mirë përveç në rastin kur është dëshmitar padashje, me pahir. Kundërshtia është se ai nuk e bart dëshminë për diçka që e ka parë, apo për diçka që e ka sajuar. Hidhërimi, nganjëherë bile dëshpërimi, rritet pasi ai nuk është i pranishëm në fajësim. Tolstoi mund të na tregojë vuajtjen që armata e Napoleonit i shkaktoi Rusisë, dhe megjithatë asgjë s'është ndryshuar në rrjedhën e historisë. Zonja Claire de Duras shkroi Ourika, dhe Harriet Beecher Stowe Kasolla e xha Tomit, por ishin njerëzit skllevër, që ndryshuan fatin e tyre, të cilët u rebeluan dhe luftuan kundër padrejtësisë me krijimin e rezistencës së skllevërve zezakë, në Brazil, në Guajanën Franceze, dhe në Antile e republikën e parë zezake në Haiti.

Të veprojë kjo është ajo çka, para së gjithash, shkrimtari do të donte të jetë në gjendje për të bërë. Të veprojë, më tepër se të dëshmojë. Të shkruajë, përfytyrojë, dhe ëndërrojë në mënyrë të tillë që fjalët dhe krijimet e ëndrrat të kenë ndikim të fuqishëm mbi realitetin, t'i ndryshojnë mendjet dhe zemrat e njerëzve, të përgatisin rrugën për botë më të mirë. Dhe megjithatë, pikërisht në atë çast, atij (shkrimtarit) një zë është duke i pëshpëritur se kjo nuk do të jetë e mundur, se fjalët janë fjalë që i merr me vete era e shoqërisë, dhe se ëndrrat janë thjesht iluzione. Çfarë të drejte ka ai të dëshirojë të jetë më mirë? Është kjo vërtet punë e shkrimtarit të gjejë zgjidhjet? A nuk është ai në vendin e një roje pylli në shfaqjen Knock ou Le Triomphe de la medicine/Trokitja apo triumfi i medicinës, i cili do të pëlqente të pengojë tërmetin?

Si mund të veprojë shkrimtari, kur krejt çka di është të kujtohet për diçka?

Vetmia do të jetë fati i tij në jetë. Kjo ka qenë kështu gjithnjë. Si fëmijë, ai qe djalosh i brishët, i shqetësuar, së tepërmi i zgjuar për ide, apo ajo vajza e përshkruar nga Colette, e cila nuk mund të ndihë por vetëm të vështrojë derisa prindërit e saj ndajnë në dysh njëri tjetrin, sytë e saj të zi të mëdhenj zmadhuar me një lloj vëmendjeje që dhemb. Vetmia është e dashur për shkrimtarët, dhe shkrimtari rri në shoqërinë e vetmisë pasi aty gjen thelbin e lumturisë. Kjo është lumturi kundërthënëse, përzierje e dhimbjes dhe kënaqësisë, ngadhënjim iluzor, torturë e heshtur, e gjithëpranishme, jo ndryshe nga muzika e ulët e bezdisshme. Shkrimtari, më mirë se cilido, di si ta kultivojë bimën jetësore, a helmuese,

6

atë e cila zhvillohet vetëm në dheun e pafuqisë së tij. Shkrimtari dëshiron të flas për secilin, dhe për çdo epokë: aty është ai, ajo, secili i vetëm në dhomë, përballur me pasqyrën shumë të bardhë të fletës së zbrazët, nën abazhurin që distilon dritë të fshehtë. Apo ulur tek ekrani tepër- i ndritshëm i kompjuterit, duke i mbajtur veshë zërit të gishtave të tij që kërcasin mbi tastet. Ky, pra, është pylli i shkrimtarit. Dhe çdo shkrimtar në atë pyll njeh fare mirë secilin shteg. Nëse, herë pas here, diçka i ikë, si kur zogu ngrihet beftë në fluturim nga një qen në ag, atëherë shkrimtari sheh para, i habitur - kjo ndodhi thjesht rastësisht pa dashjen e tij.

Nuk është dëshirë imja, megjithatë, të gëzohem në të qenët negativ.

Letërsia – dhe kjo është çfarë doja të them – nuk është ndonjë relikë e vjetëruar që duhet, logjikisht, të zëvendësohet nga artet audiovizuele, nga kinemaja në veçanti. Letërsia është shteg i ndërlikuar, i vështirë, por unë e gjej të jetë sot bile më jetësore sesa në kohën e Bajronit apo Viktor Hygos.

Janë dy arsye pse letërsia është e nevojshme: Para së gjithash, sepse letërsia është e bërë me gjuhë. Me domethënien parësore të fjalës: shkronjat, atë çka është shkruar. Në gjuhën frënge, fjala roman ka të bëjë me tekstet në prozë që për herë të parë pas Mes Jetës përdoren gjuhë të re të folur nga njerëzit, gjuhën e atmosferës fantastike. Dhe fjala për tregim të shkurtër, nouvelle, poashtu vjen prej nocionit gjë e re (novelë). Në kohë përafërsisht të njëjtë, në Francë, fjala rimeur (prej rime, apo rhyme) ndodhi të përdorej për të treguar poezinë dhe poetët – fjalët e reja vijnë nga folja greke poiein, të krijosh. Shkrimtari, poeti, novelisti, janë të gjithë krijues. Kjo nuk do të thotë se ata e zbulojnë gjuhën por kjo do të thotë se ata e përdorin gjuhën të krijojnë të bukurën, idetë, metaforat. Dhe kjo është pse ne nuk mund të rrimë pa ata.

Gjuha në historinë e njerëzimit është shpikja më e jashtëzakonshme, ajo e cila i paraprin gjithçkaje, dhe e cila mundëson të arrihet gjithçka me të. Pa gjuhë nuk do të kishte as shkencë, as teknologji, as ligj, as art, as dashuri. Por kjo shpikje, pa person tjetër me të cilin ndërveprohet, bëhet virtuale. Mund të zbehet, rrëgjohet, zhduket. Shkrimtarët, deri diku, janë ruajtësit e gjuhës. Kur i shkruajnë novelat, poezitë, shfaqjet e tyre, ata e mbajnë gjuhën të gjallë. Ata nuk janë thjesht duke i vënë në punë fjalët – përkundrazi, janë në shërbim të gjuhës. Duan për ta bërë atë me emër, të mprehur, të ndryshuar, pasi gjuha është ajo që jeton nëpërmjet tyre dhe prej tyre, dhe shoqëron gjithë transformimet shoqërore dhe ekonomike të epokës së tyre.

Kur, në shekullin e kaluar, ishin ardhur në shprehje teoritë raciste, aty ishte biseduar për ndryshimet themelore në mes kulturave. Në një lloj hierarkie absurde, ishte tërhequr një lloj lidhje reciproke në mes suksesit ekonomik të fuqive koloniale dhe epërsisë domethënëse të kulturave të tyre. Teoritë e tilla, ngjashëm me dëshirën e ethshme, të sëmurë, kujdesen përsëri aty këtu, kohë pas kohe, të përligjin neo-kolonializmin dhe imperializmin.

Aty janë, le të themi,

7

kombe të caktuara që mbeten prapa, të cilat nuk i fituan

të drejtat e tyre dhe privilegjet ku gjuha është e përzier,

pasi janë ekonomikisht prapa apo me teknologji të vjetruar. Por a kanë menduar ata të cilët janë të prirur për epërsinë e tyre kulturore se të gjithë njerëzit, në mbarë botën, në çfarëdo shkalle të tyre të zhvillimit, e përdorin gjuhën? Dhe se secila nga këto gjuhë ka, njëjtë, modelin e tipareve logjike, sistemin, strukturen, tërësinë analizuese që mundëson të shprehurit e botës, që mundëson të flitet për shkencë, apo që mundëson të krijohen mitet?

Tash pasi unë kam mbrojtur ekzistencën e krijesës së ngatërruar dhe disi të dalë mode me emrin shkrimtar, do doja të kthej sytë tek arsyeja e dytë për nevojën e letërsisë, sepse kjo ka të bëjë më tepër me profesionin e bukur të publikimit.

Këtyre ditëve flitet me të madhe për globalizmin. Njerëzit harrojnë se në të vërtetë dukuria filloi në Europë gjatë Renesancës, me fillimin e epokës koloniale.

Globalizmi nuk është një diçka e keqe brenda e jashtë vetes. Komunikimi ka shpejtuar përparimin në medicinë dhe shkencë. Mbase përgjithësimi i informacionit do të ndihmojë të parandalojë konfliktet. Kush e di, nëse Interneti do të kishte ekzistuar në atë kohë, mbase komploti kriminal i Hitlerit nuk do të kishte pasur sukses - ana qesharake e komplotit mund ta kishte parandaluar atë ta shihte ndonjëherë dritën e diellit.

Jetojmë në epokën e Internetit dhe komunikimit virtual. Kjo është diçka e mirë, por për çka do të kishin vlerë këto zbulime befasuese, nëse jo për mësimin e gjuhës së shkruar dhe librave? Ta pajisesh pothuaj secilin në planet me ekran kristali të qartë/ëmbël është diç utopike.

Prandaj, a nuk jemi në proces të krijimit të élites së re, të heqjes së vijës së re për të ndarë botën në mes të atyre që kanë çasje në komunikim dhe dijeni, dhe atyre që janë lënë jashtë? Kombet e mëdha, civilizimet e mëdha janë zhdukur pasi ato dështuan të kuptojnë se kjo mund të ndodhte. Jam i sigurt, ka kultura të mëdha. që mund të jenë në vetë popujt e vegjël, të cilët kanë qenë të aftë të qëndrojnë deri në ditët e sotme, falë përcjelljes gojore të dijes dhe miteve. Është e domosdoshme, dhe e dobishme, të pranohet ndihmesa e këtyre kulturave.

Deshëm apo s'deshëm, edhe pse ende nuk e kemi arritur pleqërinë e vërtetë, ne nuk jemi duke e jetuar më epokën e miteve. Nuk është e mundshme të sigurojmë themelin për barazi dhe respektin e të tjerëve nëse çdo fëmijë nuk merr përfitimet e shkrimit.

Dhe tash, në këtë epokë që përcjell dekolonizimin, në kohën tonë letërsia për burra e gra është bërë mënyrë të shprehin njëjtësinë e tyre, të kërkojnë të drejtën për të folur, dhe të jenë të dëgjuar në tërë larminë e tyre.

Pa zërat e tyre, të drejtat e tyre, ne do të jetonim në një botë të heshtjes.

Kultura në shkallë globale është diçka që na shqetëson të gjithëve. Por kjo është para së gjithash përgjegjësi e lexuesve –me fjalë të tjera e botuesve.

E vërtetë, është e padrejtë që Indianit prej veriut të largët të

8

Kanadës, nëse dëshiron të dëgjohet, i duhet shkruar në gjuhën e pushtuesve – në Frengjisht, apo në Anglisht. E vërtetë, është mashtrim të pritet që gjuha Creole (negro-spanjolle, negro-frënge) e Mauric-ve apo e Antileve të mund të dëgjohet aq lehtë rreth e qark botës si pesë apo gjashtë gjuhët që zotërojnë sot si gjuhë sovrane të mediave. Por nëse,

nëpërmjet përkthimit, zërat e tyre bëhen të dëgjuar, ahere diçka e re është duke ndodhur, arsyeja për optimizëm. Kultura, siç kam thënë, u përket të gjithëve, gjithë racës njerëzore. Por me qëllim që kjo të bëhet e vërtetë, secilit duhet dhënë çasja e barabartë në kulturë.

Libri, sado i modes së vjetër të jetë, është mjet ideal.

Sepse është praktik, i lehtë të mbahet, ekonomik. Nuk kërkon ndonjë zotësi të veçantë teknologjike dhe ruhet mirë në cilëndo klimë. E meta e vetme e tij – dhe kjo është ajo që do doja në veçanti t'ua them botuesve– është se në një numër të madh shtetesh çasja te librat ende është shumë e vështirë. Në Republikën e Mauricit çmimi i një romani apo e një përmbledhjeje poezish është i barasvlershëm me një pjesë të konsiderueshme të buxhetit familjar. Në Afrikë, Azi Juglindore, Meksikë, apo Ujdhesat e Detit Jugor, librat mbeten luks i paarritshëm. Dhe ilaçi për këtë situatë megjithatë ekziston. Publikimi i përbashkët me vendet e zhvilluara, themelimi i fondeve me bibliotekat huadhënëse dhe bibliotekat shëtitëse / bibliobusët, dhe, në përgjithësi, vëmendja më e madhe për veprat në gjuhët e ashtu-quajtura të kombeve të vogla – që shpesh janë qartë në shumicë - do mundësonte që letërsia të vazhdonte të jetë mjet i mrekullueshëm për vetë-njohje, për zbulimin e të tjerëve, dhe për dëgjimin e koncertit të bashkëpunimit të races njerëzore, në tërë larminë e begatë të temave dhe përndryshimeve tonike.

Vijon numrin e ardhshëm

E shtunë, 12 mars 2022
NACIONAL

MAKTHI CULLAK



Prozë nga Mehmetali Rexhepi

...cullak. Nuk e dija ku kisha fjetur dhe pse paskam mbetur i zhveshur? Shtrati ishte në dhimbjet e mia; flija në një shtrat vertikal. Shtegut ishte terr. Gjuhës i mungonte shkrepja për të ndezur dhe, nuk ndezte në ploti as fijet e kashtës. Mos vallë e këtillë qenka gjuha e memecit në hapësirën e natës së këtushme? Nëpër atë hapësirë të pakëndshme, që ma dëbonte bardhësinë nga sytë e mi, sikurse kishte dëbuar para njëqind e pesëdhjetë vjetësh mijëra sy e shikime të fundit pa caqe... Ato shikime të ngrira në trishtimin e tyre, i kishin hapur gropa varresh dheut dhe kujtesës. Në hartën e kësaj hapësire, kurdo që ktheja vështrimin, errësira më dendësohej.

***

Shikoja, por shihja të hirtën. Kurdoherë e zeza në të hirtë më përkiste mua! Dita e ecejakeve të mia niste me një hirësi dhe vijonte me të errëtën. "Katun","Qerimci" ishin veçse shenja, onomastikë memece. Hapësira më piketonte hije figurash të zeza, ri-dalje dinozaurësh e lugetër gjenesh të vjetra, vijimësisë të rejat... Dikur kishte pasur një nisje, ngaqë fundin nuk mund ta shihja dhe, që kur ishte e tillë kjo mynxyrë?! E dija se do të vijojë të jetë asisoj... Me duhmën e brendshme në zorrë, që u del nga barku, goja e mendja, ende pa u tretur viktimat... Por, si mbeta i zhveshur, ngaqë nuk kisha kryer asnjë akt mbi një të cullakuar tjetër? Nuk kishte një shtrat për mua.

***

Bredhërija e natës nuk më shpinte askund. I thosha dytëshorit nata e gjumit sjell diçka të pakapshme të ditës... Në mos asgjë të shpalon inserte mëtimesh për kërkime e prekje... Lakmoja thesarin e pandjeshëm të gjumit. Një portë e hyrjes në amshim... Nuk më jepej ai thesar i dhimbjes, ngase doli prej ferrit dhe, shtriheshin tentakula të zeza mbi mua.

- Terri ka veshë! - më pëshpëriti dytëshori
- Mirëpo, nuk ka sy! - ia ktheva.
- Ka sendorë, shpuzore ndijimesh...
- Ku ta gjej tash veshjen time?

Dytëshori lypte të imagjinuarën për mbështjellje nën një zhguall enigme; ndaj nuk kishte se si të ma mbulonte mua cullakun. Vëmendja më kot tëhollonte ndjeshmërinë e aktit të tillë. Nuk kishte banjë, as lumë, as liqe, as det që të përtrollitej akti i ndërresave të brendshme. Ecja zbathur mbi gjethe të zverdhura, të thara zhap, zhap, zhap. Ndonjë asht i mprehtë mund të më ngulej si mallkim legjitim i harresës... Mund të trazoja qindra këmbë-zeza të alarmuara. Duhej të ecja diku... Kah? Ndoshta andej ku fshihej kuptimi i përrallës? Andej kah kishin fluturuar dragonjtë shumëkëmbësh me thonj e kanxha të gjata; atje ku ishin shkërmoqur nëpër flakë, përderisa fosilet ua kishte përpirë hiri, dheu, rëra, shirat, kripërat e pëlcitura...

***

Dyshoja në njëshin tim. Ndryshe e shihte natën dytëshori, ai fshihej në një zhguall frike... Mëtoja të mos hyja nën atë zhguall dhe, ai secilën herë ma ofronte. Ashtu i përçudnuar, i cullakuar, krenaria ndjehej e cenuar, nuk kishte ku të fshihej. Sipërfaqësisht do t`iu dukesha shpellor, ose i sapo dalë nga shpellat e pazbuluara të asaj hapësire të errët. Kush m`i kishte hequr brekët e intimes: duart e mia të mbetura diku ose krahët e dikujt me duar të mia?! Me rrobat e natës nuk më dyshohej raca.

- E si: a nuk ishin edhe këta grabitqarë të kulturuar, kategori e majmunëve të zhveshur, vetëm që u mbuluan prej leshi?
- Prej shpellave dolën, stolitë tona morën dhe mbuluan bythët e palara.
- Ah! - lëshoi një ofshamë dytëshori i strukur.

Çfarë deshi ai? Zbrazi një barrë shpirti që nuk shpihej më tej...

Në mozaikun e mendjes më vezullonte edhe ndonjë copë hamendje: pse të neveriteshin prej figurës cullake, kur edhe ata kishin të njëjtat gjymtyrë mashkullore? Pyetja ishte e marrë, ngaqë prishte rendin publik. Lajthitja publike e shporrte lajthitjen intime. Tashti më kaplonin trazira për turbullimin e mendjes së shëndoshë!

- Në cilën shkallë të lajthitjes qenkam ngjitur?!
- A mund të bie e të mos ngrihem? - lypja tumiren e dytëshorit, i cili më shkëputej dhe kthehej për t`mi zbutur amplitudat e tensionit.

Përderisa vesa e agmisë më mbuloi me tisin e saj të reumës, dita do të më ekspozojë, si një figurë e gjallë e një galerie shëtitëse, me duar herë fytyrë mbuluar, herë poshtë lëshuar mbi herdhe. Mbase cullakoja le përshtypjen e një karikature. Asgjë mangët nga ata, pos që karikaturat e veta ua zbulonin grave të tyre. Në sytë e secilit isha i çmenduri me turpin e humbur. Në sytë e secilës tinëzisht shquhej ai sendi, formati i pallës. Një përfytyrim lëng-ndjellës për të çarën e butë dhe vrushkuj jonesh. Isha një arkaik ose modern i pacipë, i shkalluar, i degraduar, ironizues, protestues, i marri që duhej pështyrë e sharë, i sëmuri mental, që kishte ikur nga shtëpia përkatëse... Madje, dikush aktin tim të cullakuar mund ta shihte si një parodi, si shtytje e skajshme, zvetënim e rebelim për kthimin e sojit të njeriut në zanafillë! Ndodhja ime e tillë në skajin e trishtimit, hapat mbi gjenet e humbura të parakëve të mi në këtë anames fshatarak, do të shihen si provokim, si ndotje e sedrës femërore. Gjithnjë një folklor i heshtur do të zgjohej me sfurqe druri e metali, të ndiqej, t`iu hiqej sysh i huaji faqezi, shurdh-memeci, i mallkuari poshtërues!

Pothuajse të gjitha shikimet kalimtarëve u vareshin pikësëpari në pallën time, që epohej në të majtë e të djathtë prej ritmit të shpejtuar të ecjes dhe vrapit. Ndoshta ndonjëra e ndjente thellësisht ethshëm përmes joneve tundimin e vagjinës, mund t`i ndodhte tjetrës rrjedhja e tëmblit lugut të shalëve? Ndoshta akëcilës i zgjohej vrullshëm vlimi, që i gufonte tëmblin pas vlimit; pastaj i ftohej dhe bëhej kokrra të piksura, si droçka djathi a kosi... Sekush shtyhej t`i rikthehej pasqyrës së gjatë, ta lypte estetikën e dëshirueshme, të krahasueshme me shfaqjen e gjymtyrëve të mia? Kushedi? Mushkëritë nuk e përballojnë dot marrjen dhe nxjerrjen e frymës... E ndjeja fillim-djegien e mushkërive.

***

Gjithë atë ecje, nuk di si i mbanin këmbët gjymtyrët tjera? Trualli ku shkelja nuk ishte i sheshtë dhe, ligat më rridhnin nga një kundërmim i fërgimit. Isha gati të rrëzohesha. Nuk duhej të rrëzohesha, sepse do të më nguleshin pamëshirshëm sfurqet metalike të zhytur në plehra. Hera herës pallës i vinte vegjetacioni i kokë-ngritjes, gjersa sfondi hapej paskajë dhe caku nuk shihej askund... Si mos të ketë një sfond ku të më mbështetej shpina? Përfytyrimet e dytëshorit për gjetje të shtegut për shmangie, më shpinin në sfondin e afërm të dhjeta figurave të xhindosura me maje sfurqesh drejt meje! Më kot i dëboja ato pamje, të cilat më sollën vezullimat fragmentare të sfurqeve, aty ku kishin rënë bajgat! Oh...! Vullnet i qindra fish!... Prisja trishtimin e parë të çarjes së barkut, të gjoksit, të vitheve dhe, më vetëtoi syve një majë sfurku!... Nuk me merrja me mend nguljen në sy! Pas secilit dëbim të dytëshorit me parandjenja të gjalla, aq sa fijet e flokut në kokë, sërishmi më kthehej me të tilla të dyfishuara... E kërkoja një dytëshor tjetërsoj, që nuk do të ma ndillte kapitullimin në luftën enigmatike të pabarabartë. Nuk më bindej dytëshori. Vinte dhe sillte atmosferën e nguljes së majave të sfurqeve në cullakun e gatitur. Nuk kisha forcën e kundërvënies atmosferës së tij. Vetëm palla ime prirej drejt forcimit për qefin e vet të imagjinuar! As dytëshori, as unë nuk e shpjegonim vetëmohimin e pallës në galopin e rrëshqitshëm të ndjekjes. Vetëm sa nuk i shkëmbeja gulçimet e frymëmarrjes me ndjekësit!... Ishte një vetëpohim i egër dhe tej arsyes, paradoksal dhe fyes i pallës luhatëse andej-këndej... Palla e ngritur ishte një motivues cinik i urrejtjes për të mos u ndalur moria e ndjekësve, për të mos pasur as një fije mëshire, nëse do të më kapnin duart e tyre vrastare... Nga i vinte ai motiv misterioz kësaj palle kobtare?! Ndoshta ishte relikte e një gjeni të mbetur nga periudha e egërsisë së poligamive? Kush e ushqente atë motivim të pandalshëm, buzë shkuarjeve të tejpërtejme të metalit të mprehtë në mishin e gjallë të njeriut?! Aah, uuhh, oooh, oohhaa!... Përnjëherë, që të mos kapesha, më përpiu humnera e ëndrrës!

Mbeta në këmbë. I zbehtë dhe pa gjak, por nën vrujime djersësh të ftohta.

***

Mëdyshja sa vinte e më zgjerohej... Ndoshta isha përjashtim i racës, porse rastësisht jam ky që jam. Përpëlitesha mes akullit dhe zjarrit... Akulli i urrejtjes ishte vendor. Zjarrin e fshehur të këtij lloji epshi dozash të forta, ma kishte kurdisur Perëndesha Moderne e Dashurisë. Ajo në menynë ciklike fuste substancën e flakës dhe e shuante kur i duhej asaj. Fajtori ishte përtej meje.

- Përmbajtja e ndodhjes të së keqes është jashtë shpirtrave engjëllorë... - duke vijuar dytëshori shtoi:
- Që do të ndodh, si do të ndodh, parandjenja jote nuk është një formulë e gjetjes të saktësisë së ndodhjes.
- E ndodhura nuk vjen kur dhe kah e parandieje ti... Ajo mund të mos jetë trishtuese, mund të jetë shpirt-butë, ngase del nga shpirtra të ngjashëm me tanët, të vdekshëm si ne...

Dytëshori ma kishte kapur dorën dhe donte të më çonte te një oazë idilesh... Kjo urtësi ishte njëri nga fragmentet e idhujtarisë tij. Ishte pos një vegim tutje qarkut të mbyllur të fatit. Shpirtrat e sogjetarëve në këtë hapësirë të parakëve të mi, të këtij relievi kodrinor me lugina, fusha, lisnaja, ara, livadhe e vreshta hardhish, ishin mbushur me përshpirteni, me bekime të popëve, se prej Zotit të tyre, kudo që ishte derdhur gjak, gjaku u shenjtërohej!

***

Mëtoja ta gjeja fillin e ndodhjes time...

Ai fill nuk lidhej me prejardhjen e universit, as zgjidhej prej zgjerimit të gjithësisë. Veshët mëtonin t`i kapnin klithmat e një foshnje prej qeshjes së çastit; prej të vetmes qeshje pas nguljes në bajonetë, pastaj çurg i kuq mbi borë! Lëngata e dëshpërimit është bari i përhershëm, që mbinë e rritet pa riga të shiut... Frymëmarrjet e lagështa e ushqejnë gufimin prej shtresimit të nëndheshëm dhe, del në pah tharja e unit nga zbrazësia e vegjetimit. Lotët e vesës dhe ndonjë rigë mëkëmbin ferrat e gomarit, lule-gjembat, të cilat harlisen dhe shpojnë shikimet e buta të syve. Përherë e më qartë e shihja sfondin e zi të monodramës: thikën në qafën e qengjit, djaloshit pranveror në dorën e zezë të një Golluboviq-it! Thika e "bekuar" e popëve leshra thinjur e mjekrash zdrale!

Thika, popët mjekër thinjur e lesh zdrale, koka e prerë e pranverës së djaloshit, shkeljet e mia mbi truall klithjesh, fëmijësh të ngrirë, dënesje grash, skelete... Nëma të tej-zgjatura të mbira prej rrënjësh të nëndheshme. Mandej thika, kisha e lutjeve për prerje, popi mjekër-thinjur lesh-zdrale... Pastaj torzo, koka, koka, koka, vetëm koka pa gjymtyrë, llahtar!...

****Në konkursin letrar "FLAKA E JANARIT", Gjilan, 2022, kjo prozë u vlerësua me çmim të tretë***

Nga Basir Bushkashi

TEODOR LAÇO

Nëpër brazda proze
Derdhe aq magji...
Po dhe nëpër drama,
Nëpër komedi,
Prozator i rrallë
Nga të rrallët yllsi...

Me buzëqeshjen n'buzë
Me shpirtin fisnik,
Veshur me aq sqimë
Ngaherë poetik...
Me lexues të shumtë
Mbete shok e mik...

...Në vendlindjen tënde
Në Dardhën e bukur,
Prehesh përgjithmonë
Si një yll i këputur...
Miku im i madh,
Zemrave aq thellë futur...

VDEKSHIM NË MALL!

Edhe kësaj vere
Mbeta i zhgënjyer
Nga malli mbërthyer...

Me njëri-tjetrin
Si nuk u pamë:
A jemi gjallë?

E, po s'u pamë,
Po s'u pamë...
Vdekshim në mall...!

SHQIPTARËT

Shpërndarë Ballkanit,
Në trojet e veta,
Nga thika të mprehta...

Shpërndarë dhe Botës,
Qyshkur dhe sot,
Me mallin-lot...

Dhe brenda vendit,
Keqas shpërndarë,
Për të qenë i parë...

Dhe duam të rendim
Nëpër Europë,
Copë-copë...

VDEKSHIM NË MALL!

AQ LUMTURISHT

"Mjerë kush t'pa, lum kush t'ka,
Hidhet zogu për havà"
Popullore

Ti dogje aq zemra
Në dhembshuri
Për dashuri...

Po ti i falesh,
Aq lumturisht,
Vetëm atij...

Se aty dhe zogu
Merr më përpjetë
Se aty merr jetë...

ZJARRET RINORE

Dhembshurisht
E ndiej nga larg
Se pleqëria
Fshehur m'troket...
Në ditët me diell
Në netët me hënë
E arta rini
Më s'më thërret...

Po zjarret rinore
Ende s'janë shuar,
Dhe pleqërinë
Mundem ta tremb:
Me jetën e vrullshme,
Me vargun e vrullshëm.
- Shporru, - i them,
- Se tek unë s'ke vend...

DËBORA

Ka rënë dëborë
E gjithçka zbardhëllon.
Gjithçka ndrin,
Gjithçka ëndërron...

Pushteti i bardhë
Duke mbretëruar,
Ngjan i pamposhtur,
Duke nusëruar...

Por vjen një çast,
Një çast i mbramë:
Dëbora tretet,
Nëpër ofshamë...

E N'TË PUSHTOFSHA

Të valtat ndjenja
Më kanë pushtuar
Keqas, për ty...

E n'të pushtofsha:
Lule të zjarrta
Do t'çelin në gji...

ZHULJANA JORGANXHI
(Mbretëreshës së teksteve të këngëve)

Me aq shpirt njerëzor,
Me aq shpirt femëror...
Mbushur plot me dritë:
Nektarin e vargjeve
Derdhe nëpër këngë,
Nëpër muzikë...

Zhuljanë e ndritur,
Vargjeflakëruar:
Me magji të rrallë,
Me zemrën beharë,
Mbete nëpër këngë
Trëndafile e rrallë...

KUNGULLI

Shoh një kungull të fryrë në arë,
Thua se misri e paska zili,
Dhe n'mendje më sjell ndonjë zyrtar,
Që në zyrë merr pamjen e tij...

NJË POLICE

Një vajzë e bukur,
Një police,
Shenja polocie
Mban përmbi gji...
Dhe, hajde t'i flasësh,
Dhe, hajde ta prekësh:
Mbetesh i ngri...

RINORE

Unë e prita të dashurën time
Në një muzg të hirtë.
Përmbi plepa nxirrte hëna,
Syrin e florinjtë...

Ajo erdh' dhe lulet çelën
Plot u mbush lëndina.
Pas një reje hëna u fsheh,
Djeg nga xhelozia...

FERRAKU

Ai cicërin
Ferrave, drizave,
Se druhet të dalë
Larg në hapsirë.
Megjithatë,
Murrashi zog,
I gëzohet veç
Të tijës cicërimë...

Flet për "Nacional" Imzot Arjan Dodaj, i kryeipeshkëv i kryedioqezës Tiranë–Durrës

BINOMI FE DHE ATDHE ËSHTË SHUMË I GJALLË NË EKZISTENCËN TIME

"E ndjej veten të thirrur para së gjithash për të mbjellur shpresën tek të rinjtë shqiptarë"

Intervistoi: Dr Mujë Buçpapaj

-Si e pritët zgjedhjen tuaj në këtë detyrë kaq të rëndësishme dhe relativisht në një moshë kaq të re siç thoni edhe vetë në disa prononcime?

-Pikërisht është një event që duke qenë një përgjegjësi kaq të madhe dhe në një farë mënyre e thirrur për të pasur edhe një shërbim për një kauzë që i përket kishës në një komb të vuajtur sic është kombi ynë, është në një anë një surprizë e madhe e nga ana tjetër një akt besimi i madh në dorën e Zotit që të jep atë përgjegjësi duke pasur besim në ty e duke të nxitur për të qenë me të vërtetë në udhën e atyre që na kanë paraprirë duke qenë dëshmitarët e fesë sonë, e ndër shekuj kanë ditur të ruajnë pikërisht këtë fe duke ditur të lidhin bukur binomin fe e atdhe.

E kështu që edhe për mua ky binom është shumë i gjallë në ekzistencën time, në jetën time edhe falë dimensionit te jetës sime edhe përpara si emigrant për më shumë se 25 vjet ky dimensioni i Atdheut është një dimension i gjallë, që na ka bashkuar me shumë emigrantë të tjerë në kurbet, e na ka bërë që të ndihemi akoma dhe më shumë përkatës ndaj një kauze e ndaj një vendi siç është vendi ynë.

-Duke qenë drejtues i ri, secili duhet të vendosë disa prioritete, e të cilat mund të themi që i keni vlerësuar Ju e në përgjithësi kisha.

-Unë jam arqipeshvi i Tiranë Durrësit dhe është shumë themelor për mua aktualiteti dhe aktualiteti ballafaqohet me ato resurse që jep vendi ynë ato shpresa dhe në të njëjtën kohë ato vështirësi. Atëherë e ndjej veten të thirrur para së gjithash për të mbjellur shpresën tek të rinjtë sepse të rinjtë mund të gjejnë me të vërtetë gjithmonë e më shumë në vendin e tyre arsyen pse këtu mund të investojnë më bukur, më mirë, e më me shumë efekt ekzistencën e tyre, dhuntitë që kanë marrë, profesionin që kanë mësuar. Në të njëjtën kohë dhe ata që janë jashtë mund të rikthehen të japin kontributin e tyre intelektual kulturorë, shpirtëror, moral që kanë marrë në botën perëndimore kudo ku kanë emigruar. Pra një nga gjërat kryesore për mua është më të vërtetë për të mbjellë shpresën tek brezat e rinj.

Gjëja tjetër kryesore është shumë themelore për të ruajtur këto vlera që janë kaq të gjalla tek ne. Nganjëherë ne ndoshta shqetësohemi, mërzitemi se shohim disa fenomene që nuk i përkasin kulturës sonë, të cilat cënojnë familjen, jetën, dinjitetin e personit. Atëherë duhet të shohim vërtet që sidoqoftë familja në Shqipëri është shumë e fortë, dashuria për të moshuarit tanë, për fëmijët tanë, për nënat tona, baballarët tanë është akoma shumë e gjallë. Atëherë ne duhet që ta rivlersojmë këtë që kemi e ta rimëkëmbim, e ta bëjmë gjithmonë e më shumë si një thesar që duhet t'i përcjellim brezave të rinj, sepse pa familje pa gjirin formues të ngrohtë të një lidhje me prindërit, gjyshërit tanë që na kanë përcjellë përvojën e vuajtjes, përvojën e dëshmisë së tyrë edhe përballe vuajtjeve dhe sakrificës që kanë hasur, ne nuk do kemi të ardhme e kështu për t'i përcjellur brezave të rinj pikërisht këtë të ardhme.

Diçka tjetër shumë themelore është për të sensibilizuar edhe një fenomen që po prek ndjeshëm Shqipërinë që është dimri i madh demografik. Shqipëria ka nevojë me të vërtetë që t'i japi më shumë vlerë jetës, familjeve të reja të kenë më shumë mbështetje nga institucionet përkatëse që familjet e reja të gjejnë një mbështetje pa u shkurajuar për të marr një shtëpi të re me çmimet që fatkeqësisht po rriten në mënyrë marramendëse, me një formë krahasimi çmim rrogë që nuk plotësojnë atëherë ato kushte për të pasur një jetë pak më të denjë, pak më të lumtur, pak më të paqtë pra duhet të japim edhe arsye pse të rinjtë tanë dhe familjet tona të investojnë më shumë këtu.

-Një nga elementët që dallon kombin tonë është edhe harmonia fetare ku shquhet sidomos komuniteti katolik dhe kisha katolike. Si e vlerësoni këtë veçori kombëtare.

-Ju falenderoj shumë pasi kjo është një nga pyetjet që është shumë themelore që të marrë gjithmonë vend në dialogjet tona. Kjo sepse ne jemi pjesë e asaj trashëgimie që marrim nga etërit tanë si katolikët nga pikërisht meshtarët që na kanë paraprirë e si ashtu edhe myslimanët, sepse gjithmonë ndër shekuj kemi parë këtë solidaritet të madh njëri me tjetrin.

Papa Francesku duke u kthyer nga Shqipëria atë mbrëmje në avion në intervistën e tij dhene më 21 shatator 2014 thotë :" Në Shqipëri nuk ekziston toleranca fetare ata janë vëllezër" pra tolerancë do të thotë ta durosh tjetrin por vëllezër do të thotë ta duash, ta mbështesësh, ta kesh tjetrin pjesë të jetës tënde.

Këtë e shohim në familiet tona, e shohim dhe në këtë periudhë. Vetë unë sa herë kam dhënë leje martesash le të themi 'të përziera' ku burri është mysliman dhe gruaja katolike ose e kundërta. Pra ky është një bekim për vendin tonë dhe unë mendoj se është një mesazh profetik për botën e sotme që po përjeton shumë drama konfliktuale dhe shumë shpesh fatkeqësisht fetare.

-Gazeta Nacional shpërndahet në letër në Shqipëri, në Kosovë, e rajon dhe ka një numër lexuesish gjithandej për shkak të portalit online. Cili do të ishte mesazhi juaj për të gjithë shqiptarët në këtë kohe lufte?

-Unë para së gjithash ju përgëzoj! Ndoshta luftërat, ndoshta ndasitë, e ndoshta shpesherë ca konflikte ndodhin, sepse bagazhi kulturor ulet gjithmonë e më shumë. Pra ju jeni, unë mendoj, një gazetë elitare e didikuar ndaj letersise, arteve dhe ceshtjes kombetare.

Nganjeherë mediat i bëjnë më shumë jehonë skupit, skandalit, vrasjeve ose kriminalitetit në faqet e para të gazetave ose në edicionet e lajmeve, çka për mendimin tim nuk shkon. ju bëni kulturë dhe jeni te dedikuar ndaj trashegimisë shpirtërore, kulturore dhe arritjeve akademike!

Ju jeni promotorë të kulturës dhe jeni investitorët e së ardhmes sepse pa kulturë nuk kemi të ardhme. Një popull që nuk ka kulturë është një popull që po konsumon gradualisht një vetvrasje dhe në të vërtetë Shqiperia ka mbijetuar falë atyre djepeve të kulturës që e karakterizojnë edhe vendin tonë, falë atyre personave që edhe katolikë edhe myslimanë ose të identifikuar thjeshtë në formimin e tyre intelektual, kanë ditur t'i përcjellin brezave të rinj një trashëgimi të thellë kulturore të

rrënjosur, në kulturën tonë shqiptare që është Evropiane, kulturë perëndimore.

-Cili është mesazhi juaj për të gjithë shqiptarët e rinj dhe për ata që kanë humbur shpresën që një ditë do t'ia dalin?

-Mesazhi është më të vërtëtë, në jetën e krishterë është i mishëruar, pra është një fjalë që zë vend në zemrën, në jetën e secilit prej nesh. Kjo fjalë është prezenca e Zotit që na shoqëron për të parë përtej vellos së zezë nganjëherë të falimentimeve njerëzore të pashmangshme, për të parë përtej krizave për të parë përtej luftës. Te shohim në momentin aktual të një populli të bukur dinjitoz sic është ai i Ukrainës, sot shohim që shumë shtete te komunitetit europian po presin miliona e miliona refugjatë për arsye të kësaj lufte. Pra drama e një mungese të një kulture, të një uniteti të në paqe sjell asgjesimin e rracës njerëzore, atëherë unë ne aspektin që ju me pyetet e shoh si shume themelore. Ne të rikthehemi ne vendin tone për të rikthyer ato vlera që këtu kemi marrë por që mendoj edhe në perendim ose diku gjetkë ku kemi qënë në bazë të përvojës së jetës në bazë të eksperiencës, në bazë edhe te sfidave por edhe të vuajtjeve me të vertetë janë posuruar janë pjekur më shumë, janë bërë më të vyeshme që ti shërbejnë vendit. Unë e shoh edhe ne kontekstin aktual në Tiranë në shumë situata të biznesit të administrimeve publike të qeverisjes, sa e sa janë shqiptarët që pas një formimi një përvoje jashtë vendit janë kthyer për të dhënë kontributin e tyre. Por sa e sa akoma më të mirë kemi jashte që pret vendi ynë. E atëherë më të vërtetë së bashku ta rimëkëmbim Shqipërinë.

-Çfarë dëshironi tjetër?

-I uroj suksese gazetës kombëtare "Nacional"! Kjo gazetë me të vërtetë të na bën të ndihemi një, pra të pandarë. Të ndihemi një në ruajtjen e kulturës, letërsisë dhe trashëgimisë tonë kulturore dhe shpirtërore që është thelbi i kombit tonë nga lashtësia e madhe e Ilirisë deri në ditëtë tona, e kështu do të jetë përherë.

"Ju jeni promotorë të kulturës dhe jeni investitorët e së ardhmes sepse pa kulturë nuk kemi të ardhme. Një popull që nuk ka kulturë është një popull që po konsumon gradualisht një vetvrasje dhe në të vërtetë Shqiperia ka mbijetuar falë atyre djepeve të kulturës që e karakterizojnë edhe vendin tonë, falë atyre personave që edhe katolikë edhe myslimanë ose të identifikuar thjeshtë në formimin e tyre intelektual, kanë ditur t'i përcjellin brezave të rinj një trashëgimi të thellë kulturore të rrënjosur, në kulturën tonë shqiptare që është Evropiane, kulturë perëndimore"

Bardhyl Londo, poeti i majave poetike

Nga Dr. Uran Butka

1.

Emrin e Sali Butkës, e kisha takuar shumë më parë se të kuptoja atë që marr vesh sot nga jeta, bota, letërsia, poezia, lufta dhe paqja, agresioni dhe mbrojtja kundër tij, atdheu dhe krahina, fqinjësia dhe shovinizmi, paqja dhe orekset grabitqare të pushtuesve. Sali Butka kishte ardhur tek unë ashtu siç vijnë gjithë luftëtarët zulmëmëdhenj: diçka midis realitetit dhe legjendës. Përfytyrimi im nuk besoj se ndryshonte nga përfytyrimi i të tjerëve: një burrë gjithmonë në lëvizje, të cilit nuk i zinte kurrë këmba dhe', siç thuhet. Një burrë me pushkën në krah, që nuk i ndahej kurrë dhe që i ishte bërë si gjymtyrë e re në trupin e tij. Një luftëtar që veshët i mbante ngrehur dhe sytë gjithmonë hapur nga kufjtë shqiptarë, sidomos nga kufjtë jugorë. Fati kishte dashur që Sali Butka të lindej pikërisht në skajin juglindor të kufjve tanë të sotëm, ku historia e marrëdhënieve tona me fqinjët grekë, në ato vite të turbullta të shpërbërjes së perandorisë otomane dhe të fillimit të luftës së parë botërore, jo vetëm që nuk ishte e paqtë dhe e qetë, por ishte tejskarisht e turbulluar, madje e përgjakur dhe e dhimbshme. Ishte fat për Shqipërinë që Sali Butka lindi në ato troje, jo vetëm për qumështin patriotik që thithi, jo vetëm për edukimin dhe kulturën tradicionale të atyre zonave me të cilat u ushqye shpirti i luftëtarit të ardhshëm, por edhe sepse atje gjeti një terren ku do të shpërthente gjithë gjenia e tij prej luftëtari, gjithë gatishmëria e tij për të sakrifkuar veten dhe familjen në emër të mbrojtjes së tokave shqiptare dhe të lirisë nga sulmet dhe pushtimet e huaja në momentet vendimtare të historisë së Shqipërisë.

Natyrisht, Sali Butka do të donte të mos ta kishte provuar kurrë këtë lavdi. Do të kishte pranuar të jetonte si fshatar i thjeshtë në Butkën e tij të dashur e të bukur, të shkonte herë pas here në Frashërin historik prej nga i kishte rrënjët, të rriste nipër dhe mbesa, të hapte sytë në mëngjes dhe t'i mbyllte në mbrëmje me hallet e përditshme njerëzore. Por fati i tij ishte krejt ndryshe. Historia i kishte paracaktuar fatin e luftëtarit, fatin e Perëndisë mbrojtëse të truallit shqiptar, të zakoneve shqiptare, të qenies shqiptare. Dhe Sali Butka e kreu këtë si rrallë kush në historinë shqiptare.

Ndërsa fati personal i Sali Butkës ishte gati fatalitet. Në luftë ai humbi dy djemtë, njërin kundër me xhonturqit në Frashër, tjetrin kundër haxhiqamilistëve në Pogradec, vetë humbi syrin në betejën e Nikolicës për të mbrojtur Korçën nga grekët, por ky fatalitet vetjak (duket shumë cinike edhe sot kur e shkruan apo përmend) ishte vërtet fat i ndritur për shqiptarët, sidomos ata të Jugut dhe të Juglindjes që kishin një mbrojtës si Sali Butka. Kushedi si do të ishte fati i atyre trevave të bekuara në rast se nuk do të ishte Sali Butka dhe homologët e tij. Ndoshta duket pak jo njerëzore, madje edhe makabre, të pranosh se historia e lirisë dhe e pavarësisë së disa krahinave, por edhe e vetë Shqipërisë, është e lidhur ngushtë me sakrifkim jetësh njerëzore: dy djem të rinj vetëm nga një derë, nga dera e Butkajve, pa përmendur të afërmit e tjerë po nga kjo derë, që janë aq të shumtë, syri ihumbur i Sali Butkës në betejën e Nikolicës, privimet dhe tensionet e pafundme shpirtërore të krejt familjes dhe fisit nëpër vite. Por, sado që mund të ngjajnë të hiperbolizuara si në një film me superheronj, gjithçka është e vërtetë. Liria shqiptare i ka rrënjët në legjendën e Rozafës shekullore: as mund të mendohet dhe të parafytyrohet pa sakrifkimin e njerëzve më të afërt e më të dashur. E ndërsa ky imazh i Sali Butkës tashmë është tepër i njohur dhe familjar për gjithë njerëzit që e duan vendin e tyre, madje jo vetëm vendin e tyre por respektojnë edhe popujt e tjerë veçanërisht fqinjët, është i afërt për njerëzit që e duan lirinë dhe personalitetin e individit, që e duan paqen dhe bashkëjetesën mes popujve, ndërsa mua, pak më vonë, kur botën fillova ta kuptoj dhe ta ndjej më mirë, më erdhi një imazh tjetër i Sali Butkës, një imazh që më habiti dhe më mrekulloi njëkohësisht. Nuk e dija fare se Plaku legjendar i Butkës ishte edhe poet, madje kishte lënë një numër të konsiderueshëm vjershash, të cilat po i paraqiten lexuesit. Cili ishte, pra, imazhi i ri i SaliButkës që më shkrepëtiu në mendje "si nga i madhi Zot", siç ka shkruar Naim Frashëri?

Krejt rastësisht (rastësia shpesh herë është nënë e mrekullive dhe çudirave), nuk e mbaj mend se ku lexova vargjet e mëposhtme:

Në kohë të pleqërisë,
më erdhë plagë të rënda,
për shkakun e Shqipërisë,
që s'u bë si ma kish ënda.

Është me të vërtetë një imazh sa befasues aq dhe tronditës. Një thjeshtësi depërtuese deri në shpirtrat

më të ndërlikuar e më të sofstikuar. Po a nuk është arti i vërtetë një thjeshtësi e kulluar? Një humnerë zhgënjimi që të gëlltit brenda dhe s'të lë më mundësi veprimi? Po a nuk është zhgënjimi një mesazh i artit të vërtetë? Një dëshpërim njerëzor deri në kufjtë e vetëvrasjes, një dhembje e dëlirë, e pastër, që shfaqet pa asnjë pozë, pa asnjë pasthirrmë deklamuese nga ato që duan të tërheqin vëmendjen e opinionit dhe t'i thonë atij "shikomë mua sa po vuaj, vetëm për çështjen tuaj". Një klithmë e thekshme për jetën e një njeriu, të një vendi, të një kombi, jetë që, përfat të keq, ka shkuar kot "është djegur si qiriri", por e kanë shkelur pa mëshirë, me brutalitet të pashoq "derbederët, mercenarët...".

Imazhi i këtyre vargjeve ka vite që më ndjek. Madje them se jo vetëm mua, por shumicën e shqiptarëve edhe ata që nuk i kanë lexuar dhe nuk e dinë fare se ekzistojnë katër vargje të tillë. Janë vargje që riprodhojnë artistikisht të njëjtën gjendje shpirtërore që provon Shqipëria sot, kur zhgënjimi dhe humbja e shpresës janë ngjyra kryesore e peizazhit hallemadh shqiptar. Aq shumë më pëlqyen këto vargje sa edhe sot e kësaj dite i citoj shpesh me vete për të ilustruar gjendjen time shpirtërore. Jo rrallë ua deklamoj dhe miqve për të ndarë me ata diçka që mua më trondit sa herë e dëgjoj. Disa herë i kam cituar nëpër shkrime dhe ese të ndryshme.

Sali Butka hyri tek unë me këto katër vargje. Deri atëherë as nuk e dija që ai kishte shkruar edhe poezi. Është fat i madh për një poet kur hyn në botën e tjetrit me vargjet më të mirë të tij, sepse e ka më të lehtë komunikimin, por edhe pranimin, e ka të sigurtë ngrohtësinë e strehëzës ku troket.

Poeti i Butkës hyri tek unë nga porta kryesore e zemrës dhe jo nga dyert dytësore, apo deriçkat e parëndësishme dhe shpesh herë të rastësishme. Hyri përsëri ashtu siç kishte ardhur vite më parë: luftëtar, gjysmë njeri gjysmëlegjendë, me gjysmën e poezive që vazhdojnë të jenë vazhdim i krismave dhe flakëve të pushkës së tij të paepur, dhe gjysmën tjetër që janë ofshama dhe dhimbje për zhgënjimin e madh dhe të pashoq shqiptar, për "malet e Gramozit që qajnë" dhe "Tomorrin që oshëtin".

Por, ndërsa Sali Butka luftëtar besoj se njihet mirë, çfarë mund të themi për të si poet tani kur kanë kaluar shumë vite dhe historia është paqtuar, ndërsa gjykimi është i ftohtë nga emocionet dhe dobësitë e ndryshme njerëzore, që të bëjnë nganjëherë të gjykosh me anësi?

Jam i sigurtë: Sali Butka është po aty, është po ai që ka qenë. Syri i shëndoshë i tij, i cili në të vërtetë shikon sa dhjetëra sy të zakonshëm njerëzorë, vrojton si gjithmonë kufjtë e shenjtë, ndërsa shpirti ofshan përsëri "malet e Gramozit qajnë në moshën e pleqërisë së thellë... "

Sali Butka lindi më 1852 dhe vdiq në Butkë më 1938. Pra, siç vetëkuptohet, veprimtarinë vjershëtore e ka shtrirë në periudhën e Rilindjes Kombëtare dhe në atë që në historinë e letërsisë shqipe njihet me "Letërsia e periudhës së Pavarësisë". Megjithëse ka një prodhimtari të konsiderueshme vjershëtore, emri i Sali Butkës si poet asnjëherë nuk është përmendur zyrtarisht. Kam parasysh antologjitë që hartoheshin për shkollat, tekstet e letërsisë, të leximeve jashtë klase etj. Them zyrtarisht, sepse në popull, tek lexuesi, sidomos i viseve ku jetoi dhe luftoi poeti për të cilin po flasim, vjershat e tij njiheshin gjerësisht. Shumë prej tyre mësoheshin përmendësh dhe njerëzit i këndonin në gëzime apo trishtime të jetës.

Edhe sot e kësaj dite bëjnë jetë aktive këngë të tilla si "Të erdhi një letër nga një holandez, o Gani medet medet", "Ke tre vjet në Komitet", "Qëllimi", "Abdyl Frashërit", "Mësimi në çetë" dhe "Një natë dimri" (këngë e shkruar për Hasan Qinamin). Vetë vjershëtori i Butkës i shkruante vjershat në atë mënyrë që ato të kapeshin shpejt, të mësoheshin menjëherë, pa vështirësi, dhe t'u përshtateshin ritmeve muzikore të cilat gjallonin në krahinën e Kolonjës, Korçës, Skraparit, Përmetit, Beratit, Strugës e më gjerë.

I njohur dhe i pëlqyer masivisht në popull, zyrtarisht Sali Butka ishte lënë në harresë të plotë, ishte injoruar, për të mos thënë se ishte mohuar qëllimisht. Po vallë kaq e pasur me emra është letërsia shqipe e viteve të Pavarësisë sa të mohojë emra të tillë si Sali Butka? Përse vetë ne kemi prirjen ta varfërojmë sa më shumë letërsinë tonë, ashtu siç kemi prirjen të zvogëlojmë përmasat e historisë sonë, duke mohuar, dënuar e dëbuar personalitete të shquara, duke u rrekur me mish e shpirt për t'u ngjitur atyre ndonjë bisht apo përbaltje të padenjë, edhe kur shumica e jetës së tyre ka qenë thjesht një jetë për Shqipërinë?

Është vështirë t'i përgjigjesh pyetjes pse u injorua dhe vazhdon të injorohet zyrtarisht Sali Butka. Kushdo

mund të mendojë se kur u duhej, apo kur nuk kishin si e fshihnin të vërtetën e bëmave të tij, e dekoronin. Por pas çdo decorate, të cilën ishin të detyruar ta akordonin, autoritetet shtetërore mbanin gati dajakun. Dhe ky dajak kishte formën e injorimit, mohimit, mënjanimit. Natyrisht Sali Butka nuk është një poet elitar (në periudhën e letërsisë së Pavarësisë të tillë ka shumë pak). Ai nuk mund të studiohet as për "mrekullitë" artistike, dhe as për "personalitetin" e madh krijues. Por ai është, ekziston, frymë merr, jep e merr me lexuesin, shumë e dine përmendesh, një shumicë edhe më e madhe këndojnë me ritmet kolonjare tekstet e tij patriotike, nganjëherë pa e ditur se ato vargje kanë rjedhur nga qenia dhe shpirti i poetit të Butkës. Mjaft prej tyre kanë vlera të mirëfillta artistike.

Çfarë ka më tepër, fjala vjen, Mihal Grameno, publicistikën e të cilit ne e kemi mësuar nëpër shkolla dhe

kemi bërë shumë mirë? Ashtu siç është bërë shumë gabim që na është fshehur, mohuar dhe vjedhur Sali Butka. Për të respektuar të vërtetën dhe historinë duhet të themi se veç përhapjes spontane në popull që ishte për t'u konsideruar,

përkundrazi, poezitë e Sali Butkës janë shkruar dhe përmbledhur edhe në një libër të veçantë me titullin "Ndjenja për atdhenë" në vitin 1920 në Korçë nga shtypshkronja Dhori Koti. Bazë e kësaj përmbledhjeje është edhe libri që i japim sot lexuesit. Ndërsa Andrea Varfi ka botuar prej vjershëtorit të Butkës një libër me poezi të zgjedhura të mara nga libri i mësipërm, por edhe nga shtypi i kohës.

Duke prekur një temë të tillë kaq të ndjeshme dhe që ende plaga nuk i ka zënë kore, (mënjanimin apo

mohimin e poetëve) m'u kujtua një ngjarje e fundviteve gjashtëdhjetë gjatë praktikës pedagogjike mësimore në shkollën e mesme të Kuçovës (atëherë Qyteti Stalin). Isha pothuajse në moshën e maturantëve, të cilëve më qëlloi t'u shpjegoja një prozë të Mehmet Shehut, me të cilën fillonte antologjia letrare e maturës. Kur mbarova shpjegimin ose më saktë leximin e pjesëshëm, se çfarë mund t'i shpjegoje atij teksti fare të zakonshëm, një djalë i gjatë, i hequr, simpatik, u ngrit dhe pa iu trembur syri fare, tha gati me revoltë: "E çfarë ka ky tekst që hap antologjinë e letërsisë për maturën e shkollave të mesme? Apo e kanë futur në antologji vetëm se autori i tij është kryeministër?"

Ktheva kokën dhe shikoja nga dritaret peizazhin kuçovar të sterosur nga gazi dhe nafta, që digjej. U

interesova për djaloshin, e quanin Shpëtim Gina. Dytre vjet më vonë u fol gjatë për talentin e tij si dramaturg (arriti të botojë disa drama, madje, në mos gaboj, ndonjëra mund t'i jetë venë edhe në skenën e Teatrit Popullor (kështu quhej atëherë).

Por behari i lulëzimit të Shpëtim Ginës ishte i shkurtër. Dimri i tmerrshëm e priste me një kosë të pamëshirshme në dorë. Nuk vonoi dhe u përhap lajmi se dramaturgu i ri i talentuar nuk ishte mirë mendërisht dhe ishte mbytur në një nga kanalet e Myzeqesë. Natyrisht, këtë nuk e besuan edhe vetë ata që e kishin përhapur: përkrahësit dhe sponsorizuesit e letërsisë kryeministrore. Edhe atëherë, edhe sot njerëzit mendojnë ndryshe: Shpëtim Ginën e vranë pikërisht ideatorët, përkrahësit dhe sponsorizuesit e letërsisë kryeministrore.

Përse atëherë të mos mendojmë që Sali Butkën vjershëtor e mënjanuan apo mohuan pikërisht këta

përkrahës? Ky lloj mënjanimi Sali Butkës nuk i është bërë vetëm në kohën e diktaturës komuniste. Ai ka filluar herët sepse ai ishte qemalist (mbështetës i Ismail Qemalit), fanolist dhe antimonarkist. I lidhur ngushtë me atë që ndodhte në botë, poetit nga Butka i vinte rregullisht nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës gazeta "Republika" në të cilën ishte abonuar. Mjaftoi ky fakt i thjeshtë që në një shkresë ndalimi drejtuar Zogut nga ministri i brendshëm i asaj kohe për të gjithë ata që lexonin këtë gazetë, emri i Sali Butkës të ishte në krye. Ndërsa kur poeti Lasgush Poradeci shkroi në vitin 1938 një nekrologji për vdekjen e poetit të Gramozit, gazeta "Drita" e kohës ia refuzoi shkrimin me arsyen se luftëtari dhe poeti Sali Butka ishte kundërshtar i mbretit Zog.

E pra, hallet, ndalimet, privimet, mohimet dhe mënjanimet e poetëve janë shumë të lashta dhe gjithmonë të zymta, të errëta si një hapsanë.

3.

Nuk është e vështirë të dallosh shqetësimin poetik të Sali Butkës, të identifkosh rrënjët e tij poetike, frymëzimin dhe tokën mbi të cilën ka hedhur rrënjë dhe ka rritur shtatin muza e tij poetike. I rritur në një familje dhe mjedis të lidhur ngushtë me Shqipërinë, hallet dhe problemet e saj, gëzimet dhe hidhërimet, shpresat dhe zhgënjimet, lotët dhe gëzimet, dasmat dhe vdekjet, ftoret dhe disfatat, Sali Butka qesh dhe qan bashkë me Shqipërinë, lind dhe vdes bashkë me të. Poezia e tij nga fllimi në fund ka vetëm një kryefjalë: Shqipërinë, atdheun të cilin jo rrallë here e quan edhe mëmëdhe, shqiptarët, Kosovën e Çamërinë, por dhe vendlindjen, Kolonjën.

Rrallë gjen një vjershëtor t'i këndojë kështu vendit të vet, popullit të vet. Ky burrë që prej kohësh jeton në kufjtë e legjendës për trimërinë dhe sakrifcat që ka bërë për lirinë dhe mbrojtjen e tërësisë tokësore shqiptare, përpara Shqipërisë ndjehet një fëmijë i pafuqishëm, një burrë i dorëzuar pa kushte, pa rezistencën dhe lëkundjen më të vogël. Ai që nuk u dha kurrë para breshërisë së plumbave, nuk u dorëzua para dhembjes, kur pa dy djemtë e tij shtrirë pa jetë nga plumbat e armiqve, që nuk nxori asnjë tingull ankimi kur i operuan pa narkozë në Bari (e kërkoi vetë) syrin e dëmtuar nga një plumb në betejën e Nikolicës, është gati të kthehet në një qënie delikate dhe të pambrojtur para bukurisë së vendlindjes, është gati të "digjet për bukurinë":

Burime, ju vijmë pranë
në të mira e në të liga;
neve dhembjen për vatanë
dhe ju lotët pika – pika.
(Burimet).
Cila antologji poezie do t'i rezistonte për ta përfshirë në gjirin e saj këtë strofë të kësaj vjershe?

Ujët që ju del nga shpirti
nuk të ftoh, po të ndez gjinë;
të digjesh për bukurinë,
të shkrihesh për Shqipërinë.

"Të digjesh për bukurinë... " Kush nuk do ta kishte zili këtë varg? Kush do të mbetej i ftohtë dhe i paprekur nga imazhi që të zgjon ky varg? Naimi thotë "do të shtritem/ të venitem/ si kandili kur s'ka vaj". Butka është më i prerë: do të digjem...Jo vetëm kaq. Nuk mjafton vetëm djegia. Në mënyrë paradoksale djegia shkaktohet nga uji, uji brisk i ftohtë i Gramozit, siç thonë nga ato anë. Nga uji që përdoret për të shuar zjarrin. Por poezia e Sali Butkës e përdor atë për të ndezur zjarrin në gji. Butka që na ka habitur me bëmat e tij prej luftëtari, tani na habit me imazhet e befta poetike:

Ujët që ju del nga shpirti
nuk të ftoh, po të ndez gjinë:

Aq e fortë është lidhja e Sali Butkës poet me Shqipërinë, vendlindjen, atdheun ose mëmëdheun

(i përdor të dyja format, si për të na treguar se vetëm "atdheu" apo vetëm "mëmëdheu" nuk e nxë dashurinë e tij për Shqipërinë), sa pothuajse në çdo vjershë kryefjalë mbetet nga fllimi në fund Shqipëria, mëmëdheu ose atdheu. Një statistikë domethënëse. I shtyrë nga kureshtja numërova se në vjershat e këtij libri, Sali Butka përdor 103 herë fjalën "Shqipëri", 32 herë fjalën "shqiptarë", 29 herë fjalën "kolonjarë", 64 herë fjalën "atdhe" ose "mëmëdhe".

A nuk tregojnë këto statistika që mund t'i verifkojë kush të dojë se në zemrën e Sali Butkës poet rrihte vetëm Shqipëria, se zemra e tij rrihte vetëm për Shqipërinë?

"Për lirinë, për lirinë,
Lum kush vdes për Shqui[përinë!"
("Lirija")

4.

Nganjëherë më duket se Sali Butka luftëtar i bie nëqafë Sali Butkës poet. Duket sikur i pari përpiqet ta zbehë apo ndoshta ta lërë edhe në harrim të dytin. Natyrisht, pushka e Sali Butkës flakëriti aq shumë sa iu tregoi edhe miqve dhe armiqve, por edhe atyre që nuk shihnin mire apo që nuk donin të shihnin, se kush ishte Shqipëria dhe shqiptari, se kush ishin trojet dhe kufjtë shqiptarë. Por dihet edhe një diçka tjetër, saga heroike e Sali Butkës do të ishte më e varfër pa ditarin poetik. Them "ditarin poetik", sepse kushdo i lexon këto poezi, kupton se ato janë shkruar pas betejave. E shtëna e pushkës është pasuar menjëherë nga e shtëna e penës. Të dyja janë të lidhura aq ngushtë, sa do të ndjeheshin keq pa njëra tjetrën.

Poezia është ditari i jetës dhe betejave të Sali Butkës. Por është edhe një pjesë e mirë e historisë sonë, e ngjarjeve kryesore të saj, e heronjve dhe personaliteteve historikë të saj. Kur u bë Shqipëria, u shkëput nga Turqia dhe u kthye nga Perendimi, Sali Butka ringjall Abdyl Frashërin:

"Ngehu, Abdyl Bej nga varri
Se t'u mbarua qëllimi
Hidh sytë nga Perëndimi"

"Perëndimi" i rilindasve tanë, edhe i Sali Butkës.

Bajo Topulli, themelues i Komitetit të fshehtë në Manastir "Për lirinë e Shqipërisë" anëtar i të cilit ishte

edhe Sali Butka, na flet nga poezia "Bajo Topulli" për historinë. Sali Butka poet nuk mund të heshtëte për asnjë ngjarje që lidhej me historinë dhe fatin e Shqipërisë. Në këto beteja, ranë qindar dëshmorë, të cilëve u këndon Sali Butka, për t'i bërë të pavdekshëm, si "Trimit Spiro Ballkameni, Gani Butkës, Jake Panaritit, Nasi Spiro Qafëzezint, Nuçi Trebickës, Qazim Panaritit, Iljaz Butkës e të tjerë, që "u ndrittë shpirti dhe varri".

Të gjitha ngjarjet kryesore të Shqipërisë kalojnë në vjershat e Butkës si në një ekran. Përballimi i ushtrisë

turke të Xhavit Pashës në frontin e lumit Vjosa (vjershat "Vlorës", "Yjet e Shqipërisë", "Ismail Qemalit" etj). Lufta për të mbrojtur kufjtë nga ushtritë greke: vjershat "Mbreti i Greqisë", "Lufta e Qesarakës", "Qaf e Martës" dhe veçanërisht "Një përmendore" kushtuar betejës së Nikolicës, një nga betejat më të njohura ku luftëtari poet humbi njërin sy të cilin e operoi pa narkozë në Bari, për të rrëfyer qëndresën e shqiptarit. Aq jehonë ka bërë kjo ngjarje sa tani ka kaluar në një bëmë që tregohet kudo dhe sa më shumë tregohet aq më tepër kërkohet, sa më shumë vjetërohet, aq më shumë rinohet. Ndodh që edhe ata që e tregojnë të shtojnë pa të keq diçka nga vetja. Kështu ndodh me ngjarje të cilat tejkalojnë protagonistin, fshatin apo krahinën ku kanë ndodhur dhe bëhen pronë e të gjithëve, e gjithë vendit.

Ngjarjet e mëvonshme në kohën e Princ Vidit, të Luftës së Parë Botërore, Republika e Korçës, Kongresi

i Lushnjës, Lufta e Vlorës, Konferenca e Ambasadorëve në Londër, Çamëria, Kosova apo gjithçka që vijoi pas viteve 20 në Shqipëri kalojnë nëpër skanerin poetik të Butkës, ashtu siç kanë ndodhur, ashtu siç kanë qenë. Ato janë ndjerë nga një zemër që rrihte vetëm për Shqipërinë, janë mbrojtur nga një pushkë që qëllonte vetëm në emër të Shqipërisë dhe janë kënduar nga një shpirt i kulluar shqiptar.

Krahas përpjekjes poetike për të shënjuar ngjarje historike, shohim qartazi edhe portretizimin e

personaliteteve historike, botën e tyre të brendshme, arritjet, zhgënjimet, gëzimet dhe hidhërimet, të shkrira edhe me ndjesitë e vetë poetit.

Fjal'e tij, fjal'e një plaku,
Zemr' e tij si zemër djali.
Na u ngroh dhe na u ndez gjaku,
për mendimet që na fali.
("Dhëmbje")

Si çdo poet, edhe Sali Butka e ndien dhimbjen dhe gëzimin e krijimit poetik dhe të këngës, nga marrin jetë vjershat e tij:

Ç'është o ç'është këngë e shkretë:
është gaz e është dehje,
është duf nga zemra vetë,
është dhëmbje, është prehje.
(Ç'është kënga")

Ja sesi në dy vargje bën portretin e Shahin Kolonjës, si rilindës, si pionier i shtypit shqiptar:

Ësht'i gjallë Shahin Kolonja,
i derdhur në ato shkronja...

Poeti e përfytyron pavdekësinë jo në bronx, por të derdhur nëpër shkronja, një imazh i papërsëritshëm në letërsinë shqipe.

Ndërkohë që në poezinë e Sali Butkës, gjejmë, krahas epikës, edhe ndjeshmërinë lirike, krahas bukurisë

njerëzore edhe bukurinë e natyrës, veçanërisht tek vjershat: "Në mëngjes dola pa gdhirë", "Dit'e verës",

"Frashërit", "Fshati im", "Kolonj' e bukur Kolonjë" etj.

Nuk e di pse në mbyllje të këtyre shënimeve m'u kujtuan fjalët e Luigj Gurakuqit kur e vizitoi bashkë

me Mihal Gramenon Sali Butkën në spitalin e Barit, pas operimit të syrit të dëmtuar në betejën e Nikolicës. Bejtes së Gurakuqit "ku je lulja në lëndinë", butkalliu iu përgjigj po me bejte: "Nuk jam lulja në lëndinë/ po guri në rrokullimë".

Nuk ishte frika nga vdekja. Ishte pezmi se kishte mbetur pa njërin sy që i duhej aq shumë për pushkën,

por edhe për penën. Edhe pse mbeti me një sy, ai deri në fund të jetës pa aq qartë sa nuk shikojnë as ata që kanë sy shqiponje, siç thuhet. Sepse pa dhe ndjeu vetëm Shqipërinë, pa dhe ndjeu në emër të saj.

Libri është përqafohet gjerësisht nga publiku dhe konsiderohet si një vlerë e munguar

KARIKATURA E NJË REGJIMI NË ROMANIN "DËMTUAR GJATË RRUGËS", TË BESNIK MUSTAFAJT

"Mustafaj, me romanin e tij më të ri, na ndihmon të shohim dhe të kuptojmë se jo vetëm një njeri, por një shoqëri e tërë u dëmtua gjatë rrugës së absurdit të komunizmit shqiptar! Këtij procesi surrealist të dëmtimit gjatë rrugës, nuk i shpëton dot askush, pavarësisht se ku mund të ndodhet për momentin"

Nga Arben Cejku

Një vepër arti, pikturë apo skulpturë, mund të dëmtohet gjatë rrugës edhe për shkak të formës së transportit. Po një vepër letrare (roman, poezi, tregim, dramë, novelë), a ka të ngjarë që të dëmtohet gjatë "transportit" të saj nga shkrimtari tek lexuesi, kur ajo hyn në procesin e leximit? Unë mendoj se, po! "Dëmtimi gjatë leximit", nuk lidhet me dëmtimet e librit si objekt fizik, por nënkupton mos-vendosjen apo shkëputjen e parakohshme të urave të komunikimit midis një vepre në proces leximi dhe një lexuesi, që kërkon të reflektojë mbi atë që po lexon. Sa e sa libra i kemi shfletuar vetëm në faqet e para dhe pastaj i kemi braktisur? Sa e sa të tjera nuk i kemi zënë me dorë fare, duke i lënë në pluhurin e harresës?

Janë një mijë e një arsye, ato që ndikojnë në fenomenin e dëmtimit të një libri, gjatë leximit…

Dëmi më i madh, që pëson një vepër letrare, në këtë që po e apostrofojmë si "dëmtim gjatë leximit" është, kur kjo vepër nuk lexohet fare! Kjo shkakton edhe dhimbjen më të madhe për një shkrimtar, për një krijues! "Dëmet" e tjera gjatë leximit, siç mund të jenë mungesa e vëmendjes së plotë nga ana e lexuesit, pamundësia për ta rrokur në tërësi vlerën artistike të veprës, dituria e cunguar historike, për të kuptuar kontekstin dhe mesazhin politiko - shoqëror të veprës, mungesa e shijeve të holla artistike, për të kuptuar stilistikën dhe gjithë figuracionin e veprës, pamundesia abstraguese, për të vlerësuar personazhet si heronj real të përditshmërisë etj, etj, janë në fakt "dëme kolaterale", të pa konsiderueshme. Vepra, sigurisht, që mund të jetë "dëmtuar gjatë leximit" edhe për këto shkaqe, por për autorin, rëndësi ka që ajo ka gjetur një lexues të caktuar. Ashtu si gratë lehona, që kanë frikë, për krijesën e tyre të brishtë, kur e shohin se ndonjëherë bie në duar të pastërvitura, edhe shkrimtarët brengosen se mos vepra e tyre, si një bebe, bie dhe dëmtohet..

Në procesin e gjatë të leximit, gjithnjë kam patur dhe vazhdoj ta kem brengën se, në mos edhe unë kam dëmtuar gjatë leximit disa vepra! Kjo më ka nxitur që t'ju rikthehem e t'i rilexoj disa prej tyre. Rileximi më ka provuar se kam dëmtuar, sidomos kryevepra, gjatë leximit. Rileximi i veprave të shquara më ka bërë të kuptoj se, gjatë procesit të leximit të parë, kam patur humbje dhe nuk e kam vjelur dot të gjithë produktin. Pra, në këtë rast, jam dëmtuar unë gjatë leximit. Kur i jam kthyer për së dyti dhe ndoshta edhe për së treti, kam vënë re humbjet, boshllëqet që kam patur gjatë leximit (leximeve) të mëparshme. Ka qenë e njëjta vepër, i njëjti autor. Por në çdo lexim, kam kuptuar më mirë, kam parë më mirë dhe kam mësuar më shumë nga vepra.

Shkëndijën fillestare për këtë apostrofim të marrëdhënies magjike; shkrimtar – vepër – lexues, ma nxiti titulli i romanit, "Dëmtuar gjatë rrugës", i shkrimtarit Besnik Mustafaj.

Pasi e lexon këtë roman, kupton se nuk janë vetëm veprat, ato që "dëmtohen gjatë rrugës", por edhe vetë shkrimtarët apo njerëzit që e rrethojnë atë. Madje, edhe një shoqëri e tërë, mund të dëmtohet gjatë rrugës! Ecja në rrugën e jetës, nuk është vetëm një ecje horizontale hap pas hapi, por ajo shpesh herë mund të transformohet në një kërcim hendeqesh misterioze ose në një kacavjerrje me këmbë duar në murin që të del përpara…

Mustafaj, me romanin e tij më të ri, na ndihmon të shohim dhe të kuptojmë se jo vetëm një njeri, por një shoqëri e tërë u dëmtua gjatë rrugës së absurdit të komunizmit shqiptar! Këtij procesi surrealist të dëmtimit gjatë rrugës, nuk i shpëton dot askush, pavarësisht se ku mund të ndodhet për momentin. Gardianët e së keqes, janë gjithnjë vigjilent, siç është një nga personazhet kryesore në roman, "Shoqja Rushe", e cila, si një flutur, pasi sillet e sillet rreth dritës së partisë, më në fund, edhe ajo përplaset, duke rënë përtokë pa mëshirë dhe pa asnjë vlerë.

Kurthi ku bie lexuesi i këtij romani është keqkuptimi se ai këtë vepër – homazh, shkrimtari Besnik Mustafaj e bëri për nënën e tij! Madje, në ditët e panairit të librit, vitin e kaluar, gjatë promovimit, dëgjoja shumë njerëz që thoshin, " Besniku ka bërë një roman për nënën". Unë, pa e lexuar, u thoja me humor se, me siguri që, "Nëna e Besnikut është më e mirë se Nëna e Gorkit"…



Në roman, "Shoqja S." është personazhi kryesor, por njëkohësisht është edhe nëna e autorit. Vetë romani është shkruar në stilin e një memuari autobiografik. Saga e romanit (historia) përshkruhet si një ngjarje familjare, sepse ajo përgjithësisht zhvillohet brenda shtëpisë së nënës së autorit. Edhe heronjtë kryesorë të rrëfimit janë një grusht familjarësh, si psh, nëna e autorit, babai, gjyshi, dy vëllezërit dhe disa të njohur përreth. Duke përdorur këtë dinakëri artistike, autori e shpëton veprën e tij nga dëmtimi gjatë leximit. Por kjo lloj letërsie, nuk është gjithnjë e garantuar për të arritur suksesin artistik! Ajo është një nga sfidat më të mëdha, sprovat më delikate, kur krijuesi vendoset, herë në në rolin e objektit dhe herë në rolin e subjektit, në romanit që po shkruan. Por këtë sprovë, Mustafaj e ka tejkaluar, kryesisht tek romani pararendës , "Autoportret me teleskop".

Tek "Dëmtuar gjatë rrugës", autori herë shikon me sytë e një bebeje të vogël, herë abstragon dhe shikon veten me sytë e nënës së tij, ndërkohë që në fillimin dhe në fund të romanit është djali shkrimtar dhe figurë publike, që plotëson "amanetin e nënës", që hiq më pak, është detyra për të shkruar një roman të jashtëzakonshëm. Dhe ja ka dalë me sukses!

Në këtë roman, Mustafaj merr për bazë një histori të thjeshtë njerëzore, të treguar si brengë shpirti nga nëna e tij, dhe e vendos në qendër të veprës duke e kthyer dalë nga dalë në kryehistori, në kryengjarje, në kontrast të thellë me ngjarjet e mëdha, (si, p.sh, vizita e Hrushovit në Tiranë) që prodhon vetë shteti. Madje edhe super shteti, siç ishte Bashkimi Sovjetik apo Kina.

Në qendër të romanit është historia e thurjes së një palë çorapesh për ish-udhëheqësin sovjetik, Hrushov, nga një grua e zakonshme, në një skaj të largët të republikës së revolucionarëve shqiptarë. Rreth kësaj ngjarjeje dhe këtij triki artistik, Mustafaj ndërton një kryevepër të ironisë, sarkazmës, alegorisë dhe ndëshkimit artistik për një nga regjimet më të egra në Europë! Duke vënë në qendër të romanit një personazh të thjeshtë, të pa arsimuar, të tkurrur në vetvete, një grua tradicionale në sjellje e mendim, të përkushtuar për familjen, një nënë tipike shqiptare të viteve '60, Mustafaj, e kthen nënën e tij në simbol të mijëra nënave shqiptare, që nuk e kanë djalin "shkrimtar", që t'u shkruajnë historinë, por që kishin të njëjtin fat si nëna e Besnikut! Autori, fillimisht kujdeset të krijojë dy grupimet shoqërore, që në njërën anë simbolizojnë popullin e thjeshtë dhe në anën tjetër klubin e "njerëzve të rinj", që ishin një prodhim hibrid i taborreve ideologjike, që shkelnin mbi Shqipërinë.

Ngjarjet zhvillohen në një qytezë të vogël dhe të izoluar veriore, që për nga simbolika është vetë Shqipëria e diktarorit Hoxha. Kjo vihet re lehtë nga marrëdhënia kapilare që është mes kësaj province dhe kështjellës së socializmit, që është larg në Tiranë.

Nëna e shkrimtarit, jashtë vullnetit të saj bëhet pjesë e teatrit absurd, duke marrë role që tentojnë ta ndryshojnë, ta deformojnë si njeri. Pra, ta dëmtojnë gjatë rrugës. Madje, në një moment, kur ajo nga një grua e rëndomtë u bë "shoqja S", sepse veprën dhe shembullin e saj revolucionar e proklamoi vetë E. Hoxha, ndjeu dyshimet e para brenda vetes. Kur këtë ja tha rastësisht edhe një nga shoqet e saj të ngushta, komshia Drita, atëherë, beteja mes njeriut të ri socialist dhe atij tradicionalist, u bë më e ashpër brenda botës së saj të pastër. Ajo kishte qenë krejt e virgjër politikisht dhe ideologjikisht, deri në momentin që thuri ato dreq çorapesh për udhqheqësin botëror dhe puna e saj doli në gazeta dhe takime publike. Në këtë rrugëtim të shkurtër, "Shoqja S", gati përdhunshëm vihet në skenën e teatrit tragji-komik për të ushqyer popullin me propagandë, jo për të plotësuar nevojat e saj shtëpiake. Në këtë ngarendje ajo, përveç fëmijës së vogël , lë vetëm herë pas here edhe gjyshin e autorit, i cili nga ana e vet, është simboli i malësorit tradicional, që as nuk e refuzon as nuk e pranon dot gjithë atë histeri enveriste, që përballë tij shfaqet gjithnjë kërcënues. Ashtu siç kanë bërë miëjra e mijëra shqiptare në këtë udhëtim paradoksal, edhe nëna e autorit, "Shoqja S." e kryen golgotën e absurdit . Por, pak para fundit, ajo ndeshet me Dritën, komshien e saj, të cilën po e internojnë. Në këtë moment, "Shoqja S", flak tej frikën dhe çdo lidhje me klubin e shoqeve të agjitpropit dhe zyrave të partisë dhe i gjendet pranë me përkushtim e zemër, si dikur. Kur dy miket e vjetra gjenden përballë, Drita, vlerëson gjestin e "Shoqes S" dhe i thotë, "ti nuk ke ndryshuar..". Ky pohim i Dritës ishte lajmi më i mirë për nënën e autorit, e cila pas kalimit nëpër gjithë atë labirinth angazhimesh publike dhe zyrash shteti, kish mbetur përsëri njeri me shpirt të mirë dhe nuk ishte bërë plotësisht "njeri I ri", nuk ishte bërë fiks si shoqja Rushe. Pra, ishte dëmtuar fare pak gjatë rrugës së vështirë, që kish kaluar.

Leximi i romanit nis si kuriozitet, për të vlerësuar, sesi një shkrimtar mund të shkruaj për nënën e tij. Por në fund, romani "zhgënjen" për mirë. Nuk është një vepër homazh për një nënë të vetme, por është një kryevepër e letërsisë moderne e realizmit total, e cila trajton në mënyrën më të

Vijon nga faqja 30

Mendime për vëllimin me tregime " Porta e mbyllur e Dashirisë " e autorit Hyqmet Hasko

HASKO,NJË SHKRIMTAR ME PRIRJE SA DREJT TRADITËS AQ DHE NDAJ MODERNES

“ Pas disa vëllimeve me poezi, disa përmbledhje me tregime e novela dhe disa romane, shkrimtari, poeti dhe kritiku letrar Hyqmet Hasko vjen para lexuesit me një liber të ri, me tregime të një lloji të veçantë, që nuk njeh ndonjë traditë të pasur në Shqipëri, por që rrok një nga vektorët më të ndjeshëm të shoqërisë, pra vjen me një liber ku ne themele eshte jeta njerozere, veshterisite, lufta per jetuar dhe mbijetuar”.

Nga Kristina Demiri Dojçe, Selanik

Hyqmet Hasko,është një shkrimtar me profil të tij, me prirje sa drejt traditës aq dhe ndaj modernes. Nga Kristina Demiri Dojce . Botimi i një libri të ri është gjithmonë një kënaqësi e veçantë, sidomos kur kemi të bëjmë me autorë shqiptarë, që nëpërmjet artit arrijnë të sensibilizojnë lexuesit e tyre për problemet e theksuara etike, sociale dhe ekzistenciale të shqiptarëve, jo vetëm në Shqiperi, por edhe në shtetet e shumte ku janë detyruar të emigrojnë për t'i shpëtuar mjerimit ekonomik, apo mungeses së ligjit që mbreteron në vendlindjen e tyre. Me këtë përjetim e mora në dorë librin me tregime " Porta e mbyllur e Dashurisë " te mikut tim Hyqmet Hasko, me ndjesinë e mirë se kam të bëj me me shumë histori, më së paku, të shkruar me frymë, me shpirt, me dashuri për jetën dhe vlerat njerëzore. Hyqmet Hasko,është një shkrimtar me profil të tij, me prirje sa drejt traditës aq dhe ndaj modernes. Dhe, e them që në krye të herës, jo vetëm që nuk mbeta e zhgënjyer, por u befasova. Pas disa vëllimeve me poezi, disa përmbledhje me tregime e novela dhe disa romane, shkrimtari, poeti dhe kritiku letrar Hyqmet Hasko vjen para lexuesit me një liber të ri, me tregime të një lloji të veçantë, që nuk njeh ndonjë traditë të pasur në Shqipëri, por që rrok një nga vektorët më të ndjeshëm të shoqërisë, pra vjen me një liber ku ne themele eshte jeta njerozere, veshterisite, lufta per jetuar dhe mbijetuar. Për të qenë më e saktë në këtë etikim, ky nuk është një liber i mirëfilltë me nje synim te vetem te shkruaj nje liber , ndonëse tematika e tij, ngjarjet dhe sfondi rrëfimtar janë nga lufta dhe qëndresa njerizore ne rrugen e perditeshme .,Narracioni përfshin dhe plot gjendje lirike, psikologjike episikoanalitike, të shkruara me një stil të veçantë, të ngjeshur e dinamik. Libri I ri me tregime" PORTA E MBULUR E DASHURISE " lexohet me endje, pasi tregim pas tregimi, faqe pas faqeje, autori zbulon me një anë të një rrëfimi mbresëlënës emocionet e jetës të një rrefimtari, që në çdo hap të tij ka të bëjë me të panjohurën dhe të perditeshmes njerzore. Është një botë që duket se shkrimtari e njeh mirë, pasi një pjesë e rëndësishme e tregimeve të tij jane ne optiken e nje vezhgimi te holle, optikë për të cilën ai duket se ka një njohje të gjërë dhe të thellë. Dy shtyllat më të spikatura të rrëfimit të Hyqmetit janë gjetja e intrigës dhe paraqitja e detajeve mjaft të goditura. Ai nuk vrapon pas temave të antikitetit dhe për ta bërë atë lidhjet e kohërave, filozofinë e kohërave. Optika e tij është shikimi i jetës i problemeve të mprehta sociale.Kam para sysh disa nga tregimet e botuara ditët e fundit. Tregimi “Porta e mbyllur e dashurisë” në të njëjtën kohë të dërgon në një klithmë të fortë. Një fabul e thjeshtë një intrigë meriottre për një shirmtar. Brenda trillimit dhe reales sikur pranojmë të dytën. Është një fabul që diku e dëgjojmë si befasi dhe duam ta themi kudo po këtë meritë e ka vetëm Hyqmeti që na e thotë të gjithëve Në atë letër të shkruar në trupin e foshnjës së braktisur shkruhet se ai që do ta rrisë atë do ketë mbarësiinë më të madhe. Kaq mjafton që lexuesi ta vazhdojë me interes këtë tregim e pastaj ta marrë mesazhin më vonë. Në rininë e saj vajza Fatlinda, dikur e braktisur, bie në dashuri me djalin e familjes së re. E bukur, e rrallë e jashtëzakonshme, po ja që rrëfimi të intrigon. Djali nuk pranon dhe në fund ajo vendos që të bëhet ndihmësja e djalit që lind djali. Mjaft pikëpyetje lindin në fund mjaft diskutime, po kjo nuk është më detyra e autorit, po ajo që lexuesi e merr me vete kudo intrigën. Është mjaft emociones mbyllja e tregimit “Ti?!!!...Ti je ajo?!!!-e pyeta me ngulm teksa ajo ikte me ngut nëpër tisin e një mjegulle që sapo kishte rënë dhe sillte me vete një trazim të gjithëkohshëm… Nuk foli. Vetëm iku vetëtimthi, duke nxituar, pa e kthyer kokën pas, sikur të kishte frikë se mos më lëndonte sado pak. Ndeza një cigare. Ishte cigarja e parë pas njezet vitesh që e kisha lënë. Fjollat e tymit të kaltër sikur ndiqnin siluetën e saj të brishtë, që po ikte me nxitim nëpër mjegull. “ Një subjekt për skenar filmi. Një tjetër intrigë një konflikt i fortë social në tregimin “Një varr për nënën”. Bosi i një firme e vret gruan që punonte në firmën e tij se ajo nuk po dorëzohej për qëllimet e tij të mbrapshta. Vajza e saj më vonë kërkon që të punësohet në firmën e tij dhe ai dëshiron që ta bëjë dhe këtë viktimë të egërsisë së tij dhe zbulohet si vrasës. Temë aktuale. Një mesaszh i fortë letrar nga autori. Një vleësimi veçantë vjen për regimim “Refuzimi i mirënjohjes së Nivanës”. Niviana, e re e papunë, me një arsim mjaft të mirë falë drejtësië, meritës dhe humanizmit të një nëpunësi të ri gjen punë. Gjen qetësinë dhe rregullon ekonominë e një ditë, qoftë nga dashuria apo dhe nga një mirënjohja që duhet ta tregonte kërkon që t’I jepet atij . Pa dyshim një befasi si subjekt, si fabul. Me mjaft mirësjellje, ajo refuzohet. Të gjithë marrim diçka nga mesazhi I tij. Humanizmi shumë hetrë I munguar këtu merr ngjyra të forta dhe të besueshme. Tregimi “Klithje në humnerë”. Është nga ato tregime që lexohen me një frymë Rrëfimi është I thjeshtë pa ngarkesa emocionale në metafora e në ndërtimin e dialogjeve, po mënyra se si e zgjidh ai konfliktin është mjaft e arrirë Në një botë në një shoqëri ku vlerat morale shpesh edhe nëpërkëmben, personazhi i tregimit vihet në një lloj dyluftimi. Ishte një humnerë imagjinare që atë e tërheq por që me forcën e ndershmërisë ai kthehet dhe fiton në këtë dyluftim. Alisa e njohura e tij e josh e tërheq drejt hymnerës morale, po ai është I fortë. E fiton betejën Mjafton që të lexohet momenti i sprovës së tij për të parë se sa larg ngrihet ai “Sytë e butë të shokut dhe fytyra engjëllore e të fejuarës nuk i ndaheshin për asnjë çast. E shtyu lehtë, por ajo në vend që të largohej, u qas më pranë tij dhe ai ndieu frymën e nxehtë të buzëve të saj të fryra në buzët e tij… -Mjaft! E gjithë kjo…e gjithë kjo është hunmnerë.” Me anë të rrëfimit emocionus në vetën e parë, çfarë lë të kuptohet ,se personazhet kryesor ne cdo tregim identifikohet me vetë autorin, shkrimtarin . Ai tregon për punën plot pasion dhe përkushtim të njerëzve që shërbejnë në frontin e përditeshmerisë Kete do ta shohim tek tregimi " Nje takim i veshtire " Mbi gjitheshka detyra e mjekes dhe pastaj detyra si e dashura e djalit, te njeriut, qe i kishte shkaktuar veshtiresi. Nuk jane te gjithe njelloj.Une e dua ate. Në një shtrat të tillë narrativ, ku sjell rrëfimet e drejtpërdrejta, horizontale dhe kthime në kujtesë, si retrospektivë, shkrimtari, here herë me tendenca të një vetë ironie të hollë, që shkon deri në alegori, përcjell mesazhin e kundërshtimit të së keqes, e luftës dhëmb për dhëmb me të keqen, në emër të sistemit të vlerave që mban në këmbë një shoqëri të shëndetshme dhe që nuk e pranon në asnjë rast nënshtrimin.Janë të panumërta tregimet e sjella nga autori në ilustrim të kësaj bote, të kësaj vetëdije, të këtij mesazhi që në rrugëtimin e tij nga shkrimi në letër deri tek lexuesi jam e sigurtë se shumëfishohet dhe pasurohet në ngjyra dhe aspekte jo vetëm emocionale por dhe reflektive. Te gjitha keto, do ti gjejme tek tregimi "Porta e hapur me zor" Tregimet tek libri“PORTE E MBYLLUR E DASHURISE” nuk janë aspak histori sentimentale, përkundrazi, ka drama te gjalla për të gjithë ata që në rrugën e tyre ndodhen me protagonizmin kryesor dhe bëjnë një përpjekje sizifiane për të gjetur të drejtën , te bukuren ,imendjaten . Shkrimtari Hyqmet Hasko duket se është një shkrimtar me profil të tij, me prirje sa drejt traditës aq dhe ndaj modernes, me një aparat krijues të fortë, plot figura të gjalla dhe te proritëm rrëfimtar. Ai në thuajse gjithë krijimtarinë e tij të gjërë e të larmishme ka për objekt shqyrtimin estetik, rrëfimtar, filozofik dhe etik, si dhe për nga ngarkesa emocionale, pra në qendër ka botën shqiptare, fatin e saj në një kohë hapësirë të rrethuar e të paragjykuar historikisht. Do te vecoja tregimin, "Pranvere e dehur", "Lotet ne syrin e nje mikeje." Shkrimtari Hyqmet Hasko duket se është një kërkues realist në psikologjin e shpirtin shqiptar, me një stil të ngjeshur e konciz, por njëherësh të ngrohtë e plot ngjyra, ku përzihen rrëfimi dhe depërtimi psikologjik e psikanalitik, me një gjuhë të zhdërvjellët dhe elegante, Ai na sjell në këtë libër më shumë se një shqetësim qytetar, për njerzit e ndershem të këtij vendi. Një ankth gati ekzistecial endet në këtë liber, ku përzihet e shkrihen në një vektor estetik tragjizmi dhe poetika e për kujdesin njerëzor, mizoria e barbaria e botës së kriminelëve, trafikantëve, tutorëve dhe kulti I dashurisë së botës shqiptare. Ajo që e bën të dallueshme krijimtarinë e Haskos, si dhe në këtë liber të tij, është linja shumëgjyrëshe përshkruese dhe meditative, ritmi i përndezur, figurat e gjalla dhe të freskëta, vrulli I fjalës dhe t hellësia e ndjenjës dhe mendimit.Aventura e tij shkrimore është një aventurë e bukur, në një rrugëtim të natyrshëm drejt vetvetes poetike. njëherësh të një udhëtimi në thelbin e vetëkohës shqiptare.Shkrimtari konfiguron një peisazh të thyer të shpirtit njerëzor, na jep tablonë lëvizje, si vetë jeta e saj dinamike, në kërkim të gjërave të bukura, për të cilat ia vlen të jetosh.("Dita e pare e lirimit) Krijimtaria e Haskos dallohet për stilin e ngjeshur, poetikën e rrëfimit, fuqinë e përshkrimit dhe gjallërinë e mjediseve të përshkruara. Historia me realitetet e deformuara, ëndrrat dhe zhgënjimet janë “të fshehtat e tij përvëluese” që vënë në veprim rrëfimin, kujtesat, përjetimin dhe fantazinë.Hasko është një nga zërat më të veçantë të brezit të tij të shkrimtarëve, brez që erdhi relativisht vonë në letërsi, pas çlirimit të saj nga izmat te një kohe të sëmurë, duke tentuar të kapë me shpejtesi kohën e humbur per te shkruar një letërsi që mund të radhitet në mënyrën më dinjitoze me veprat e mira të kohës sonë në bashkësinë e letrave shqipe. Lexuesi do ta mirëprese këtë liber të ri me tregime të Hyqmet Haskos, pasi në protagonistet e tij, në ëndrrat dhe luftën e tyre për çdo perçastshme, do të gjejë një model të rezistencës aktive të një shkrimtari me plot vlera ndaj çdo skalioni nga ku vjen e keqja, dhe mungesa e të drejtës njerëzore, do të gjejë një rrugë ëndërrimi për një shoqëri të lirë e të çliruar nga barrierat, çfarë është devizë e çdo njeriu të lire dhe qytetari të lire të botës njerëzore.

Me 16 Mars Akademi përkujtimore në 1-vjetorin e ndarjes se Karadakut nga jeta

Shefki Karadaku një nga poetët dhe prozatorët më të veçantë të letrave shqipe

Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

AND-ja E PANDRYSHUAR E SHEFKI KARADAKUT

- Dr.Lutfi Turkeshi, gazetar&studjues nga Republika e Maqedonisë së Veriut, jo më kot, e vlerëson Shefki Karadakun si "Khajamin e ditëve tona". Në këtë konkluzion ai arrin pasi ka lexuar romanet "Puthja e ngrirë", "Njëmijë vjet dashuri", "Vila e magjepsur", "Salamandrat", "Filantropi", "Panagjerikus" e të tjerë, dhe vëllimet poetike "Kënga e korrave të drithit", "Melodi të Shkumbinit", "Ylberi". "Lumi me njëqind zemra" e "Feniks" të poetit e shkrimtarit Shefki Karadaku, i cili asnjëherë nuk do t'i nënshtrohej jetës edhe pse e vuante atë…

- Para pak kohësh, u botua në anglisht romani i Shefki Karadakut "PUTHJA E NGRIRE", nga një kopje e të cilit ju dhurua selive te huaja diplomatike në Tiranë. Dhe menjëherë vjen vlerësimi i ambasadorit gjerman Peter ZINGRAF për këtë roman tejet të arrirë që me të drejtë është mirëpritur e vlerësuar nga personalitete të botës letrare të kryeqytetit….

Në një shtëpi karakteristike, të lagjes Spahikorre, të qytetit të Elbasanit, 81 vjet më parë lindi, mori shkollimin bazë dhe nisi rrugëtimin e jetës Shefki Karadaku, i cili ndër vite do të bënte emër si një nga poetët e prozatorët më të mirë në rang kombëtar.. Këtë lagje, si dhe gjithë Elbasanin ai e konsideronte ADN-në e tij të pandryshuar. Në memorien e tij, sa qe gjallë, ruhej Spahikorrja e fëmijërisë, për të cilën me të drejtë pikëllohej kur e shihte se si është dëmtuar…, ruheshin banesat e traditës, të mbetura ende tashmë, si një dëshmi që dënon dhe akuzon!

I zhytur në nostalgjinë e kohës, ish - mësuesi dhe shkrimtari i talentuar rrëfente mjeshtërisht: "Ne, në Spahikorre i adhuronim pemët, veçanërisht ullinjtë; unë si poet, ca më shumë dhe, si të isha një druid i vërtetë. I kam kushtuar edhe një vjershë të veçantë njërit prej ullinjve të Spahikorres. Pale pastaj, shelgjeve dhe karakfteve hijerënda, apo shtegtimit magjepsës të shpendëve!". Mjafton qoftë dhe ky rrëfim i çiltër për të konkluduar se Shefki Karadaku, megjithëse një familjar i rregullt dhe përgjithmonë i obliguar, shpirtin e kishte prej bohemi të çliruar dhe të papërmbajtur.

Siç shkruan bashkëkohësi i tij Enver Kushi, brenda korpusit letrar, Shefki Karadaku ka sendërtuar shtëpinë e shpirtit të tij buzë Shkumbinit, atje ku "ylberi ka rënë mbi brigjet e trishtuara".

Dhe kjo shtëpi e shpirtit të poetit, ka mbledhur brenda stinët dhe qiejt e Elbasanit, shirat zemërak, çeljen e karakafteve, zërat njerëzor, jehonat e largëta të fëminisë, këngët e Isuf Myzyrit, kuajt e hazdisur, kopshtijet e vendlindjes, nënën dhe babain, Nadiren dhe mallin për Çamërinë, Dorianin dhe Albanën, fëmijët e tij.

SHTËPIA E SHPIRTIT TË TIJ...

Në këtë shtëpi të shpirtit të tij vijnë erërat e vjeshtës "të m'i krehë flokët kaçurrelë" apo ulen dhe ngrihen lejlekët. Përqark saj "qielli plot me re i leckosur vjen". Dhe kur heq çatinë e kësaj shtëpie shpirti, poeti sheh"qiellin plot me re që i leckosur vjen përqark…"

Dhe, kur hap dritaret e kësaj shtëpie, shpirti, bashkë me valët e Shkumbinit që "përplas jehonën e planetit", vjen Nadirja që i "sjell erën çame si bukuroshe magjishme" dhe "gëzimet misterioze të një atdheu të braktisur".

Në laboratorin krijues të Shefki Karadakut gjen një arsenal veprash krijuese. Nga "Kënga e karrove të drithit" te "TORAKS", ky krijues brilant prodhon emocione të freskëta, me origjinalitet të këndshëm e të besueshëm që gjelbërojnë humanizëm, me mesazhe befasuese, të ndjeshme e me sens dashurie njerëzore.

Karrierës së tij krijuese prej pesë dekadash, i shtohen gjithashtu edhe disa muaj të paharrueshëm që i kaloi në një fshat të humbur të rrethit të Elbasanit, kur jepte mësim në një shkollë fillore.

Studjuesi dhe analisti i zellshëm i veprës së tij letrare, Bardhyl Ajazi, në monografinë : "Elbasan, i bukur Elbasan" (me syrin e poetit Shefki Karadaku), ndër të tjera shkruan: "….Shefki Karadaku i pårkiste një familjeje të mirëfilltë intelektuale. Babai i Shefkiut Xhaferr Karadaku ishte një arsimtar, që pasi mbaroi atë të bekuar Normale gjithë jetën ia kushtoi mësuesisë. Nëna e Shefkiut Adile ishte një grua e kulturuar dhe arsimdashëse. Ajo bëri shumë sakrifica për shkollimin e fëmijëve të saj. Vëllai i Shefkiut, Astriti mbaroi studimet për gazetari dhe punoi për shumë vite në organet kryesore të shtypit. Motra e Shefkiut, Natasha, mbaroi studimet për mësuesi dhe punoi për shumë vite në arsim. Pra, Shefkiu, në detyrën e arsimtarit ishte në fushën e vet, ishte në botën e librave. Janë ato vite kur ndjeu shijet e para të kënaqësisë së heshtur krijuese, nga skicat, tregimet, reportazhet, monografitë historiko-letrare, për të vijuar pastaj për 20 vite në revistën prestigjioze "Ylli", si një nga zërat më të spikatur dhe si mbështetësi real e kurajoz i letrarëve të rinj nga i gjithë vendi.

TË MËDHENJTË E LETRAVE PËR KARADAKUN...

Shefki Karadaku me korpusin e tij letrar, ka hyrë denjësisht në historinë e letërsisë shqipe. Një bilanc më konkret e gjejmë tek libri "Absurdi Mbretëror" – (Shënime kritike, ese, këndvështrime për krijimtarinë e Shefki Karadakut), në të cilin autori i 35 veprave letrare në prozë e në poezi, portretizohet si një nga shkrimtarët e dalluar të kohës së tij. Gjejmë në këtë libër kolosët e letrave shqipe: Dritëro Agolli, Llazar Siliqi, Petro Marko, Adriatik Kallulli, por dhe personalitete të njohura të letrave shqipe, si: Moikom Zeqo, Roland Gjoza, Riza Lahi, Petraq Risto, Agim Cerga, Milianov Kallupi, Dr.Lutfi Turkeshi, Faruk Myrtaj, Sazan Goliku, Halil Rama e Sakip Cami, të cilët vlerësojnë maksimalisht veprën letrare të Shefki Karadakut ndër vite. Në librin "ABSURDI MBRETËROR", botuar në 75-vjetorin e lindjes së shkrimtarit, Bardhyl Ajazi ka përmbledhur artikuj kritikë-Ese. Këndvështrime për krijimtarinë e Shefki Karadakut.

Dhe nëse patriarku i letrave shqipe, Dritëro Agolli vlerëson konceptimin popullor të realitetit në përmbledhjen "Meloditë e Shkumbinit" të Shefki Karadakut, ku evidenton gjuhën e pasur të vargjeve të tij të ngjashme me motivet popullore, si "Vajza e mullixhiut", "Nata e fundit e aksionit" e të tjera……., Kallulli shprehet për pleksjen bukur e me forcë të ngjyrave, e heroikes me tragjiken, të fëlligështisë e dobësisë morale të armiqve të egër. Adriatik Kallulli për një nga poezitë më të njohura shkruan se poezia e Shefki Karadakut është në shumë raste një poezi pikturë, ai e ndien që lexuesit i duhet shprehur në një mënyrë të tillë që të parafytyrojë me kthjelltësi atë që ka parë njëherë poeti. Shembulli tipik për këtë është poezia "Kënga e karrove të drithit", ku gëzimi për korrjen, për bollëkun e grurit shprehet me një kuadër plot lëvizje:

"Kur të fillojë të bredhë nesër dielli,/Në largësinë e fushës, si lejlek,/Atëherë, pas karrove të drithit,/Udhën e kaltër të arave do ndjek….."

Po ashtu, poeti ynë Llazar Siliqi do të shprehej se, "kur më 1967 Shefki Karadaku doli me vëllimin e tij të parë, 'Këngën e karrove të drithit', ne u gëzuem që radhët e poetëve shqiptarë u shtuan me një poet të ri, me një lirik të qetë e të ambël, me ndjenja të holla, me dorë piktori të akuarelit".

Ndërsa shkrimtari i madh Petro Marko, pasi ka lexuar novelën e Shefki Karadakut, të titulluar "Rrugët e para" shprehet: "Sikur ta kishte këtë botim në vargje dhe ta kishte pagëzuar po me këtë emër, ne përnjëherësh do të thoshim: poeti, pasi njeh rrugët e para të jetës, ka zbuluar në to fenomene dhe tinguj, ose ngjyra të reja dhe tani po na i dhuron me dashuri…."

Dr.Lutfi Turkeshi, gazetar&studjues nga Republika e Maqedonisë së Veriut, jo më kot, e vlerëson Shefki Karadakun si "Khajamin e

ditëve tona". Në këtë konkluzion ai arrin pasi ka lexuar romanet "Puthja e ngrirë", "Njëmijë vjet dashuri", "Vila e magjepsur", "Salamandrat", "Filantropi", "Panagjerikus" e të tjerë, dhe vëllimet poetike "Kënga e korrave të drithit", "Melodi të Shkumbinit", "Ylberi". "Lumi me njëqind zemra" e "Feniks" të poetit e shkrimtarit Shefki Karadaku, i cili asnjëherë nuk do t'i nënshtrohej jetës edhe pse e vuante atë…

"Si feniks, shkëlqen me ide kuarci duke ndërtuar "udhë betoni"... I tillë është poeti Shefki Karadaku. Tërë vargjet e poemës 'Feniks' janë të harmonizuara estetikisht në të gjitha nivelet e të shprehurit emocional, individual, stilit origjinal dhe figuracionit. Këto poezi janë shprehje e një personaliteti poetik jo të zakonshëm... Ka poeti edhe idilin e vet të vendlindjes që është "... me çuka, rrape-qiparisa dhe subtropiku mund t'i flasë qershisë, por jo ajsbergë...". Por, ka poeti edhe dashurinë e shprehur si Naimi e Çajupi: 'Të këndoj ty bukuroshe si alku, unë s'jam poet i vjetër melik, po zemra po aq e lashtë sa dheu, përpara teje rreh si det antik...', që pastaj të vijojë: 'Po zemra e kërkon nudon e bukur, le të jetë ajo si mbretëreshë, që nëpër gjoksin e saj malli i shkurtër si tajfun floride të përqeshë...'. Si të përfundojmë?! Shkurt, poezi e veçantë, e jashtëzakonshme, e bukur... Është e tillë poezia e poetit Shefki Karadaku... Është shumë refleksive, sa më shpesh ta lexosh dhe rilexosh, gjithnjë do të nxjerrësh ndonjë ndriçim nga qielli me plot yje lirike të poetit të madh. Pra, kjo lirikë është identiteti poetik si katarzë", -shkruan Dr. Lutfi Turkeshi-Gazetar, studiues ("IDENTITETI SI KATARZË" - Gazeta "Fakti", 8 mars 2001, Shkup).

Petraq Risto si redaktor i romanit "Puthja e ngrirë" vlerëson ndërthurjen plot dritë dhe hije, si një afresk bardh e zi nga autori, të lirizmit, heshtjes, frikës, rebelimit, ankthit, jetës, dashurisë….

Edhe Moikom Zeqo nuk e ka të vështirë për të deklaruar se Shefki Karadaku është një poet nga të spikaturit në lirikën shqiptare.

Shefki Karadaku portretizohet si një nga shkrimtarët e dalluar të kohës.

Karadaku është një nga përfaqësuesit më të spikatur për gjininë e lirikës ku absorbohen përvojat e poetikave tradicionale me ato moderne e avangardiste evropiane dhe realizohet kundërvënia ndaj traditës letrare. Tipare të futurizmit, ekspresionizmit, surrealizmit, madje dhe krepuskolarizmit janë përthithur dhe pasqyruar në poetikat e këtij autori.



KOORPUSI LETRAR I SH.KARADAKUT PËRBËN NJË THESAR TË ÇMUAR...

Teksa lexon veprën e Shefki Karadakut, vetëtimthi të kujtohet krijimtaria letrare mjaft cilësore e këtij poeti dhe prozatori që shkruan prej pesë dekadash, si romanet: "Puthja e ngrirë", "Njëmijë vjet dashuri", "Argonautët", "Vila e magjepsur", "Salamandrat", "Gjergj Elez Alia", si dhe disa novela e vëllime me poezi.

Koorpusi letrar i Sh.Karadakut përbën një thesar të çmuar që rrezaton dritën e artë. Gjetjet metaforike, forca krijuese, gjuha e pasur e shpesh poetike, përdorimi mjeshtëror i fakteve, kronikat, përshkrimi i heronjve, legjendat dhe episodet e bëjnë të këndshme prozën e këtij shkrimtari.

Rrallë gjen në historinë e letërsisë shqipe një autor si Shefki Karadaku, të vlerësuar nga pena të spikatura si: Agim Cerga, Perikli Jorgoni, Milianov Kallupi, Riza Lahi, Jusuf Shahini, Leonard Veizi, Faruk Myrtaj, Mujë Buçpapaj, Ramazan Vozga, Namik Selmani, Sazan Goliku, Sakip Cami, Neritan Dragoti, Ahmet Banushi, Ermir Hoxha, Kostandin Dhamo, Tomor Jolldashi, Mihal Disho etj.

Krijimtaria e Shefki Karadakut është botuar edhe në gjuhë të tjera europiane. Revista letrare gjermane "Literatura Nr. 11 ndërmjet 20 autorëve nga Gjermania dhe vendet e tjera të Europës dhe Ballkanit boton edhe fragmente nga krijimtaria e shkrimtarit shqiptar Shefki Karadaku. Revista është botuar nga shoqëria letrare "Marburg" e Universitetit të Marburgut. Kopjet e saj ruhen në bibliotekën gjermane sipas ISSN.

Para pak kohësh, me kontributin e familjes u botua në anglisht romani i Shefki Karadakut "PUTHJA E NGRIRE", nga një kopje e të cilit ju dhurua selive te huaja diplomatike në Tiranë. Dhe menjëherë vjen vlerësimi i ambasadorit gjerman Peter ZINGRAF për këtë roman tejet të arrirë që me të drejtë është mirëpritur e vlerësuar në botën letrare të kryeqytetit.

Nuk është rastësi që poeti e prozatori Shefki Karadaku mirërpritej e botohej kudo në trevat shqipfolëse, si në Prishtinë, Dibër të Madhe, Ulqin, Strugë etj. Madje në vitet '73-74 gazeta prestigjioze "RILINDJA" e Prishtinës botoi në 6 numra radhazi novelën e tij "Kur kërcasin boçet e pishave"

Trashëgimia letare që na la Shefki Karadaku me 13 vëllime me poezi dhe 12 romane e 10 libra me tregime e novela, që të gjithë me subjekt të zgjedhur e të arrirë nuk është pak. Ato janë një kontribut i çmuar për të sotmen dhe për të nesërmen që të mos ketë "Puthje të ngrirë", që fjala e lirë të rrjedhë si "Ujëvarë", që "Gjergj Elez Alia" t'u transmetohet brezave si njeri trim dhe i besës, si njeri i zgjuar dhe i ditur, që respekton njerëzit e tij, por edhe vizitorët e huaj të rajonit e të botës, që "Shkumbini" të mos shkatërrojë tokat, por të përmirësojë ekologjinë tonë, që "Elbasani i bukur" të çlirohet nga ndotja dhe të shndërrohet në turizmin tradicional shekullor. Ky është mesazhi që përcjell vepra e Shefki Karadakut.

Ndaj, shkrimtarë të tillë si Ai, që kanë sjellë risi në letërsinë tonë, meritojnë vëmendje nga kritika letrare dhe, në mungesë të Lidhjes së Shkrimtarëve, nga Ministria e Kulturës e nga Presidenti i Republikës. Personalitete si Ai, meritojnë vëmendje, sepse janë truri i kombit.

N'asnjë libër poetik, të cilët ai i krijoi dhe i botoi njeri pas tjetrit, dhe sidomos tek më i fundit me titullin sinjifikativ "TORAKS", nuk mungon Elbasani; Karadaku është ajo kumria që s'e tradhtoi kurrë…Madje siç shkruan Kostandin Dhame:

Ky libër, këtë herë, përveç teksit poetik, ngërthen midis faqesh edhe disa fotografi dhe vizatime, të hedhura gjithë fantazi fine nga vetë Shefki Karadaku. Këto vizatime së bashku me fotografitë, shpërfaqin jetën e tij midis shtëpisë së lindjes, brigjeve të Shkumbinit, tek kundron kumrien n'ajër, Bezistanin gumëzhitës, Kalanë, Sahatin, shelgun e pikëlluar që shkrehet mbi ujëra, dritaret pas pemëve të redaksisë së Revistës Ylli, Rrugën e Elbasani, e çnuk tjetër…

Shefki Karadaku, nga Elbasani i kumries, kësaj embleme n'ajër, nga Elbasani i Kalasë me çezmat te porta që rrjedhin e rrjedhin si mikpritja, dhe shtëpitë përbrenda me lule dhe vajza të bukura, nga Elbasani i Ditës së Verës, i Ballokumeve të ëmbla, i Shkumbinit shkumëzues, përgjatë brigjeve të të cilit stinët ndërrohen si dekore; nga Elbasani i Kristoforidhit, Isuf Myzyrit, Dhaskal Todrit, Vëllezërve Shpataraku, Bezistanit, Rrapit të Vojvodës, me poezinë dhe prozën e tij me vlera kombëtare, i dhuroi këtij qyteti një identitet të ri, Elbasani i Shefki Karadakut. Bashkëshortja e tij, Nadirja pohon se

"Shefkiu nuk e programonte kohën kur shkruante. Shkruante në shtëpi, në parqe e lulishte, kudo ku gjelbëronte muza e tij….. Kishte ditë që ulej para tavolinës dhe shkruante për 10 orë rresht. Shpesh çohej edhe nga gjumi dhe shkruante për disa orë edhe natën… Nuk kishte regjim të caktuar, por pas viteve ''90 ai shkroi me shumë temp dhe botoi shumë libra, ndërkohë qå la në dorëshkrim disa vepra tjera letrare".

Një vit më parë, më 16 mars 2021, familja Karadaku humbi njeriun e saj të dashur dhe që e bënte të ndjehej krenare. Ndërsa letërsia dhe kultura kombëtare humbën një nga autorët e saj më të shquar, kur mund t'i jepte akoma vepra të tjera, edhe më cilësore artistikisht dhe më të pasura emocionalsht. Shefkiu u shua vetëm fiziksht. Emri, veprat e shumta e me nivel të padiskutueshëm artistik, i kanë dhënë me kohë të drejtën e denjë të pavdekësisë dhe të prehjes në Parajsë! Ndaj dhe do të përkujtohet në 1-vjetorine vdekjes (16 mars 2022) dhe 81-vjetorin e lindjes, me një Akademi Përkujtimore në Akademinë e Shkencave, jeta dhe veopra letrare e të cilit do të përcillet edhe në një film dokumentar.

Reagim i 17 subjekteve kulturore

Ministria e Kulturës në Maqedoninë e Veriut, diskriminon kulturën shqiptare

"Shpallja e rezultateve, nga përzgjedhja e projekteve konkuruese, për Programin e kulturës për vitin 2022, që finansohen nga Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë së Veriut, vazhdon të bëhet një GODITJE e madhe për kulturën shqiptare"!

Edhe këtë vit, sikurse shumë vite radhazi, kultura shqiptare diskriminohet rrënjësisht dhe fondet buxhetore që u përkasin shqiptarëve, kryesisht shkojnë për projektet e maqedonasve, të cilët gjithandej favorizohen dhe mbështeten nga Ministria e Kulturës.

Ky diskriminim i hapur, edhe në konkursin e vitit 2021, i detyroi 17 Shoqata Kulturore, Lidhje, Shtëpi Botuese, Shtypshkronja dhe subjekte tjera kulturore nga Tetova, të reagojnë në forma të ndryshme, si dhe duke nënshkruar një MEMORANDUM bashkëpunimi, jo vetëm për të bashkëvepruar në mbijetesën kulturore, por edhe me qëllimin e shfaqjes së pakënaqësisë dhe revoltës, ndaj nënvlerësimit dhe diskriminimit të pushtetmbajtësit absolut, të korruptuar deri në palcë.

Golgota vazhdon!

Edhe këtë vit, në konkursin për Programin e kulturës për vitin 2022, Ne, si përfaqësues të Organizatave, Lidhjeve, Shtëpive Botuese dhe Shoqatave Kulturore – Letrare, të regjistruara në mënyrë të rregullt për ushtrimin e veprimtarive të botimit të librave dhe aktiviteteve kulturoro – letrare, të cilat kanë të bëjnë me promovimin, ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, reagojmë bashkërisht në mbrojtje të fjalës së shkruar shqipe, traditës dhe kulturës sonë shekullore.

Ministria e Kulturës, me fonde të ulëta dhe qesharake deri në banalitet, i mbështet vetëm disa shoqata shqiptare dhe individë, të cilët për interesa personale kanë bashkëpunuar me persona si Lulzim Haziri dhe Ahmet Selmani, vasalë të Ministrisë së Kulturës, partive politike ose pushtetmbajtësve, që në mënyrë flagrante "i shkelin" të drejtat e shqiptarëve pa pushtet, pra me dhjetëra udhëheqës të shoqatave dhe shtëpive botuese, megjithëse këta udhëheqës, janë njerëz të veshur në petkun e dijes, punës dhe vlerave.

Në këtë diskriminim shumëvjeçar, pothuajse nuk kanë më vlerë pyetjet thelbësore: deri kur do të lejohet që Ministria e Kulturës t'i diskriminojë shqiptarët?

Deri kur, partitë shqiptare në pushtet do ta përfaqësojnë vetëm partinë, interesin e individëve dhe të lidhjeve miqësore, dhe jo vlerat e vërteta kulturore?

Deri kur, do ta durojmë fyerjen dhe mposhtjen edhe në instancat e institucionit të kulturës?

Deri kur do të heshtim, pa kërkuar llogari për atë që na takon përmes taksave tona?

Deri kur, do ta bartim dëshpërimin e diskriminimit të përhershëm, ndaj ATYRE që nuk japin kurrë llogari për zhbërjen e identitetit tonë kombëtar, sepse ata, fatkeqësisht nuk janë të vetëdijshëm se kultura nuk është kërkim lëmoshe, as interes vetanak, as "kult" i suksesit të individit të shpërfytyruar si puthadorë e servil…?!

Kjo ministri, e ndihmuar nga argatët e vet: Lulzim Haziri dhe Ahmet Selmani, e godet kulturën shqiptare, duke e ndërprerë mbështetjen finansiare të manifestimeve kulturore me përmasa mbarëkombëtare. Po, duhet theksuar – Mbarëkombëtare, ku promovohen vlera të përbashkëta kombëtare të traditës dhe fjalës shqipe! Duke e ndërprerë gjithashtu edhe finansimin e botimit të të gjitha revistave në Gjuhën shqipe! Nacionalizmit të vazhdueshëm të kësaj ministrie, me përunjësi i shërbejnë argatët e saj të devotshëm, duke i llogaritur shqiptarët intelektualë – udhëheqës të shoqatave e shtëpive botuese, si analfabetë që nuk dinë të plotësojnë dokumente (ndërkohë që dokumentet fshihen në vetë institucionin ku dërgohen), apo të paaftë për të prezantuar kulturë letrare e artistike, e gjithfarë broçkullash tjera?!

Vetëm se, realisht, ata vasalë kurrë nuk patën ndërgjegje ta pranojnë të vërtetën e paaftësisë së tyre për të vlerësuar drejt, pa baza interesi, ose për të kërkuar me këmbëngulje në ndarjen adekuate të buxhetit për kulturë që u përket shqiptarëve. Edhe mirë bëjnë! Sepse, të tillët, janë të orientuar vetëm për ta realizuar diktatin me porosi për ta nënvlerësuar kulturën shqiptare, për ta shkatërruar arsimin, ekonominë…, e skenari vazhdon me ikjen masovike të të rinjve për në botën e jashtme, sepse kur nëpërkëmben e goditen kaq brutalisht intelektualët dhe njerëzit e kulturës, paramendoni se si mund të ndihet qytetari i rëndomtë, të drejtat e të cilit privohen përditë!

Me këtë diskriminim institucional të kulturës shqiptare, në këtë vend, të merr malli të bësh kulturë, sepse lajmin kyç e zë: vjedhja, korrupsioni, hapja e bastoreve, dënimet e inskenuara, e gjithçka tjetër që "suksesshëm" kontribuon në përzënien jashtë vendit të ajkës së inteligjencës shqiptare.

Kjo pra, është fytyra e vërtetë e institucionit të kulturës në RMV!

Pyesim pa ironi: çka iu nda kulturës shqiptare këtë vit…, apo preteksti ishte që ta zhbëjnë Manifestimin Mbarëkombëtar "Dita e plisit të bardhë", Manifestimin Mbarëkombëtar Letrar – Poetik "Flakadani i Kujtesës", Aktivitetin kulturor "Karvani i librit" – një projekt kulturor me traditë 17 vjeçare, mosmbështetjen e Panairit të librit (si një mundësi e vetme ku mund të sigurohet libri (ndërkohë që qytetet, veçmas në Tetovë, ku në vend të librarive, brenda natës si kërpudha mbijnë bastoret). Sigurisht, përpos këtyre që theksuam, janë dëmtuar edhe disa manifestime tjera me përmasa mbarëkombëtare, që përditë e më shumë zëvendësohen me "festivale" lokale të ashtuquajtura "ballkanike" (ku nuk merr pjesë asnjë poet ballkanas), të ashtuquajtura "ilire", ku fatkeqësisht shkojnë e prezantojnë poete serbe, kuptohet në serbisht (e shqiptari i gjorë e merr rolin e përkthyesit), e sa e sa të tjera të këtij lloji, me tendenca multikulturore, sepse vetëdije multikulturore ka pikërisht edhe vasali kryesor i këtij komisioni përzgjedhës, Lulzim Haziri. Po do të thoni, nuk ka asgjë të keqe të kesh vetëdije multikulturore! Sigurisht se po, por jo për interesa të ulëta vetanake e miqësore, në kurriz të kulturës shqiptare! E sa për vlerat e tij personale, më mirë t'ia lëmë kohës, sepse koha është gjykuesi më i mirë!

Ne, udhëheqësit e Shoqatave dhe Shtëpive Botuese, konstatojmë se anashkalimi dhe përçmimi i projekteve për kulturën shqiptare, aq sa përkon me vendimin e ndarjes së ulët buxhetore të institucionit të kulturës, po aq përkon edhe me mungesën e "ndërgjegjes" së anëtarëve shqiptarë të Komisionit, të cilët nuk e përfillin pakënaqësinë dhe reagimin e vazhdueshëm të dhjetëra subjekteve kulturore, duke mos e trajtuar kurrë në mënyrë serioze këtë qëndrim të Ministrisë së Kulturës ndaj shqiptarëve, por e zgjedhin rrugën më të shkurtër, atë të nënvlerësimit dhe të papërgjegjësisë.

Me këtë reagim, Ne, përfaqësues të Organizatave, Lidhjeve, Shtëpive Botuese dhe Shoqatave Kulturore – Letrare, e shprehim revoltën tonë, për t'i thënë NDAL diskriminimit të kulturës shqiptare në RMV!

Këshilli i Organizatave, Lidhjeve, Shtëpive Botuese dhe Shoqatave Kulturore – Letrare i fton të gjitha Shoqatat, nga e tërë Maqedonia e Veriut, në mbështetje të këtij REAGIMI, kundër diskriminimit të kulturës shqiptare!

Lidhja e Botuesve Shqiptarë në Maqedoninë e Veriut

Shoqata për Shkencë dhe Kulturë "Pellazgët"

Shtëpia Botuese "Luma grafik" – Tetovë

Shoqata për Kulturë dhe Shkencë "Ars Albanica" – Tetovë

Shtëpia Botuese "ArbëriaDesign" – Tetovë

Shoqata për Arsim dhe Edukim të të Rinjëve "Support"

Shoqata për Kulturë "Rapsodia e Sharrit"

Shtëpia Botuese "Çabej" – Tetovë

Shtëpia Botuese "Enea Print"

Shtëpia Botuese "Voka 4"

Shoqata për Shkencë Kulturë dhe Sport "Gondor" – Tetovë

Shtëpia Botuese "Litera Group"

Shtëpia Botuese "Ajan" – Tetovë

Shtëpia Botuese "Feniks" bb trade – Kërçovë

Tetovë, 23.II.2022

Shefki Kadri Selami Enver Beqiri Dashmir Jusuf Ademi Xhemil Selimi Afet Iljazi Sami Beqiri

Agron Islami

Arsimi ynë, sfida dhe realitete

Shkruar nga Fran Gjoka

Drejtimi i arsimit dhe i shkollës në veçanti, përbën sot një ndër prioritetet e MAS dhe është në qendër të reformimit dhe strukturimit të vazhdueshëm. Gjithkush në arsim, por edhe komuniteti arsimdashës e pridëror, e ndjen dhe e kupton domosdoshmërinë e ndryshimeve dhe reformimeve në shërbim të arsimit, që do të thotë në shërbim të arsimit të brezit të ri, të të sotmes dhe të së ardhmes së vendit tonë, për t'u futur sa më natyrshëm në rrjedhat e zhviliimit evropian dhe për ta bërë Shqipërinë në të gjithë fushat si Evropa.

Drejtimi shkollës është parësor, jo vetëm për rëndësinë dhe peshën që ka një drejtues, por sepse nga mënyra e drejtimit dhe menazhimit të punëve drejtuese të shkollës, kushtëzohen dhe çlirimi i energjive pozitive, i kapaciteteve të mendjes dhe të eksperiencave, të mësuesve tanë të përkushtuar ndaj arsimit. Rrjedhat zhvillimeve njohja e Evropës dhe e praktikave që ato përdorin në drejtimin e shkollës, janë sigurisht një mësim i madh për ne, por të zbatuara, ato në kushiet konkrete të shkollave tona, natyrisht që kërkojnë vëmendjen e duhur, kujdes dhe preokupacion të veçantë.

kërkon vetë zhvillimit arsimor i vendit dhe I shoqërisë sonë, ashtu dhe kërkesave dhe detyrave, që ndjejmë brenda vetes për t'u bërë plotësisht dhe pa asnjë mangësi, pjesë e zhvillimeve dhe kërkesave të reja bashkëkohore, që fi përgjigjemi në çdo hap ndryshimeve reformuese e strukturuese, por edhe të hyjmë me dinjitet të lartë në Evropë, ashtu si edhe e meritojmë. Të bëjmë që punët të na ecin sa më mbarë, duke praktikuar dhe aplikuar format dhe metodat më të mira dhe më të avancuara shkencore. E dimë se nxënësi shikon mësuesin në sy dhe ai e dëgjon dhe e respekton fjalën e tij, por në klasa më të larta, shpesh herë ndodh që, nxënësi e vë përpara provave dhe vështirësive mësuesin, prandaj, ai, në radhë të parë auhet ta ngrejë vetveten në lartësinë e detyrës së tij, profesionalisht dhe shkencërisht. Natyrisht, që po aq, në mos më shumë, kjo është një kërkesë për drejtuesit e shkollave dhe të arsimit në rang rrethi e qarku. Në krye të shkollës, të jetë një drejtues, që në radhë të parë të jetë mësuesi më I mirë, por, ai, të ketë edhe disa cilësi vetjake, origjinale, drejtuese dhe menazhuese, të cilat nuk lindin vetvetiu, por kërkojnë studim, dije, vëmendje dhe kulturim të vazhdueshëm. Mbase, do të ishte i udhës aplikimi i idesë së përgatitjes së drejtuesve në shkolla apo kurse të veçanta, që ata të marrin njohuri nga bota dhe të jenë në gjendje t"i aplikojnë ato në praktikë. Ndërkohë, kjo bënë që të zbulohen më të mirët, si mësues e drejtues, ata që janë në gjendje t u përgjigjen suksesshëm sfidave të kohës dhe të zhvillimit. Kualifikimet e vazhdueshme, që ne organizojmë si drejtori Qarku apo rrethi, me drejtues e mësues, na bindin për domosdoshmërinë e aftësimit e kualifikimit të mëtejshëm të drejtimit dhe menazhimit të shkollës. Kështu, ne mendojmë për fëmijët, që janë jo vetëm e ardhmja, por në radhë të pare, ata janë e sotmja. E sotmja, kur ne duhet të punojmë çdo orë, çdo ditë e javë me ta, duke zbatuar ato forma dhe metoda frytdhënëse, që japin rezultatet më të mira.

Duke ndihmuar shkollën, ndihmojmë të sotmen dhe të ardhmen e vendit. Vitet ikin si pa u ndjerë, brezat ua lënë radhën njëri-tjetrit, por të gjithë njerëzit, që nga ai qytetari i thjeshtë e gjer tek shkencëtari, krijuesi, artisti, politikani, burrat e shtetit, ministra, kryeministra dhe presidentë, të gjithë, kanë qenë dikur në bankat e shkollës, kanë pasur mësuesit dhe drejtuesit, që me siguri i kujtojnë dhe i përmendin shpesh në biseda. Por, edhe kur nuk i përmendin, ata nuk mund të shkëputen nga dituritë dhe mësimet që kanë fituar nga shkolla e tyre. Ato janë shkrirë brenda qenies së gjithsecilit dhe janë bërë pjesë e identitetit, e stilit dhe personalitetit. Fjala që dëgjon shpesh se mësuesi konsiderohet si "prind i dytë", ka pikërisht këtë domethënie të madhe. Nëse mëma e iind, e ushqen fëmijën me qumësht dhe ushqim të përditshëm që ai të rritet i shëndetshëm, mësuesi e "ushqen" me dije e kulturë, që ai të bëhet i ditur dhe i mençur, që të njohë botën ku jeton, f i japë kuptim jetës, të mos vegjetojë dhe të mos kalojë pa lënë gjurmë e pa u ndjerë. Eshtë e njohur sentenca se, megjithëse bota shkon përpara, fëmijët dhe të rinjtë ia nisin nga fillimi. Dhe, për këtë jemi ne, që, me sa mundim, f u ndriçojmë atyre rrugët e dijeve dhe të jetës, t'i ndihmojmë, që të ecin me hapin dhe ritmin e kohës.

Në përfundim duhet theksuar se shkollat tona të larta të mësuesisë duhet t'i nënshtrohen një reforme të thellë me qëllim qe të përgatisin njerëz të aftë që të përballojnë me sukses problemet e sotme të mësimit dhe të edukimit qe të përgatisin njerëz të aftë për të përballuar vështirësitë qe nxjerr koha.Parë në këtë këndveshtrim, edhe MAS duhet të forcojë punën menaxhuese dhe kontrolluese në këto institucione për t'u dalë përpara detyrave që shtron koha.Çdo neglizhencë në këtë drejtim,-mund të paguhet me kosto të lartë në të ardhmen.

NË RRETHIM

– Poemë nga MAHMOUD DARWISH

Përktheu SKËNDER BUÇPAPAJ

Këtu në shpatet e kodrave, përballë pluhurit dhe artilerisë së kohës
Pranë kopshteve të hijeve të shqyera,
Çfarë bëjnë të burgosurit,
Dhe çfarë bëjnë të papunët:
Ne kultivojmë shpresë.
***
Një vend duke u bërë gati për agimin. Ne bëhemi më pak inteligjentë
Sepse e shikojmë nga pranë orën e fitores:
S'ka natë në natën tonë të mos ndriçohet nga bombardimet
Armiqtë tanë janë vigjilentë dhe bëjnë dritë për ne
Në terrin e qelive.
***
Këtu nuk ka "unë".
Këtu Adami kujton pluhurin e baltës nga doli.
***
Në prag të vdekjes, ai thotë:
Unë nuk kam asgjë çfarë të humb:
Jam i lirë kaq pranë lirisë sime. E ardhmja ime është në duart e mia.
Së shpejti do ta kapërcej jetën time,
Do të lind i lirë dhe pa prindër,
Dhe emrit tim do t'i zgjedh shkronja të kaltra…
***
Ju që rrini prapa derës sonë, hyni brenda,
Pini kafe arabe me ne
Dhe do ta kuptoni se jeni njerëz si ne
Ju që rrini prapa dyerve të shtëpive tona
Ejani tek ne herët mëngjeseve
Ne do të ndihemi më të sigurtë se jemi
Njerëz si ju!
***
Kur avionët zhduken, pëllumba të bardhë, të bardhë
Fluturojnë dhe lajnë faqet e qiellit
Me krahët e lirë duke marrë rrezatim sërish, duke marrë
Në zotërim eterin dhe lojën. Më lart, edhe më lart, pëllumba të bardhë
Fluturoni. Ah, nëse vetëm qielli
Ishte real [një burrë duke kaluar mes dy bombave ma tha mua].
***
Selvitë prapa ushtarëve, minaret duke mbrojtur
Qiellin së rrëzuari. Prapa gardhit të hekurt
Ushtarët pshurrin¬-nën syrin vigjilent të një tanku-
Dhe dita vjeshtore mbaron verdalljen e saj të artë në
Një rrugë të gjerë sa një pishë pas meshës së të Dielës…
***
[Një vrasësi] Nëse ti e ke kundruar fytyrën e viktimës
Dhe e ke çuar atë në mendje, atëherë do të kishe kujtuar nënën tënde në
Dhomën e gazit, do të kishe qenë çliruar nga arsyeja e automatikut
Dhe do të kishe ndërruar mendje: kjo nuk është mënyra
për të gjetur identitetin e dikujt.
***
Rethimi është një periudhë në pritje
Duke pritur në shkallën e anuar në mes të stuhisë.
***
Vetëm, ne jemi vetëm aq poshtë sa llumi
Ishte kur nuk pret për vizitat e ylberëve.
***
Ne kemi vëllezër prapa kësaj hapësire.
Vëllezër të hatashëm. Ata na duan ne. Ata na shikojnë dhe luten.
Pastaj, fshehtas, i tregojnë njëri tjetrit:
"Ah! nëse ky rrethim do të ishte deklaruar…"
Ata nuk e mbarojnë këtë fjali:
"Mos na braktisni ne, mos na lini ne."
***
Humbjet tona: nga dy deri tetë martirë çdo ditë.
Dhe dhjetë të plagosur.
Dhe njëzet shtëpi.
Dhe pesëdhjetë pemë ullinjsh…
Shtoja kësaj rrëkenë strukturore që
Do të arrijë në poemë, lojën dhe telajon e mbaruar.
***
Një grua i tha resë: mbuloje të dashurin tim
Sepse veshja ime është qullur me gjakun e tij.
***
Nëse nuk je shi, i dashuri im
Ji pemë
Nginjur me pjellori, ji pemë
Nëse nuk je pemë, i dashuri im
Ji gur
Nginjur me lagështi, ji gur
Nëse nuk je gur, i dashuri im
Ji hënë
Në ëndërrën e gruas së dashur, ji hënë
[Kështu i tha një grua
djalit të saj në funeralin e tij]
***
O roja! A nuk jeni të shqetësuar
Së prituri shtrirë dritën në kripën tonë
Dhe për inkadeshencën e trëndafilit në plagën tonë
A nuk jeni të shqetësuar, o roja?
***
Pakëz nga kjo pafundësi absolute dhe blue
Do të ishte mjaft
Për ta ndriçuar barrën e këtyre kohe
Dhe për të dlirur batakun e këtij vendi.
***
Është koha që shpirti të zbresë nga mali i tij
Dhe me këmbët e tij të mëndafshta të ecë
Përkrah meje, dorë për dorë, si dy miq
Të vjetër që ndajnë bukën e moçme
Dhe gotën e moçme të verës
E bëfshim këtë rrugë së bashku
Dhe pastaj ditë tona do të marrin drejtime të ndryshme:
Unë, përtej natyrës, çka në shkëmbim
Do të zgjedhë të ulet këmbëkryq mbi shkëmbin e lartë.
***
Në gurin tim hija bëhet e gjelbër,
Dhe ujku po fle në lëkurën e dhisë sime
Ai ëndërron si dhe unë, si ëndërrojnë engjëjt

Se jeta është këtu… jo tjetërkund.
***
Në gjendje rrethimi, koha bëhet hapësirë
E ngurosur në perjetësinë e saj
Në gjendje rrethimi, hapësira bëhet kohë
Që i ka humbur të djeshmet dhe të nesërmet e saj.
***
Martiri më qarkon mua çdo kohë që jetoj një ditë të re
Dhe më pyeti mua: Kush je ti? Ktheje çdo fjalë
Që ma dhanë mua në fjalorët
Dhe qetësoi gjumashët nga zukama e jehonës.
***
Martiri më kthjelli mua: përtej hapësirës
Unë nuk vështrova
Për virgjinët e pavdekësisë dhe për dashurinë e jetës
Mbi tokë, mes fiqve dhe pishave,
Por unë nuk e arrita atë, dhe pastaj, gjithashtu u nisa drej saj
Me të fundit që më kish mbetur: gjakun në trupin e qiellit të kaltër.
***
Martiri më paralajmëroi: Mos iu beso qarjeve të tyre
Besoje babain tim kur, duke dënesur, pa fotografinë time
Si i ndërruam rolet, biri im, si ti më paraprive mua.
I pari unë, unë i pari!
***
Martiri më qarkon mua: vendi im dhe mobilja ime e pagdhendur
janë gjithë ç'kam ndryshuar.
Unë vë një gazele në shtratin tim,
Dhe një gjysmëhënë në gishtin tim
Për të ngushëlluar keqardhjen time.
***
Rrethimi do zgjasë në mënyrë që të na bindë ne të zgjedhim
një robërim që nuk lëndon, në liri të plotë!
***
Të rezistosh do të thotë të sigurosh vetes për shëndetin e zemrës,
Shëndetin e boleve dhe lëngatën tënde kryeneçe:
Lëngatën e shpresës.
***
Dhe në çka mbetet deri në agim, unë bëj të dal jashtë vetes
Dhe në çka mbetet prej natës, unë ndiej zhurmën e hapave brenda meje.
***
Përshëndetjet e mia kujt ndan me mua vëmendjen ndaj
Dehjes së dritës, dritës së fluturës, në
Terrin e këtij tuneli!
***
Përshëndetjet e mia kujt ndan gotëm time me mua
Në dendësinë e një nate që i rrethon dy hapësirat:
Përshëndetje pamjes sime.
***
Miqtë e mi gjithnjë po përgatisin një festë lamtumire për mua,
Një varr mirëpritës në hijen e lisave
Një epitaf në mermerin e kohës
Dhe gjithmonë unë i paraprij ata në funeral:
Atëherë kush vdiq… kush?
***
Të shkruarit është një rrahje që nuk lë shenjë
Të shkruarit plagos pa gjurmë gjaku.
***
Filxhanat tanë të kafesë. Zogjtë ne pemët e gjelbra
Në hije blu, dielli kërcen nga një mur
Në tjetrin si një kaproll
Uji në retë ka një formë të papërkufizuar të asaj që na ka mbetur ne
Nga qielli. Dhe gjërat e tjera të kujtesave të mbetura pezull
Nxjerrin në pah se ky mëngjes është i tejfuqishëm dhe i ndritshëm,
Dhe se ne jemi mysafirë të përjetësisë.

KOHA PËR TË ZGJEDHUR NJË SHQIPTARO-AMERIKAN NË KONGRES: VEDAT GASHI MUND TA BËJË

Nga Harry Bajraktari

Djali i emigrantëve shqiptarë po kandidon në zonën që dikur përfaqësohej nga kongresisti Engel – fitorja e tij do të kishte një vlerë të madhe simbolike.

Njoftimi nga Vedat Gashi se po kandidon për Kongresin Amerikan është një lajm i bukur për komunitetin tonë.

Gjithmonë kemi dashur të shohim një brez të ri shqiptaro-amerikanësh që kandidon në politikë dhe përfaqëson zonat ku jeton komuniteti ynë.

Vedati sjell me vete një histori të bukur të djalit të emigrantëve që rritet dhe bëhet një udhëheqës duke realizuar versionin e tij të Ëndrrës Amerikane.

Historia e tij ka rëndësi sidomos për komunitetin tonë. Shumë nga ne mërguam nga trojet shqiptare, të shtyrë nga shtypja dhe vuajtjet. Në këtë vend gjetëm një atdhe të dytë. Gjetëm liri dhe demokraci. Amerika na frymëzoi që të punonim shumë, të bëheshim qytetarë të mirë dhe patriotë. Na frymëzoi që suksesin e arritur ta shfrytëzonim për të ndihmuar atdheun e të parëve. Vedati i ka bërë të gjitha këto. Kur mbaroi studimet, ai u kthye për të ndihmuar Kosovën e pasluftës që të ndërtojë institucionet e demokracisë së re dhe reformën e drejtësisë.

Në SHBA, ai ngriti biznesin e tij ligjor dhe kandidoi dy herë me sukses në politikë. Ka bërë punë shumë të mirë duke u shquar në Bordin e Ligjvënësve të Uestçesterit (Westchester). Ai ka shumë potencial dhe do të bëhet një përfaqësues shumë i mirë në Kongresin Amerikan të distriktin e 16 të sapondryshuar, që tani përfshin edhe qytetin e Vedatit, Jorktaunin (Yorktown).

Kam pasur kënaqësinë ta njoh personalisht Vedatin. E mbaj mend qysh fëmijë dhe e kam parë të rritet e të bëhet një avokat i zoti, veprimtar i komunitetit dhe përfaqësus i zgjedhur. Kam besim se do të na nderojë edhe në Kongresin Amerikan.

Ka vlerë të madhe simbolike, që po kandidon në distriktin që dikur përfaqësohej nga miku im i mirë, Eliot Engel për 32 vjet me radhë.

Engel hyri në histori duke shërbyer si Kryetar i Komitetit të Punëve të Jashtme në Dhomën e Kongresit. Ai themeloi dhe bashkëdrejtoi Kaukusin e Çështjeve Shqiptare në Kongresin Amerikan. Engel e ka mbështetur me pasion çështjen e Kosovës por ka ndihmuar shqiptarët kudo që jetojnë në luftën e tyre për liri dhe demokraci. Kam punuar me të për më shumë se tre dekada dhe jam krenar për atë bashkëpunim.

Vedat Gashi do të vazhdojë në rrugën e Eliot Engelit me të njëjtën vendosmëri dhe krenari.

Ai është një kandidat shumë i mirë jo vetëm për shqiptarët, por për të gjithë njerëzit e distriktit të tij. Është bir i Jorktaunit dhe Uestçesterit, një njujorkez i vërtet dhe amerikan krenar. Ai është një demokrat që tërheq njerëzit e të gjitha shtresave dhe që do të shërbejë me ndershmëri dhe dinjitet.

I bëj thirrje të gjithëve që t'i japim të gjithë ndihmën dhe mbështetjen që ka nevojë në këtë betejë historike.

Harry Bajraktari është themeluesi dhe ish-botues i gazetës "Illyria" (1991-1998). Ai është një veprimtar, biznesmen dhe filantropist shqiptaro-amerikan, i nderuar me shumë çmime mes tyre edhe Nderi i Kombit nga Presidenti i Shqipërisë, Medalja Presidenciale e Kosovës për Merita si dhe Dekorata e Thirrjes Presidenciale për Shërbim nga Shtëpia e Bardhë në SHBA.

SHOKET E MI TË BUKURIVE ALPINE

Nga Vangjel Simaku*

Ata ishin te tre nga Veriu i Shqiperise.Fadil Shaqiri nga Morina e Kukesit, Bardhok Rama nga Gjegjani i Pukes , Mujo Bucpapaj nga Tplani i Tropojes. Ishin te tre djem shume te mire, njeri me i mire se tjetri. Une isha i katerti mes tyre, nga juglindja e Shqiperise. Vija nga nje qytet kulture si Korca , por ata edhe mua me quanin malesor si vetja . Dhe kjo per faktin se edhe Korca ime shtrihet ne nje fushegrope , 850m mbi nivelin e detit dhe rrethohet nga nje kurore malesh. Pra ishim kater malesore .Edhe malet e mia jane te bukura , por jo sa te tyret. Ata ishin bij te bjeshkeve , ku mpreh sqepin shqiponja .Per kete ndjeheshin krenare .

Fadili qe me i madhi nga ne ne moshe .Bile qysh kur erdhi ne fakultet ne vit te pare ishte baba me femije . Ai fliste pak , por fjala i zinte vend . Ajo ishte e rende si shkemb. Sot me Fadilin jemi miq ne facebook dhe shkembejme shpesh mesazhe .Ai eshte drejtor shkolle ne vendlindjen e vet , shume i pasionuar pas punes . Por edhe pas natyres se bjeshkeve te tij .I viziton shpesh me miq e shoke . Kemi kohe pa u pare . Mbase Zoti na e ben mbare nje dite .

Bardhoku ishte nje djale katolik nga Gjegjani i Pukes.Ishte i qete edhe ai , ndonese ndonjehere edhe debatonim gjate per probleme te ndryshme . Pas fakultetit punoi si mesues ne fshatin e tij .Pata rastin te shkoj nje here te ky fshat buze lumit Fan ,ne kohen kur punoja edhe une ne Veri.Ishte shume bukur dhe njerezit qene shume mikprites. Sot me Bardhokun i kemi humbur lidhjet. Me aq sa di une ai ndodhet ne Itali si emigrant .Kam shume deshire te takohemi serish .

Mujo Bucpapaj ishte nje djale nga Tplani i Tropojes. Ai ishte poet, me sakte pjese e nje familje poetesh .Shkruante ai vete , i vellai , Skenderi , kushurinjte e tij , Halili, Flamuri. Halili ka qene gazetar i njohur , kurse Skenderi i famshem si poet, kritik, redaktor i gazetes Drita edhe Drejtor i Pergjithshem i RTSH-se.

Muji shkruante poezi ne flete te bardha formati , qe ishte veshtire t'i gjeje ne ate kohe. Krijimet e tij ishin frymezime te castit, pa sforcime . I botonte kryesisht tek " Zeri i Rinise" dhe "Nentori." E shihja shpesh qe ngrihej rrembyeshem , merrte stilografin dhe shkruante mbi fletet e bardha. Pa arritur une ta pyesja se c'bente ai me zgjaste poezine e re te sapokrijuar. Ato ishin te shkurtera, por domethenese . Ne te shumten e heres simbolike, metaforike.

Me Mujon jam takuar shpesh ne Tirane, ku ai ka patur nje jete shume aktive, pas zhvillimeve demokratike ne vendin tone, ku ai u pwrfshi nw levizjen demokratike antikomuniste duke qene nje personazh i njohur i saj. Ai ishte bashkethemelues i gazetes RD dhe themelues dhe kryeredaktor i Tribunes Demokratike. Ka botuar shume libra me poezi ne Shqiperi dhe jashte shtetit. Ka fituar shume cmime ne vend dhe ne nivel nderkombetar, duke qene nje nder perfaqesuesit me te suksesshem te poezise bashkekohore shqipe. Se fundmi, ka qene drejtor i Qendres Nderkombetare te Kultures dhe Drejtor i Zyrws Shqiptare tw tw Drejtave tw Autorit nw Tiranw. Tani boton gazeten kulturore Nacional, ku botoj here pas here shkrime te ndryshme.

Shoket e mij veriore i kujtoj me respektin me te madh, si djem te beses, te drejtperdrejte, trima. Me ta duheshe te ishe i matur ne fjale e ne veprime. Por qene miq per koke. Jam i lumtur qe pata fatin te jetoj kater vite me ta, ne nje dhome ne konviktin e qytetit "Studenti."

Ne kujtim te atyre viteve te bukura, po sjell ketu dy poezi te shokut tim Mujo Bucpapa, marre nga vellimi " Fitorja e padukshme " botuar ne dy gjuhe ne SHBA, ne shqip e anglisht.

SHIU S'ESHTE SHI

Shiu s'eshte shi
Ai qe shushurin
Kur prek fletet.

Shiu eshte dicka tjeter
Lot i qiellit .

Sic vjen prej mundimesh
e malli njerezor
Loti i syrit

Shiu qe e ndjellim prej qiellit
Shiu qe enderrojme
S'eshte shiu.

Eshte lot i arte
Qe remd drejt fushave e streheve tona
Prej qiellit .

Shiu s'eshte shi
Ai qe prek zhurmshem kallinjte
Dhe tremb andej zogjte .

KY ESHTE VETEM FILLIMI

I biri i djallit i ulur
Ne fron zjarri
Te ndezur ,
Pa te drejte vote numeronte popullin
E hirte
Ne fund te shekullit te mjegullt.

Shoqeria pa konsensus
I binte
Fyellit te eger te detit.

Deri ne breg te mbytjes
Ne llum
Deshirash te marra
Shkonte durimi i pertypur.

Lamtumire
Popull i mbetur
Ne fillim !

*Autori i shkrimit, V. Simaku, u nda nga jeta më 4 mars 2017

ËSHTË PIKËLLUESE PËR MUA TË SHKRUAJ NË KËTË PËRVJETOR TË NDARJES NGA JETA TË VANGJUSHIT

Nga Dr. Mujë Buçpapaj

Është pikëlluese për mua të shkruaj në këtë përvjetor të pestë të ndarjes nga jeta të Vangjushit, mikut tim të famshëm të fakultetit që udhëtoi drejt parajsës duke lënë ndër ne kujtimin e një një njeriu fisnik, që sfidoi të gjitha pëngesat në jetë, përfshirë edhe vdekjen me qetësi, fisnikëri dhe guxim.

Me Vangjushin u njohim qysh në Fakultetin e Letërsisë, me një grup djemsh dhe vajzash të reja që përpiqeshim të gjenim tek kjo letërsi misterin e botës, mistikën dhe trandjen që u kishte shkaktuar shkrimtarëve të botës frika e jetës, shpesh mbijetesa dhe fundi thuajse tragjik i tyre.

Vangushi ishte një njeri që mund të bisedoje për letërsinë, kulturën, ndërthhurjen ironike të jetës reale dhe asaj të shpikur nga shkrimtarët si një shpetim nga ankthi i tyre nga vdekja, ose të paktën humbja dhe poshtrimi që u kishte ndodhur, qoftë edhe si një lëshim ideologjik në rastin e shkrimtarëve të realizmit socialist.

Ishim katër vjet në dhomen 42 të ndertesës së konviktit në Qytetin "Studenti" në Tiranë, bashkë me Fadilin, Benin dhe Bardhin dhe në dhomën ngjitur Çeçon, Arjanin, Artanin, Ladin, V.Pjetrin, Rrapon etj, të gjithë djem të mirë dhe të vertytshëm, që sillnim prejardhje dhe kultura të ndyshme e që i reflektonim edhe në mënyrat e ndryshme të sjelljes, reagimit ndaj padrejtësive që bëheshin kudo, aq sa unë dhe Çeloja, një shkok tjetër i kursit, konsideroheshim si zëra kundër .

Vangjushi mes nesh dukej si një akademik, me kostum , kollare dhe një çantë të kushtueshme plot me libra që ja shtonin edhe me shumë seriozitetin, aq sa vajzat e merrnin shpesh për pedagog dhe i drejtoheshin me respekt biles me druajtje. Vangjushi ishte mësuar më këtë komunikim dhe nuk i bënte përshtypje. Biles kur atij i vinin paratë nga shtepia , bashkë me pakot e ushqimeve, pinim ndonjë birrë tek trekëndshi në qender të Tiranës dhe qeshnim më të madhe me keto ndodhi.

Nga rrethi i miqve të kursit dhe të dhomës me Vangjushin më mirë se me të gjithë debatonim për shkrimtarët, për dyshimet që kishim për leksionet e pedagogave, për sllloganet e kohës, për përkthimin, humorin, vajzat e bukura të Fakultetit, jetët e tyre dashurore dhe jehonat që vinin deri në dhomat e konviktit, sidomos netëve të zymta të dimrit plot shi të Tiranës, kur nuk mund të shkoja as në bibliotekë.

Vangjushi njihte disa gjuhë të huaja, përkthente dhe shkruante, ai i lexonte më zë poetët e tij të preferuar, biles edhe poezitë e mia apo Cklin e Kreshnikëve edhe pse është i shkruar në gegnisht. Ai mund të kishte vazhduar me sukses edhe artet. Meqënëse unë, Fadili dhe Bardhi ishim nga Veriu e quanim si një vëlla të vogël, si një malsor dhe për këtë e ndihmonte edhe shtalartësia dhe fisnikëria e tij e përhershme.

Vangjushi kishte shumë ironi, shumë homor burimor aq sa nuk linte pa thumbuar këdo që e merziste apo e tepronte me ndihmat që i kërkonte atij për leksionet e rregullta që mbante ma mirë nga të gjithë ne.Vangushi ishte një student e rregullt dhe shumë i mirë në mësime.

Bashkë me Vangjon dhe Çeçon u kishim vënë nga një nofkë shumë prej studentëve hileqarë si një kod saterik, kur debatonim për aventuart e tyre. Biles me Vangjon dhe Çeçon patëm shkruar nga një poemë saterike për aventurat e dashurisë të dy shokëve të Fakultetit, të cilat Vangjushi i mori me vete në Korçë.Janë berthamat e dy komedive të shkelqyera.

Vangjushi ishte një intelektual trim. Kur në vitin 1997 bandat revanshiste me bënë atentat dhe mora disa plumba kallashnikovi, ai shpërfilli situatën e rrezikshmedhe jashtë kontrolli ku gjendej vendi dhe erdhi dhe me takoi tek spitali ushtarak në Tiranë."Kreshnikët nuk pyesin për plumba", më tha me humor sapo hyri tek dhoma, duke e lidhur emrin tim me atë të heroit të epikës tonë legjendare siç benin kur ishim studentë.

Me Vangjon, jemi takuar sa herë që vinte në Tiranë, deri pak ditë para se të ndahej nga jeta pasi bënte dializën në kryeqytet. Ndërsa kujtuam si gjithmonë kohën studentore, më tha se i kishte poemat në shtepi dhe se mund t'i botonte. Vangjushi ishte një shpirt i lirë një demokrat patriot qe vinte nga nje familje intelektuale, patriote. Ai e mbeshteti pluralizmin dhe demokracinë. Vangjushi dha kontribute të rendësishme për arsimin e mesëm në vend duke filluar nga Puka ku dha mesim disa vite dhe posaçërisht në Korçë.

Ai bashkpunoi për disa vite me gazetën "Nacional" me shumë shkrime ekselente problemore si dhe plot të tjerë për kulturën në Korcë.

Ai iku i ri, i qetë dhe i plotësuar me një familje të shkelqyer që e deshi dhe e mbeshteti gjithënjë në agazhimet e tij deri në frymen e fundit.

Ai gjeti strehim në banesën e përjetshme të zotit me ndriçmin që Ai u bën shpirtërave fisnik siVangjush Simaku.

Vangush, kujtimi yt do të jetë përherë ndër ne!

Tri poezi nga Teuta SADIKU

1@

Jam e skajshme deri në pafundsi.
Në agimin e çdo mëngjesi
mbjell me duart e mia një dëshirë mëkatare.
e ushqej me gjirin tim ,
në parvazin e pritjeve , të muzës.
E ndjej si rritet koka e mendimit ,
dhe hyn thellë në brazdat e trurit tim.
Natë e ditë e bluaj në mullirin e gurtë.
Kokë shkëmbe poezia si unë.
Ndonjëherë harroj ta vadis me lotët e mi.
E shkel me këmbë,në skajin tjetër
e bëj musht nga të korrat e keqardhjes
e hedh në kosh, të pajetë .
E kthej në jetë , me një frymë.
Kur kaloj në mes të vargut drejt fundit ,
në pikën e vdekur
emocioni periferik shton rrahjet e zemrës .
Besnike në zakonin e vjetër
buzëqeshja më ulet në buzë.
E vërteta është ironike në rrugën e përditshme.
Muza s'më ka dashur aq sa e kam dashur unë.

2@

Një trup i deformuar ,me konture të ashpra
Egzaminon veten para pasqyrës
E zhveshur para kohës ,e gjunjëzuar
Drejt të gjashtëdhjetave
fluturon pas një drite,
pa flokë në kokë ,
me duar diçka kërkon
të papërcaktuar të shtrembëruar .
Një nyje shkëputet nga figurat e Bacon -it
e zbehtë, e rraskapitur futet plot emocione
në kubin e Picasso-s ,
rrafshon format e jetës
në Tempullin e Paqes një grua mbështet bërrylat.

3@

Ajo hija dëshpëruese e Giacomett-it
e humbi formën,
U coptua në një gjëagjëzë,
Një enigmë rrugëve të ngushta endet
skandali shndërrohet në shuplakë
Është plagë që kullon tani,
mos e prekni me duar .
Hedh një hap hija e luftës
lëviz para e mbrapa
të mund të dalë nga korniza
të mbështjellë në rrjedhë amorfe imagjinatën
coptohet substanca e karikaturës .
Vetëm sytë shohin nga brenda të habitur
.Kush jam ?
Një grimcë e qeshur shkëputet
bëhet molekulë jete
sytë brenda mitrës shohin të pikëlluar
duan të hapin grilat e jetës me një klikim.

SHQIPTARËT NË UKRAINË, STALINI DHE SHQIPTARËT

Prof. dr. Spiro Mëhilli

Më 24 maj 1794, me urdhër te Ekaterinës II, në jug të Ukrainës, buzë Detit të Zi, u ndërtua një port ushtarak, që në vitin 1795 e quajti Odesë, dhe më 1796 e futi atë në gubernën e Novorosiskut. Ka të ngjarë që shqiptarë të ketë pasur me kohë në atë qytezë, sepse, menjëherë pas themelimit të qytetit, takojmë dy rrugë shqiptare: "Bolshaja Arvanitskaja Ulica" (Rruga e madhe arvanite-shqiptare-S.M.) dhe "Mallaja Arvanitskaja Ulica (Rruga e vogël arvanite-shqiptare- S.M.), që datojnë në vitet 1794-1795, si dhe bukën e famshme të zezë, "Arvanitskij hljeb" (bukë e gatuar alla shqiptarshe me thekër dhe shumë e shtrenjtë- S.M.).

Vite më vonë, drejt verilindjes së Europës filloi emigrimi në masë i shqiptarëve që u quajt "lëvizje shqiptare" me bullgarë, me vlleh dhe me shqiptarë nga Maqedonia Perëndimore, nga Shqipëria e Mesme (Qendrore) si dhe nga ajo Juglindore, kryesisht nga rrethi i Korçës dhe krahina e Devollit. Fillimisht, ata u vendosën në juglindje të Bullgarisë, në fshatin bullgar të Mandricës. Koloni shqiptare ka pasur jo vetëm në Bullgarinë Jugore por dhe në verilindje. Rreth 10 km larg nga Varna, që për disa vite në komunizëm, u quajt "Stalino", ndodhej fshati bullgar Devino (Devna, Devnja, Devnje) i ujezdës Provadijskij, emër që e mori nga lumi Devino, që rridhte aty pranë. Në atë fshat, ose pothuaj ngjitur me të, u vendos një koloni shqiptare me rreth 300 familje, dhe e quajtën atë vend Devi. Në vitet 1809-1810, nga fshati Devi, shqiptarët bashkë me bullgarë shkuan në Besarabi duke kaluar nga qyteti Galac për t'u vendosur në fshatin tartar Çumaj, të Ujezdës Kagulskij, afër Jallkuçit dhe më vonë në bregun e djathtë të liqenit Jallpug, pranë lumit Sarlik e më pas në fshatrat Tabak, kështu quhej para vitit 1819 qyteti Bollgrad, Vollkanesh, Çadër-Lunga, Besh-Gjoz, Verhnebuxhaskij dhe Kagullo-Prutskij. Në vitin 1811, prej andej u shpërngulën një pjesë e mirë e fshatarëve dhe shkuan në anën e majtë të liqenit Jallpug, jo larg lumit Sarllik, dhe themeluan fshatin Karakurt, që aktualisht bie në qarkun e Odesës, afërsisht 6-8 km në juglindje të fshatit Tabak, në veri të qytetit Izmail. Dhe që nga ai vit, ata vazhdojnë të banojnë në atë vend duke ruajtur zakonet dhe deri diku gjuhën amtare. Të moshuarit, tregojnë se të parët e tyre rridhin prej anëve të Korçës, dhe për mos t'u persekutuar nga turqit u shpërngulën nga atdheu. Në vitin 1861, një pjesë e shqiptarëve që banonin në Karakurt, u shpërngulën duke kaluar në rrugën Akerman-Odesë-Nikollajev-Berisllav nëpërmjet dy kalimeve të mëdha: përmes Bugit në Nikollajev dhe Dnjeprit në Berisllav, dhe në rajonin e Berdjanit ata u sistemuan në bregdetin Azov, dhe në vitin 1862 themeluan tri fshatra: Taz, Gjandran dhe Qushki (emra sikundër i kanë pagëzuar banorët e parë shqiptarë), që më vonë u quajtën me emrat e ri rusë ose ukrainas, përkatësisht Devnjenskoje, Gamovka dhe Georgievka. Devnjenskoje, Gamovka dhe Georgievka ndodhen në rrethin Priazovsk të qarkut Zaparozhje , 30 km në juglindje të qytetit Melitopol dhe shumë afër njëra-tjetrës. Gamovka buzë lumit Domuzlli, që derdhet në Detin Azov, ndërsa Georgievka dhe Devnjenskoje shtrihen në bregun e djathtë të lumit të vogël Akiokrak, që është degë e lumit Domuzlli. Karakurti dhe këto tre fshatra ndodhen në territorin e Ukrainës. Banorët ruajnë folklorin gojor dhe koreografik. Në vitin 1949, sipas Selim Islamit, deri në vitin 1949, në ato tre fshatra banonin 1050 shqiptarë, banorë nga Korça dhe më pak nga Maqedonia dhe ishin të bashkuar në kolkozin "Kaganoviç".

Në vitet 1877-1878 në kohën e Aleksandrit II, një numër i madh shqiptarësh morën rrugën dhe u vendosën kryesisht në Odesë, në një komunitet prej 5000 vetash, sepse e patën më të lehtë të shkonin me anije sesa me rrugë tokësore dhe më pas u shpërndanë në qytete të ndryshme të Perandorisë Ruse. Një pjesë e tyre u vendosën në një lagje të Odesës, që dhe tani mban emrin "Mali Arnauti". Të tjerë u vendosën në Sank Petërburg, në Harkov, në Irkutsk, në Inovgentevsk afër Irkutskut, në Verhneudinsk, në Svjerdllovsk, në Kamenec, në Sevastopol, në Siberi, në Kutaisk, në Suhumi dhe në Vladivostok.

Autorët Musliu dhe Dauti që kanë hulumtuar mbi shqiptarët e Ukrainës, në një titull të veçantë "Stalini vrau 2000 shqiptarë të Tazit, varreza masive e viktimave të "murtajës", e vërteta e fshehur me vite" shkruajnë sesi e tregon ngjarjen banori vendas Mihajl: "Thonin se është çuma (kolera) që kjo botë të vdesë, por kjo nok klinka kështu. Ata botë i hidhkan të gjallë në këtë baltë. Po ne këtë nok e dinim.Tashti kur u bë slobodna (e lirë) Ukraina, tashti na thanë drejt. Ata donin të na unishtitin (likuidojnë), na të mos ishim hiç në jetë.Qysh dëften ime mamo, dhe botë (shumë) pleq, këtu janë edhe ime tatë, ime totë (baba dhe tezja), këtu janë edhe imë pesë ulshur. Ata nok na dashkan neve në këtë baltë, imi të gënjurë (gënjyer), nok na dashkan hiç në këtë baltë. Por neve na gënenin. Kjo u bë në kohën kur ishte Stalini, në motmot 1933. Hecnin nëpër fshat, kush kish një cërkë bukë, kush kishte një cërkë koqe (drithë) na merrnin, të mos ket ç'të hajë vdisnin botë. Mamo më dëftente, vajta në Kladovë të marr një cërkë mill, nga mbrapa ngarend i jatë, vëllau thot vdekka. Ajo nok vjen prap, mbet të marrë një cërkë millë jatër të mos vdesë. Ajo nuk e paska të vëllanë kur e sollën këtu dhe e hedhkan në këtë baltë të mos vdesë të tjerë fëmijë. Unë ndoshta nok shqipton (kuptoj) mirë si tantë, por kush dilingon neve, desha të tregoj drejt se ata neve deshën të na bënë fiziçeski unishtozhe (likujdojnë fizikisht). Botës tanë atje ku na dilingojnë, desha të tregoj drejt se ata neve deshën të na likujdojnë. E tashti tantë botë, nga një cërkë, ngas një cërkë e gjetën të vërtetë se Stalini tantë botë desh në na unishtat (likujdojë).....jer të vdes bëjë skarbit (*uratë) për tantë botë, për motra dhe vëllezër tantë....Ju e shihni këtë poljanë (fushë), këtu të gjithë të mbulut të tantë botë, në vitet tridhjetetre. Fshati tanë ishte nga tantë botë, pastaj këtu sollnë preselencë (të ardhur). 'u desh kjo punë, dhe ku do klahesh (ankohesh)". E vështirë të pranohet si shifër kur dihej sesa shqiptarë kishte ai fshat. Po të besojmë Gertruda Josifovna Ejntrein që thoshte se "Në Karakurt shqiptarët janë rreth 2000", duke shtuar dhe të tjerë nga Odesa dhe nga vende të tjera ku banonin shqiptarë, atëherë kjo shifër duhet të jetë e pranueshme. Në kohën e LIIB, sipas Ramadan Çilkut, "Stalini nuk i pranonte ushtarët shqiptarë nga Karakurti e gjetkë. Ai i merrte vetëm në armatën e punës, për të punuar nëpër miniera. Kështu ishte deri në vdekje të tij dhe shumë shqiptarë kanë lënë eshtrat në Basenin e Donit". Nga këto thënie, Stalini që nga ajo kohë nuk i kishte në konsideratë shqiptarët dhe për analogji edhe Shqipërinë.

Në Konferencën e Moskës, në tetor të vitit 1944, në takimin që patën delegacionet e Bashkimit Sovjetik dhe Britanisë së Madhe, me pjesëmarrjen e Stalinit, Molotovit, Çërçillit, Idenit, Herrimanit dhe përkthyesve Birs e Pavllov, në tavolinën e bisedimeve, pa i vënë në dijeni udhëheqësit e SHBA-ve, sipas propozimit të Çërçillit dhe dakortësisë së Stalinit, ata vendosën influencën e tyre në Ballkan. Sipas tyre, Rumania do t'i takonte 90% Rusisë dhe pjesa tjetër prej 10% do t'i takonte të tjerëve, për më tepër që Rumania kishte dërguar në BS 26 divizione. Greqia do t'i takonte 90%-100% ose 90% Britanisë së Madhe dhe 10% Rusisë. Jugosllavia dhe Hungaria do të ndaheshin në mes, pra, 50% me 50%, midis Rusisë dhe Britanisë së Madhe. Përsa i përkiste Bullgarisë, Rusia propozoi që t'i takonte 75% asaj dhe 25% të tjerëve.

Shqipëria nuk u zu me gojë, sikur ajo, sipas tyre, të mos egzistonte si shtet, pavarësisht të ndonjë deklarate të lëshuar prej Tre të Mëdhenjve, ku vlerësohej lufta e popullit tonë kundër pushtuesve nazist.

Vijon numrin e ardhshëm

Vijon në faqen 20

veçantë periudhën e diktaturës në Shqipëri. Lehtësia me të cilën autori të shpie në thelbin e procesit transformues (ndryshe nga Kafka tek Procesi psh), gjuha e pastër dhe plot figuracion artistik, analizat e veçanta psikologjike të personazheve dhe sidomos monologjet e "Shoqes S", e bëjnë romanin një sy magjik nëpër të cilin shihet pas në kohë një realitet të metaltë, që peshon rëndë në supet e secilit.

Romani është një akt-akuzë artistike kundër autokracisë dhe diktaturave, të cilat synojnë nënshtrimin e shoqërisë, nëpërmjet deformimit të individit. Por kur vjen fjala tek një diktaturë e llojit komunist, si ajo që ishte në Shqipëri, absurdi nuk mund të trajtohet artistikisht, vetëm se nëpërmjet satirës, sarkazmës dhe mjeteve të tjera sa më fine, me qëllim që tragjikja e realitetit të mos ja zërë frymën artit të romanit.

Për ata që janë lindur pas viteve 1990 dhe nuk kanë përjetuar asgjë nga ai absurd tragjik, kjo vepër do t'u shërbejë si një çelës për të hapur sa më mirë portën e së shkuarës. Nga ana tjetër, ky roman është një homazh artistik për të gjithë ata njerëz të thjeshtë, anë e mbanë Shqipërisë, që direkt apo indirekt u detyruan të bëhen vegla dhe viktima të diktaturës.

Ai sistem ishte si zjarri; t'i afroheshe shumë, të digjte; t'i largoheshe shumë, të ngrinte. Gjetja e vendit më të përshtatshëm për të qëndruar në atë fermë oruelliane, ishte gjëja më e vështirë.

"Dëmtuar gjatë rrugës", është një roman, që e tejkalon misionin e shpalosjes së lakuriqsisë së një karikature tragji-komike. Mesazhet, kryesisht mesazhet që sjell ky libër, janë me vlerë shoqërore, për sot dhe për nesër. Edhe në procesin e gjatë të tranzicionit demokratik në Shqipëri, sa e sa personazhe periferike e qëndrore janë "dëmtuar gjatë rrugës…"? Sa të tjerë rrezikojnë sot, që të "dëmtohen gjatë rrugës"? Në fakt, metafora e rrugës, mund të mishërohet tek koha dhe përditshmëria jonë. Sa presion bashkëkohor bëhet sot mbi karakteret e brishta njerëzore? A nuk janë ende si dikur, po aq të frikshme zyrat e shtetit, sikur i shihte nëna e shkrimtarit Besnik? A nuk janë intrigat, pabesitë, kurthet, degradimet e personalitetit ato që herë pas here na presin në krye të shkallëve në institucionet ku trokasim? A nuk është ringjallur autokracia si karikaturë e demokracisë?

Përveç vlerave të spikatura artistike dhe risisë që sjell në prozën shqiptare të këtij shekulli, ky roman, mendoj se është, gjithashtu një leksion purifikues, edukativ dhe i pazëvendësueshëm për rininë e sotme, para së cilës ka sfida të reja. Sokrati, një herë e një kohë i porosiste të rinjtë athinas; "Njihe vetveten"! Kurse sot, Mustafaj, me këtë roman, sikur na porosit të gjithëve; "mos e tradhëto vetveten"!

E përmenda edhe pak më lart se, me këtë roman, shkrimtari Besnik Mustafaj ka kapërcyer veten dhe ky është një hop cilësor, që nuk e bën dot gjithkush. Ka shkrimtarë të mëdhenj, si psh Kadare apo ndonjë tjetër, që gjatë këtyre dy a tri dekadave të fundit, nuk e kanë tejkaluar dot vetveten. Është e dhimbshme, p.sh, që një kandidati për çmimin "Nobel" në letërsi, t'i përmenden si kryevepra, romane të shkruara dekada më parë. Liria është një mundësi e madhe për shoqërinë që të ecë përpara. Por, ndonjëherë, për shkrimtarët e periudhës së post-diktaturave, kjo sikur u kufizon elementët krijues, sidomos në rrafshin e figuracionit, metaforave dhe simbolikave të tjera.

Lajmi më i gëzuar për një shkrimtar është, kur një nga veprat e tij përqafohet gjerësisht nga publiku dhe konsiderohet si një vlerë e munguar. Mirëpo, pikërisht këtu, fillon edhe problemi për të, sepse ky standard është një lloj steke, që ai e ka para vetes çdo ditë për ta kaluar. Nëse ai nuk e kalon dot, siç edhe ka ndodhur shpesh, atëherë, rron shkrimtari, por vdes arti i tij. Unë besoj se me kërkesat që ka ndaj vetes, Besnik Mustafaj, do ta tejkalojë këtë roman me një prurje tjetër befasuese. Por, sido që të ndodhë, "Dëmtuar gjatë rrugës", mendoj se ka hyrë denjësisht në panteonin e kryeveprave të prozës shqiptare.

Konkursi "InsurTech" dhe turi në universitete, një mundësi e artë nga SIGAL UNIQA për të rinjtë

Në një muaj kur festohet 23-vjetori i themelimit dhe 15-vjetori i bashkëpunimit me gjigandin austriak UNIQA Insurance Group, kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon SIGAL UNIQA Group Austria vjen me mundësi të arta për të rinjtë shqiptarë.

Konkursi InsurTech dhe workshop-et e kompanisë në disa prej universiteteve në vend janë një mundësitë që gjithësecili të tregojë dëshirën dhe aftësitë për të punuar në një sektor ende të pazbuluar plotësisht siç janë sigurimet.

"InsurTech" është projekti i SIGAL që ka si qëllim zbulimin e talenteve të reja në botën dixhitale dhe shfaqes së virtyteve të tyre në aksesimin e burimeve të ndryshme.

Qëllimi? Zgjidhje novative dixhitale për probleme unike në biznesin e sigurimeve.

"Në këtë 23 vjetor të themelimit të saj dhe 15-vjetorit të bashkëpunimit me gjigandin austriak të sigurimeve UNIQA Insurance Group, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA lançon konkursin për zbulimin e talenteve të reja në botën dixhitale, të titulluar "InsurTech – E Ardhmja që na frymëzon!"

"InsurTech" është projekti më i fundit i kompanisë më të madhe të sigurimeve në Shqipëri dhe rajon që synon zbulimin e talenteve të reja në botën dixhitale dhe prezantimin e zgjidhjeve dixhitale novatore për probleme unike në biznesin e sigurimeve.

- Nëse ti ke një ide novatore dhe origjinale...
- Nëse ti ke një ide të zbatueshme në botën reale të sigurimeve shqiptare sot...
- Jepi vetes mundësinë për të fituar çmimin e parë prej 1,500 Euro!"

Konkursi përfshin edhe dy çmime të tjera:
Çmimi i dytë: 1,000 Euro
Çmimi i tretë: 500 Euro
Mos harroni! Afati i fundit për aplikim është data 15 mars 2022", shprehet Ona Haxhiaj, shefe zyre pranë Departamentit të IT në SIGAL UNIQA.

Ne intervistuam gjithashtu edhe znj. Irma Shkrepa, Administratore e Institutit Ndërkombëtar Financiar për Banka dhe Sigurime (IFIBI), kompani nënkontraktore e SIGAL UNIQA, e cila do të jetë njëkohësisht edhe lektore e workshop-eve që kompania më e madhe e sigurimeve do të zhvillojë në universitete.

"SIGAL UNIQA Group Austria në demostrim të përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë koorporative, si lider i sigurimeve në tregun shqiptar, në bashkëpunim me IFIBI-n, Institutin për Sigurime dhe Banka, ndërmarrin një tur në të gjithë universitetet e vendit për një fushatë ndërgjegjësimi, informimi dhe insetivimi në lidhje me produktet e sigurimit.

Fushata ka synim dhe objektiv informimin për produktet që prekin përditshmërinë tonë siç janë sigurimet e shtëpisë, sigurimet e mjeteve motorike, sigurimet e shëndetit por jo vetëm. Edhe planifikimet për skemat e pensionit privat në mënyrë që brezi i ri dhe jo vetëm të ndërgjegjësohen për opsionet që kanë për të ruajtur dhe për të mbajtur një standard më të lartë jetese në përditshmërinë e tyre", tha ndër të tjera znj.Shkrepa.

Çdokush e ka mundësinë të bëhet transmetues i këtyre informacioneve kaq të dobishme duke nisur nga rrethi i tij familjar, shoqëror e duke siguruar kështu të ardhura nëpërmjet komisioneve të ndërmjetësimit që paguhen nga SIGAL Uniqa Group Austra.

Të rinj, studentë e pedagogë mund të përfitojnë nga kjo mundësi duke u bërë agjentë të SIGAL.

SIGAL UNIQA Group Austria, Jetojmë më mirë së bashku…

Për më shumë informacion:
WEB: https://sigal.com.al/insurtech/
E-mail: info@uniqa.al
WhatsApp: +355 68 606 2829

https://www.youtube.com/watch?v=9Ie34nvMuLM&t=2s

Bordi Editorial Ndërkombetar i revistës "Nacional"

DR. MUJË BUÇPAPAJ,
Instituti i Studimeve dhe Projektteve "Nacional" Kryetar, Tiranë

1. Prof. Dr. Frederick Turner (USA), (Professor, UTD)
2. Prof. Dr. Ed Garcia (USA), (Professor, retired)
3. Dr. Rati Saxena (India), (Drejtoreshë e revistes "Kritya")
4. Mai Van Phan (Vietnam), (Poet Professional, Vietnam)
5. Prof. dr. Vasil Tocinovski, Shkup/Skopje
6. Akademik Fabijan Lovriç (Prof. Dr), Knin, Kroaci
7. Prof. Dr. Basil Schader Zvicer, Universitetit i Cyrihut, albanolog
8. Prof. dr. Gjovalin Shkurtaj, Akademik, Tiranë
9. Prof. Dr. Milazim Krasniqi, Universiteti i Prishtinës
10. Prof. Dr. Albin Sadiku, Qendra Albanologjike, Prishtine
11. Prof. Dr. Shaban Sinani, Qendra e Stud. Albanaologjike, Tiranë
12. Prof. Dr. Ardian Marashi, Qendra e Stud. Albanologjike, Tiranë
13. Prof. As. Dr. Ukë Bucpapaj, Univeristeti i Tiranës
14. Prof. Dr. Nuridin Ahmeti, (Hulumtues në Degën e Historisë)
15. Prof. Dr. Sadik Bejko, Universitei i Tiranës
14. Dr. Nail Draga, Ulqin, Mail i Zi
15. Pr. Dr. Avzi Mustafa, Universiteti i Shkupit
16. Michael Agustin, Gjermani
17. Naim Araidi, poet, Izrael
18. Dr. Rovena Vata, Qendra e Stud. Albanologjike, Tiranë
19. Prof. As. Dr. Anton Papleka, Tiranë
20. Prof. Dr. Bahri Beci, Tiranë
21. Prof. Dr. Klara Kodra, Tiranë
22. Prof. Dr. Laura Smaçi, Qendra e Stud. Albanologjike, Tiranë

SIGAL
UNIQA
UNIQA GROUP AUSTRIA
Trajtohu jashtë vendit për sëmundje serioze
Paketa e sigurimit
Jetë
Plus
Mbulon shpenzimet për trajtimin dhe udhëtimin
në spitalet më të mira në botë deri në
1 milion euro
NA SHKRUANI NË
+355 68 606 2829